REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E FUSHË KOSOVËS 2026-2030

Gusht, 2026

STRATEGJIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK LOKAL PËR KOMUNËN E FUSHË KOSOVËS 2026-2030



Gusht, 2026

Përgatitja e këtij dokumenti është bërë nga ALBO GROUP në partneritet dhe financuar nga Komuna e Fushë Kosovës

Autoriteti kontraktues: Komuna e Fushë Kosovës

Hartoi: ALBO GROUP në bashkëpunim me Komunën e Fushë Kosovës

PËRMBAJTJA

Lista e tabelave....VIII
Lista e grafikëve....IX
Lista e figurave....X
Lista e shkurtesave....XI
Fjalia hyrëse e kryetarit të komunës 13
Përmbledhje ekzekutive....15
1. Hyrje....16
2. Metodologjia....18
3. Vizioni, misioni dhe vlerat kyçe....21
4. Analiza e gjendjes aktuale dhe sfidat....22
   Historik i shkurtër i komunës....22
   Pozita dhe veçoritë gjeografike....24
   Popullsia....27
   Vendbanimet....31
   Migrimi....35
   Arsimi....36
   Shëndetësia....39
   Mirëqenia sociale....42
   Tregu i punës....43
   Shërbimet administrative....43
   Infrastruktura....44
   Telekomunikacioni.... 47
   Rrjeti energjetik....48
   Ndriçimi publik....49
   Furnizimi me ujë....49
   Kanalizimi....51
   Mbeturinat....52
   Kultura....53
   Profili ekonomik i komunës së Fushë Kosovës....60
   Krahasimi me vendet/komunat tjera....67
5. Analiza SWOT....68

6. Qëllimet dhe objektivat për zhvillim ekonomik....73
Qëllimet strategjike dhe objektivat specifike....73
7. Monitorimi dhe raportimi....87
8. Ndikimi buxhetor....88
Buxheti komunal....88
Vlerësimi buxhetor....92

Shtojca 1 - Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal....93
Shtojca 2 - Struktura organizative e komunës së Fushë Kosovës....126

Lista e tabelave

Tabela 1. Populllsia e komunës së Fushë Kosovës sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare...33

Tabela 2. Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Fushë Kosovës.....34

Tabela 3a. Migrimi kombëtar në komunën e Fushë Kosovës, periudha 2021-2023.....36

Tabela 3b. Migri Migrimi ndërkombëtar në komunën e Fushë Kosovës, periudha 2021-2023 36

Tabela 4. Rangimi i grupeve kryesore të shkaqeve të vdekjes në komunën e Fushë Kosovës, 2020-2021.....41

Tabela 5. Shërbimet sociale në komunën e Fushë Kosovës.....42

Tabela 6. Numri i të punësuarve në komunës së Fushë Kosovës, sipas drejtorive.....44

Tabela 7. Burimet e ujit në komunën e Fushë Kosovës.....51

Tabela 8. Trashëgimia kulturore.....57

Tabela 9. Objektet e luajtshme.....58

Tabela 10. Profilet e aktiviteteve ekonomike, numri i tyre dhe %.....61

Tabela 11. Burimet e financimit në komunën e Fushë Kosovës (€), periudha 2026-2028.....89

Tabela 12. Planifikimi i të hyrave vetanake në komunën e Fushë Kosovës (€), 2026-2028.....87

Tabela 13. Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Fushë Kosovës (€), vlerësim për periudhën 2026-2028.....88

Lista e grafikëve

Grafiku 1. Populllsia në komunën e Fushë Kosovës sipas regjistrimeve, periudha 1948-2024...28

Grafiku 2. Shtimi natyror në komunën e Fushë Kosovës, periudha 2021-2023 29

Grafiku 3. Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Fushë Kosovës.....29

Grafiku 4. Struktura etnike e popullsisë në komunën e Fushë Kosovës.....30

Grafiku 5. Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Fushë Kosovës.....30

Grafiku 6. Struktura moshore e popullsisë në komunën e Fushë Kosovës.....31

Grafiku 7. Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Fushë Kosovës.....34

Grafiku 8. Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948-2024.....35

Grafiku 9. Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare në komunën e Fushë Kosovës, 2019-2024.....38

Grafiku 10. Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2022-2023.....40

Grafiku 11. Të infektuarit me COVID-19 në komunën e Fushë Kosovës, 2020-2023.....41

Grafiku 12. Statistikat e tregut të punës, 2024, në Republikën e Kosovës.....43

Grafiku 13. Sipërfaqja e tokës bujqësore në komunën e Fushë Kosovës.....62

Grafiku 14. Sipërfaqja e tokës jobujqësore në komunën e Fushë Kosovës.....63

Grafiku 15. Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Fushë Kosovës (%), periudha 2023-2028.....89

Grafiku 16 Struktura mesatare e shpenzimeve në komunën e Fushë Kosovës (%), vlerësim për periudhën 2026-2028.....92

Lista e figurave

Figura 1. Metodologjia e punës.....19
Figura 2. Vlerat kyçe të komunës së Fushë Kosovës.....22
Figura 3. Pozita gjeografike e komunës së Fushë Kosovës.....25
Figura 4. Pamje e qytetit të Fushë Kosovës.....32
Figura 5. Enë me dy doreza nga Epoka e Hekurit (Muzeu i Kosovës).....54
Figura 6. Fortesa parahistorike e Bellaçecit.....54
Figura 7. Stoli mesjetare.....55
Figura 8. Kalaja e Harilaqit.....56
Figura 9. Rekonstruimi i stadiumit të qytetit – projekti ideor.....59
Figura 10. Palestra në ndërtim e Sporteve.....59
Figura 11. Parku i pishave në Sllatinë.....66

Lista e shkurtesave

AMF	Ambulanca të Mjekësisë Familjare
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
GIS	Geographic Information System
Ha	Hektarë
KAB	Korniza Afatmesme Buxhetore
KEDS	Kosovo Electricity Distribution and Supply Company
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
km	Kilometër
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike në Kosovë
KRM	Kompania Regjionale e Mbeturinave
KRU	Kompania Rajonale e Ujësjellësit
kv	Kilovat
m	Metër
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MSA	Marrëveshja e Stabilizim – Asocimit
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OJQ	Organizata Jo-qeveritare
PKVEE	Plani Komunal i Veprimit për Efiçiencën e Energjisë
PSAK	Planit Strategjik i Arsimit në Kosovë
QKMF	Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare
QMF	Qendër e Mjekësisë Familjare
QPS	Qendra për Punë Sociale
SWOT	***S**trengths, **W**eaknesses, **O**pportunities, **T**hreats*
SZHEL	Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal
SHFMU	Shkolla fillore të mesme të ulëta
SHML	Shkolla të mesme të larta
TM	Tremujor

FJALIA HYRËSE NGA KRYETARI I KOMUNËS

Të nderuar qytetarë të Fushë Kosovës,

Fushë Kosova është ndër komunat që po përjeton transformimin më dinamik demografik, urban dhe ekonomik në vend. Rritja e shpejtë e popullsisë, afërsia me kryeqytetin, pozita strategjike në rrjetin rrugor dhe hekurudhor, zhvillimi i sektorit privat dhe zgjerimi i vazhdueshëm urban krijojnë mundësi të mëdha zhvillimi, por njëkohësisht kërkojnë planifikim më të mirë, investime të qëndrueshme dhe shërbime publike që i përgjigjen këtij ritmi të rritjes.

Pikërisht mbi këtë realitet është ndërtuar Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal për Komunën e Fushë Kosovës 2026 - 2030. Ajo nuk është vetëm një dokument planifikues, por një kornizë për drejtimin e zhvillimit të komunës në vitet e ardhshme dhe për kthimin e prioriteteve tona në politika, investime dhe rezultate konkrete për qytetarët.

Ambicia jonë është që potencialin e jashtëzakonshëm të Fushë Kosovës ta shndërrojmë në zhvillim të qëndrueshëm dhe të balancuar. Synojmë një komunë moderne, konkurruese dhe gjithëpërfshirëse; me ekonomi dinamike dhe klimë të favorshme për investime; me infrastrukturë funksionale që i përgjigjet rritjes së popullsisë dhe nevojave të bizneseve; me arsim dhe shëndetësi cilësore; me mjedis më të pastër dhe hapësira publike më të mira; si dhe me administratë efikase, transparente dhe të orientuar drejt qytetarit. Këto drejtime përputhen me pesë shtyllat kryesore të strategjisë: zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e sektorit privat, arsimin, shëndetësinë dhe mirëqenien sociale, urbanizimin dhe infrastrukturën, mjedisin dhe zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe qeverisjen e mirë.

Zhvillimi ekonomik dhe krijimi i kushteve për investime do të jenë ndër shtyllat kryesore të këtij transformimi. Fushë Kosova tashmë ka një bazë të fuqishme ekonomike dhe një sektor privat dinamik, ndërsa pozita e saj gjeografike, lidhjet rrugore e hekurudhore dhe afërsia me Prishtinën i japin potencial të veçantë për zhvillim komercial dhe logjistik. Strategjia evidenton mbi 3,500 biznese dhe orienton politikat komunale drejt përmirësimit të infrastrukturës për bizneset, tërheqjes së investimeve dhe fuqizimit të sektorit privat.

Në këtë drejtim, Plani Zhvillimor Komunal 2026 - 2034 parasheh zgjerimin e zonave komerciale, me synimin që Fushë Kosova të arrijë rreth 500,000 metra katrorë hapësira të destinuara për veprimtari komerciale. Ky zhvillim nuk përfaqëson vetëm zgjerim fizik të zonave të biznesit, por një orientim të qartë ekonomik: krijimin e hapësirës për investime të reja, zgjerimin e bizneseve ekzistuese, rritjen e punësimit dhe forcimin e bazës ekonomike të komunës. Synimi ynë është që, përmes kësaj politike dhe masave të tjera zhvillimore, Fushë Kosova të pozicionohet ndër katër komunat kryesore në Kosovë për nga qarkullimi financiar i bizneseve.

Ky orientim do të shoqërohet me mbështetje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, promovim të ndërmarrësisë dhe inovacionit, përmirësim të kushteve për investitorët dhe zhvillim të partneriteteve me sektorin privat. Qëllimi nuk është vetëm rritja e numrit të bizneseve, por krijimi i një ekonomie lokale më produktive, më konkurruese dhe që gjeneron vende pune dhe të ardhura të qëndrueshme.

Megjithatë, zhvillimin ekonomik nuk e shohim të ndarë nga mirëqenia e qytetarëve. Rritja ekonomike ka vlerë kur përkthehet në cilësi më të mirë të jetës. Për këtë arsye, investimet në arsim dhe shëndetësi, zgjerimi i kapaciteteve për fëmijët dhe të rinjtë, përmirësimi i mirëqenies sociale, zhvillimi i infrastrukturës, transporti më funksional dhe shërbimet publike më cilësore janë pjesë thelbësore e këtij vizioni.

Rritja e shpejtë e popullsisë e bën këtë përgjegjësi edhe më të madhe. Sipas të dhënave të përdorura në strategji, Fushë Kosova numëron rreth 70,000 banorë dhe ka shënuar një rritje prej mbi 82 për qind krahasuar me vitin 2011. Kjo dinamikë kërkon që investimet në arsim, shëndetësi, rrugë, transport, ujësjellës, kanalizim dhe hapësira publike të ecin përpara me ritmin e zhvillimit të komunës.

Një komunë që zhvillohet shpejt duhet njëkohësisht të zhvillohet me përgjegjësi ndaj mjedisit dhe brezave të ardhshëm. Prandaj, mbrojtja e mjedisit, menaxhimi më i mirë i mbeturinave, zgjerimi i hapësirave të gjelbra, efiçienca e energjisë dhe përdorimi i burimeve të qëndrueshme janë pjesë integrale e zhvillimit që synojmë.

Në qendër të gjithë kësaj mbetet qytetari. Qeverisja e mirë nuk matet vetëm me numrin dhe vlerën e projekteve të realizuara, por edhe me mënyrën se si merren vendimet, me transparencën e institucioneve, me cilësinë dhe shpejtësinë e shërbimeve dhe me mundësinë që qytetarët të jenë pjesë e vendimmarrjes. Për këtë arsye, strategjia parasheh forcimin e transparencës dhe llogaridhënies, digjitalizimin e shërbimeve dhe mekanizma më të avancuar të komunikimit dhe bashkëpunimit me qytetarët.

Strategjia 2026 - 2030 është ndërtuar mbi analizën e gjendjes së komunës dhe mbi bashkëpunimin ndërmjet administratës komunale, komunitetit të biznesit, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë relevantë. Por vlera e saj reale do të matet me zbatimin. Për këtë arsye, realizimi i saj do të përcillet përmes planit të veprimit, indikatorëve të matshëm, raportimit të rregullt dhe vlerësimit të rezultateve, duke forcuar përgjegjësinë institucionale dhe transparencën ndaj qytetarëve.



Jemi të vetëdijshëm se ritmi i zhvillimit të Fushë Kosovës kërkon vendime të guximshme, planifikim afatgjatë dhe bashkëpunim të vazhdueshëm. Institucionet komunale nuk mund ta ndërtojnë të vetme të ardhmen e komunës. Ajo ndërtohet së bashku me qytetarët, bizneset, profesionistët, të rinjtë, shoqërinë civile, institucionet qendrore dhe partnerët tanë vendorë e ndërkombëtarë.

Prandaj, kjo strategji është njëkohësisht zotim dhe ftesë për bashkëpunim: zotim që prioritetet e përcaktuara të udhëhiqen nga interesi publik dhe të shndërrohen në rezultate konkrete; dhe ftesë që secili të kontribuojë në ndërtimin e një Fushë Kosove moderne, konkurruese, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse – një komunë me mundësi për investime, punë dhe zhvillim dhe, mbi të gjitha, me cilësi më të mirë të jetës për çdo qytetar.

Në emër të Komunës së Fushë Kosovës, shpreh mirënjohjen time për anëtarët e grupit punues, administratën komunale, ekspertët, komunitetin e biznesit, shoqërinë civile dhe të gjithë qytetarët që kanë kontribuar në hartimin e këtij dokumenti.

Fushë Kosova ka potencialin, pozitën dhe energjinë njerëzore për të qenë ndër qendrat kryesore të zhvillimit ekonomik në vend.

Përgjegjësia jonë është që këtë potencial ta kthejmë në zhvillim të planifikuar, investimet në vende të reja pune dhe rritjen ekonomike në mirëqenie të prekshme për çdo qytetar.

Valon Prebreza

Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Zhvillimi ekonomik lokal është një element thelbësor i qeverisjes vendore, duke synuar krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve. Komuna e Fushë Kosovës përballet me sfida si zhvillimi i sektorit privat, modernizimi i infrastrukturës, ruajtja e mjedisit dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës. Ky dokument strategjik ofron një qasje të strukturuar për adresimin e këtyre sfidave, duke përfshirë mekanizma për nxitjen e investimeve dhe forcimin e bashkëpunimit mes institucioneve publike dhe sektorit privat.

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal për periudhën 2026-2030 ka përcaktuar pesë qëllime kryesore që do të udhëheqin veprimet e komunës: zhvillimin ekonomik dhe fuqizimin e sektorit privat, rritjen e cilësisë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale, urbanizimin dhe përmirësimin e infrastrukturës, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, si dhe qeverisjen e mirë dhe bashkëpunimin me komunitetin. Çdo qëllim është mbështetur me objektiva specifikë dhe projekte konkrete që synojnë të sjellin ndryshime të prekshme në jetën e qytetarëve.

Për të arritur këto qëllime/objektiva, plani strategjik rekomandon një qasje të integruar, ku komunat, bizneset dhe shoqëria civile punojnë së bashku për të krijuar një ekonomi më dinamike dhe të diversifikuar. Kjo përfshin lehtësimin e investimeve për bizneset e vogla dhe të mesme, përmirësimin e transportit publik dhe infrastrukturës rrugore, nxitjen e riciklimit dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme, modernizimin e arsimit dhe shëndetësisë, si dhe rritjen e transparencës dhe digjitalizimin e shërbimeve publike.

Në sektorin ekonomik, strategjia fokusohet në mbështetjen e ndërmarrjeve lokale, krijimin e lehtësirave për investitorët e huaj dhe promovimin e inovacionit si faktor kyç për zhvillimin e qëndrueshëm. Infrastrukturën dhe urbanizimin, strategjia i trajton përmes përmirësimit të transportit publik, ndriçimit dhe rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit. Mbrojtja e mjedisit përfshin investime në hapësira të gjelbëruara, promovimin e turizmit ekologjik dhe politika për reduktimin e ndotjes. Në qeverisjen lokale, objektivat përfshijnë digjitalizimin e shërbimeve, rritjen e llogaridhënies dhe forcimin e bashkëpunimit me komunitetin.

Ky plan strategjik është një udhërrëfyes dinamik për zhvillimin ekonomik të komunës, duke garantuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme. Zbatimi i qëllimeve të tij për periudhën 2026-2030 pritet të sjellë përmirësime të prekshme në jetesën e qytetarëve, duke e bërë komunën e Fushë Kosovës një vend më tërheqës për investime, zhvillim dhe mirëqenie.

1. HYRJE

Zhvillimi ekonomik lokal është një shtyllë e rëndësishme e qeverisjes vendore, e cila synon të krijojë një mjedis të favorshëm për rritjen e qëndrueshme ekonomike. Ky proces nxit bashkëpunimin mes aktorëve lokalë, përfshirë institucionet publike, bizneset dhe shoqërinë civile, për të shfrytëzuar potencialin ekonomik dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës në komunitet.

Përmes këtij angazhimi të përbashkët, synohet rritja e punësimit, zgjerimi i mundësive ekonomike, reduktimi i varfërisë forcimi i kapaciteteve lokale. Zhvillimi ekonomik lokal nuk është vetëm një qasje administrative, por edhe një strategji që u mundëson autoriteteve vendore të adresojnë nevojat urgjente të qytetarëve në mënyrë të qëndrueshme.

Për realizimin e këtij synimi, është e domosdoshme një qasje e mirëorganizuar, e cila përfshin mobilizimin e resurseve njerëzore, financiare dhe natyrore. Vetëm përmes bashkëpunimit efektiv mes palëve të interesit, krijohen mundësi për inovacion, investime dhe politika që sigurojnë një të ardhme më të mirë për të gjithë qytetarët.

Qëllimet kryesore të zhvillimit ekonomik lokal në komunën e Fushë Kosovës për periudhën 2026-2030 janë:

1. Zhvillimi ekonomik dhe fuqizimi i sektorit privat;
2. Rritja e cilësisë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale;
3. Urbanizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës;
4. Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm, dhe
5. Qeverisja e mirë dhe bashkëpunimi me komunitetin.

Ky dokument është përgatitur në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Komunës së Fushë Kosovës dhe udhëzimet e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, duke respektuar dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale. Ky ligj u garanton komunave kompetenca të plota për hartimin e politikave që lidhen me interesin lokal, përfshirë zhvillimin ekonomik, dhe siguron bazën ligjore për një qeverisje të decentralizuar, transparente dhe efektive. Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive për sa i përket interesit lokal, ku në mënyrë të precizuar përcaktohet edhe fusha e zhvillimit ekonomik lokal.

Qeverisja lokale në Kosovë po konsolidon autonominë komunale, duke thelluar reformat në vetëqeverisje. Strategjia për vetëqeverisje lokale ka pesë objektiva kryesore, ku një prej më të rëndësishmëve është *fuqizimi i rolit të komunave në zhvillimin ekonomik lokal*.[1] Kjo u mundëson komunave të hartojnë politika që mbështesin bizneset, investimet dhe infrastrukturën, duke rritur pjesëmarrjen e qytetarëve dhe bashkëpunimin me sektorin privat

Plani strategjik për zhvillimin ekonomik lokal është shtylla kryesore e rritjes së qëndrueshme, duke ofruar një kornizë të qartë për vendimmarrjen në nivel komunal. Ky dokument përcakton

[1] Strategjia për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 6.

prioritetet dhe veprimet konkrete për të nxitur zhvillimin ekonomik, mbështetur bizneset dhe përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve.

Komuna e Fushë Kosovës ka si vizion të saj të jetë komunë ekonomikisht e zhvilluar, me administratë moderne komunale, mjedis të pastër, infrastrukturë të zhvilluar, shërbime cilësore shëndetësore publike, popullatë të arsimuar dhe me mjedis atraktiv për jetëse dhe investime

Misioni i komunës së Fushë Kosovës është të jetë përkushtuar për të krijuar një mjedis të zhvilluar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, ku qytetarët përfitojnë nga shërbime cilësore, infrastruktura moderne dhe mundësi të barabarta për mirëqenie sociale dhe ekonomike. Përmes një qeverisjeje transparente dhe inovative, komuna synon të fuqizojë sektorin privat, të mbështesë zhvillimin ekonomik, dhe të përmirësojë standardet e jetesës, duke u bazuar në bashkëpunim me komunitetin, institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë. Me një qasje të orientuar drejt përsosmërisë në menaxhimin publik, komuna do të punojë për ruajtjen e mjedisit, nxitjen e investimeve dhe avancimin e sistemit arsimor dhe shëndetësor, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm.

Suksesi i këtij plani strategjik varet nga kreativiteti dhe angazhimi i aktorëve vendorë, përfshirë institucionet lokale, bizneset dhe shoqërinë civile. Duke e përshtatur me realitetet në terren dhe pasuruar atë me ide dhe përvoja të reja, ky dokument shndërrohet në një udhërrëfyes dinamik për zhvillimin ekonomik. Zbatimi i objektivave të tij për periudhën 2026-2030 do të kontribuojë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetesës në komunën e Fushë Kosovës.

2. METODOLOGJIA

Gjatë hartimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal (SZHEL) të komunës së Fushë Kosovës për periudhën 2026-2030, është ndjekur një qasje gjithëpërfshirëse dhe sistematike, që siguron përputhjen e dokumentit me nevojat lokale dhe zhvillimet strategjike. Procesi ka përfshirë një sërë takimesh pune të rregullta me përfaqësues të komunës dhe palët kryesore të interesit, duke garantuar angazhimin aktiv dhe reflektimin e diversitetit të perspektivave në dokumentin përfundimtar.

Lista e anëtarëve të grupit punues të komunës dhe të angazhuarve tjerë:

1. Valon Prebreza - Kryetar i Komunës së Fushë Kosovës;
2. Muhamet Tërnava - Shef i kabinetit të Kryetarit;
3. Xheneta Muzhaku - Zyrtare Administrative, Zyra e Kryetarit;
4. Pranvera Merovci — Drejtoreshë e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik, kryesuese e grupit punues;
5. Anant Termkolli - Drejtor i Drejtorisë për Infrastrukturë, zëvendëskryesues i grupit punues;
6. Vildane Latifi - Drejtoreshë e Drejtorisë për Administratë;
7. Albana Gashi - Drejtoreshë e Drejtorisë për Shëndetësi;
8. Sabri Xhigoli - Drejtor i Drejtorisë për Arsim;
9. Ylber Kelmendi - Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport;
10. Taulant Kelmendi - Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban;
11. Durim Hajra - Drejtor i Drejtorisë për Inspektorat;
12. Arton Hajruallahu - Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër;
13. Mirsad Qygalla - Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
14. Izja Mjeku - Drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Mjedis;
15. Bardhyl Koçiçi - Drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet;
16. Hasan Gjyrevci - Zyrtar i lartë për Kuvend dhe komunitete;
17. Florentina Pacolli - Zyrtare e lartë për Tatim në Pronë;
18. Shqipe Islami - Zyrtare për Buxhet dhe Financa;
19. Nurije Fazliu - Zyrtare e lartë për Integrime Evropiane;
20. Hysen Sllamniku - Udhëheqës i sektorit për Shëndetësi;
21. Vlora Berjani - Zyrtare e lartë e Arsimit;
22. Fatlum Berisha - Udhëheqës i sektorit për Sport;
23. Antigona Sahiti - Udhëheqëse e sektorit për Urbanizëm;
24. Valentin Krasniqi - Udhëheqës i sektorit për Kadastër;
25. Faik Dedinca - Udhëheqës i sektorit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural;
26. Ejup Qyqalla - Udhëheqës i sektorit për Shërbime Publike dhe Mjedis;
27. Besa Budakova - Zyrtare për ndërtim;
28. Jehona Gërguri - Zyrtare për transport rrugor;
29. Blerina Morina - Zyrtare e lartë Ligjore;
30. Ekspertë dhe konsulentë të jashtëm.

Fillimisht, është zhvilluar një plan i detajuar për hartimin e dokumentit, i cili ka përfshirë identifikimin e metodave të mbledhjes së të dhënave dhe proceset konsultative. Të dhënat janë mbledhur nga burime dytësore, si veçoritë gjeografike dhe demografike, arsimi, shëndetësia,

mirëqenia sociale, tregu i punës, infrastruktura fizike dhe telekomunikacioni, rrjeti energjetik, furnizimi me ujë të pijshëm, shërbimet administrative, kultura dhe profili ekonomik lokal i komunës. Këto të dhëna janë pasuruar përmes burimeve parësore, të mbledhura nëpërmjet intervistave të strukturuara dhe jo të strukturuara, si dhe fokus grupeve, për të siguruar një kuptim të detajuar dhe të plotë mbi gjendjen aktuale të komunës.

Strategjia e zhvillimit ekonomik lokal për komunën e Fushë Kosovës (2026-2030) është ndërtuar mbi disa politika strategjike kyçe, si:

- Strategjinë dhe Planin Kombëtar për Zhvillim 2030;
- Programi Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2030;
- Programin Kombëtar për Zbatim të Marrëveshjes për Stabilizim Asociim (MS);
- Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026;
- Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB);
- Strategjitë e Veprimit në Nivel Lokal dhe
- Udhëzuesin për hartimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal.

Figura e mëposhtme ilustron procesin e strukturuar të punës, i cili ka udhëhequr hartimin e SZHEL të komunës së Fushë Kosovës për periudhën 2026-2030.

Fig. 1 Metodologjia e punës



Ky proces ka përfshirë disa hapa kryesorë, duke siguruar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të organizuar për krijimin e dokumentit strategjik. Në fillim, u realizua identifikimi i palëve të interesit dhe organizimi i një grupi punues shumëpalësh, i cili përbëhej nga përfaqësues të komunës, komunitetit të biznesit dhe organizatave të shoqërisë civile. Ky grup punues siguroi përfaqësimin e plotë të aktorëve lokalë dhe bashkëpunimin për hartimin e strategjisë. Procesi vijoi me mbledhjen e informatave nga burime të ndryshme, duke përfshirë të dhëna demografike, ekonomike, infrastrukturore dhe sociale, të kombinuara nga burime parësore (intervista, fokus grupe) dhe burime dytësore (statistika dhe raporte kombëtare). Ky hap shërbeu si bazë për analizën strategjike.

Analiza SWOT shënoi një fazë të rëndësishme të procesit, duke identifikuar forcat, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që ndikuan në zhvillimin ekonomik të komunës. Kjo analizë u përdor për të vlerësuar potencialet ekzistuese dhe për të përcaktuar prioritetet kryesore.

Draftimi i strategjisë dhe konsultimet publike u realizuan si faza pasuese, ku aktorët lokalë dhe publiku kontribuan me sugjerime dhe komente. Këto kontribute u integruan në dokumentin final, duke e përmirësuar atë dhe duke garantuar transparencë në proces Procesi përfundoi me përgatitjen e versionit final të strategjisë dhe miratimin e saj nga organet relevante. Kjo fazë pasqyroi ndjekjen e procedurave transparente dhe përputhjen me standardet kombëtare për hartimin e dokumenteve strategjike.


Ky proces metodologjik vendosi një themel të fortë për realizimin e objektivave afatgjata, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe përforcimin e bashkëpunimit midis aktorëve lokalë. Ai siguroi mirëqenie për të gjitha grupet e interesit në komunën e Fushë Kosovës dhe një plan të strukturuar dhe gjithëpërfshirës për zbatimin e tij.

3. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT KYÇE

Deklarata e vizionit, misionit dhe vlerave kyçe të komunës së Fushë Kosovës shërbejnë si bazë për zhvillimin strategjik, duke udhëhequr vendimmarrjen dhe përcaktimin e prioriteteve për periudhën 2026-2030. Këto elemente jo vetëm që përfaqësojnë ambiciet e komunës, por gjithashtu garantojnë një qasje të qartë dhe të qëndrueshme për të përmirësuar jetën e qytetarëve dhe për të krijuar një mjedis të favorshëm për investime.

Vizioni për komunën e Fushë Kosovës synon ta shndërrojë atë në një qendër ekonomike të zhvilluar, me një administratë moderne komunale, mjedis të pastër, infrastrukturë të avancuar, shërbime shëndetësore cilësore, popullatë të arsimuar dhe një hapësirë atraktive për jetë dhe investime.

Deklaratat e vizionit dhe misionit të komunës së Fushë Kosovës, janë prezantuar në vijim.




Pra, vizioni i komunës së Fushë Kosovës është: "*Fushë Kosova – një komunë moderne, konkurruese, gjithëpërfshirëse dhe e qëndrueshme; qendër dinamike e zhvillimit ekonomik dhe e investimeve, me potencial të fuqishëm logjistik, infrastrukturë funksionale, arsim dhe shëndetësi cilësore, administratë efikase e transparente dhe cilësi të lartë të jetës për të gjithë qytetarët".* Ndërsa, misioni i saj është: "*Komuna e Fushë Kosovës është e përkushtuar për të krijuar një mjedis të zhvilluar, të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, ku qytetarët përfitojnë nga shërbime cilësore, infrastruktura moderne dhe mundësi të barabarta për mirëqenie sociale dhe ekonomike. Përmes një qeverisjeje transparente dhe inovative, komuna synon të fuqizojë sektorin privat, të mbështesë zhvillimin ekonomik, dhe të përmirësojë standardet e jetesës, duke u bazuar në bashkëpunim me komunitetin, institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë. Me një qasje të orientuar drejt përsosmërisë në menaxhimin publik, komuna do të punojë për*

ruajtjen e mjedisit, nxitjen e investimeve dhe avancimin e sistemit arsimor dhe shëndetësor, duke siguruar një zhvillim të qëndrueshëm për brezat e ardhshëm."

Vlerat kyçe të komunës së Fushë Kosovës janë: ***Zhvillimi ekonomik dhe inovacioni*** (mbështetja e bizneseve dhe nxitja e investimeve për një ekonomi konkurruese dhe të qëndrueshme), ***komunikimi dhe pjesëmarrja*** (nxitja e dialogut dhe përfshirjes aktive të qytetarëve në vendimmarrje), ***integriteti dhe transparenca*** (qeverisje e ndershme, e hapur dhe e përgjegjshme, duke garantuar besimin e qytetarëve), ***qëndrueshmëria dhe mbrojtja e mjedisit*** (zhvillimi i ekuilibruar dhe mbrojtja e burimeve natyrore për një mjedis të shëndetshëm), ***profesionalizmi dhe efikasiteti*** (ofrimi i shërbimeve publike me kompetencë dhe përkushtim, duke siguruar standarde të larta) dhe ***mirëqenia sociale dhe barazia*** (krijimi i një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës, duke garantuar mundësi të barabarta për të gjithë).

Fig. 2 Vlerat kyçe të komunës së Fushë Kosovës



4. ANALIZA E GJENDJES SOCIO-EKONOMIKE

Kjo pjesë paraqet një pasqyrë të gjendjes socio-ekonomike në komunën e Fushë Kosovës. Më konkretisht, janë prezantuar të dhëna mbi pozitën dhe karakteristikat gjeografike të komunës, popullsinë, vendbanimet, migracionin, arsimin, shëndetësinë, mirëqenien sociale, shërbimet administrative, infrastrukturën, telekomunikacionin dhe kulturën. Gjithashtu, në vijim janë paraqitur buxheti komunal dhe profili ekonomik i komunës.

HISTORIK I SHKURTËR I KOMUNËS – Komuna e Fushë Kosovës, e themeluar në vitin 1988, ndodhet në qendër të Rrafshit të Kosovës, vetëm 7 kilometra larg kryeqytetit të Kosovës, Prishtinës. E njohur për pozicionin e saj strategjik, këtë komunë e ka përshkuar rruga antike "*Via Ignatia*", duke luajtur një rol të rëndësishëm historik dhe ekonomik.[2]

Fushë Kosova ka qenë një nyje e rëndësishme hekurudhore, nëpër të cilën ka kaluar rruga e lashtë ilire "Via Ignatia", që lidhte Bizantin me Kostandinopojën. Ky territor ka qenë banim i hershëm për banorët iliro-dardanë, dhe është gërshetuar me vendbanimet e vjetra antike, si Harilaçi, Bardhoshi, Maja e Zezë, dhe Uglari (Ulari).[3]

Fushë Kosova është një komunë dhe qytezë e vendosur në pjesën qendrore të Kosovës, e cila bën pjesë në Regjionin e Prishtinës. Kjo komunë u formua në vitin 1988, duke u ndarë nga territori i atëhershëm i Komunës së Prishtinës. Në ditët e sotme, Fushë Kosova shquhet si një nga komunat më dinamike të vendit, duke përjetuar ndryshime të mëdha urbanistike dhe zhvillim të konsiderueshëm.

Strukturat demografike të komunës kanë evoluar ndjeshëm gjatë dekadave të fundit. Veçanërisht pas trazirave të marsit, një pjesë e popullsisë serbe u vendos kryesisht në fshatrat Uglare, Bresje dhe Graçanicë.

Historikisht, pozita gjeografike e favorshme, kushtet natyrore dhe klima e përshtatshme kanë mundësuar zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme, si bujqësia, blegtoria dhe gjuetia, ndërsa relievi i sigurt e ka bërë këtë territor tërheqës për banim që nga lashtësia.

Gjurmimet arkeologjike të kryera në këtë rajon tregojnë për një histori të pasur dhe të lashtë, duke dëshmuar praninë e banorëve që në lashtësi. Relievit i saj strategjik dhe burimet natyrore e kanë bërë këtë zonë tërheqëse për banim që në periudha të hershme historike. Lokalitetet si Bardhi i Madh, Harilaçi dhe Uglari kanë ruajtur gjurmë të rëndësishme nga banorët iliro-dardanë, që datojnë nga shekulli VII p.e.r. dhe periudha e neolitit. Gjurmët e banimit vazhduan gjatë periudhës antike dhe mesjetare, duke përfshirë vendbanime si Kumanova pranë Vragolisë, Bardhi i Vogël dhe Uglari.

Gjatë historisë, ky territor ka qenë dëshmitar i ngjarjeve të rëndësishme. Nga fundi i shekullit XII, territori ra nën pushtimin serb, ndërsa në shekullin XIV kaloi nën sundimin osman. Një nga

[2] Strategjia e zhvillimit lokal ekonomik 2015-2020, fq. 9.
[3] Draft-plani zhvillimor komunal i Fushë Kosovës 2024-2032, fq. 44.

ngjarjet historike më të spikatura është Lufta e Dytë e Kosovës, e cila u zhvillua në vitin 1448 në Livragoli (Vragoli), ku u përballën ushtritë osmane dhe hungareze.

Përveç kësaj, gjysma e dytë e shekullit XIX shënoi një valë migrimi kur familje çerkeze, të larguara nga Kaukazi, u vendosën në këtë rajon, duke i shtuar diversitetin kulturor. Disa prej këtyre familjeve gjetën strehë në fshatra si Sllatina e Madhe, Miradi e Epërme, Bardhi i Madh dhe Uglar.[4] Kohëve të fundit, janë identifikuar varreza historike në Gurshkabë, të cilat kanë rëndësi jo vetëm për komunën, por edhe për Kosovën në tërësi, duke vërtetuar lashtësinë e kësaj treve.[5]

Fushë Kosova vazhdon të luajë një rol kyç në zhvillimin urban dhe ekonomik të rajonit, duke mbrojtur dhe promovuar trashëgiminë e saj historike dhe kulturore. Njëkohësisht, ajo spikat si një nyje e rëndësishme transporti hekurudhor, duke shërbyer si pikë strategjike lidhëse për gjithë territorin e Kosovës. Për më tepër, është planifikuar që përmes territorit të komunës të kalojë autostrada Morinë-Merdar, një projekt që pritet të forcojë ndjeshëm lidhjet rajonale dhe të nxisë zhvillimin ekonomik.

Sot, komuna e Fushë Kosovës përbëhet nga qyteti dhe gjithsej 15 vendbanime tjera.

POZITA DHE VEÇORITË GJEOGRAFIKE – Fusha e Kosovës është një nga formacionet më të spikatura gjeografike në Republikën e Kosovës, duke përfshirë një reliev të sheshtë, të përbërë nga fushëgropa, lugina lumore dhe formacione të tjera natyrore. Ky terren i lëshuar krijon kushte të favorshme për bujqësinë dhe veprimtaritë e tjera ekonomike të zonës.

Në perëndim të komunës së Fushë Kosovës ngrihen malet qendrore të Kosovës, ku shquhen Goleshi dhe Gospoja, me lartësi që variojnë nga 800 deri në 1,200 metra. Relievi i komunës përmban një kombinim të hapësirave të rrafshëta dhe kodrinore-malore, duke ofruar një mjedis të shumëllojshëm për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore dhe blegtorale. Fushë Kosova gëzon një pozitë të favorshme gjeografike, kushtet e përshtatshme klimatike dhe burime natyrore të pasura, që krijojnë mundësi të mira për zhvillimin e gjuetisë, blegtorisë dhe bujqësisë. Me investimet e duhura, këto sektorë mund të zgjerohen dhe të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të rajonit.[6]

Komuna e Fushë Kosovës është e pozicionuar afër koordinatave gjeografike 42°63’ veri dhe 21°12’ lindje, duke mbuluar një sipërfaqe prej rreth 99 km^2. Në përbërje të saj përfshihen këto njësi kadastrale: Fushë Kosovë, Albanë e Vogël, Albanë e Madhe, Bardh i Madh, Bardh i Vogël, Mesbardh, Harilaq, Henc, Gurshkabë, Miradi e Poshtme, Miradi e Epërme, Livragonë, Lismir, Nakaradë dhe Kuzmin. Pas miratimit të propozimit të Ahtisaarit nga Kuvendi i Kosovës, fshatrat Uglarë dhe Batuse u ndanë nga territori i komunës, duke ndryshuar përbërjen e saj.

Historikisht, territori i Fushë Kosovës, sipas të dhënave të vitit 1987, përfshinte 16 zona kadastrale me një sipërfaqe prej 9,573 ha, 63 ari dhe 24 m^2, ekuivalente me rreth 96 km^2. Komuna e Fushë Kosovës ndodhet në qendër të Rrafshit të Kosovës dhe shtrihet në perëndim të

[4] https://sq.wikipedia.org/wiki/Fush%C3%AB_Kosova
[5] Draft-plani zhvillimor komunal i Fushë Kosovës 2024-2032, fq. 44.
[6] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 11-12.

Prishtinës, rreth 4-5 kilometra larg. Për shkak të zhvillimit urbanistik, aktualisht është pothuajse e bashkuar me kryeqytetin.

Fig. 3 Pozita gjeografike e komunës së Fushë Kosovës



Në aspektin kufitar, kjo komunë shtrihet në lindje pranë Komunës së Prishtinës, në veri kufizohet me Komunën e Kastriotit, në jug me Komunën e Lipjanit, dhe në perëndim me Komunën e Drenasit.

Fushë Kosova është një nyje kryesore e transportit hekurudhor në Kosovë, me lidhje hekurudhore që degëzohen nga qendra komunale drejt Mitrovicës në veri, Shkupit në jug, Prishtinës dhe trevës së Llapit në verilindje, si dhe drejt Pejës në perëndim dhe Prizrenit në jugperëndim. Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, i ndodhur në fshatin Albanë e Madhe (Sllatinë e Madhe), u hap në vitin 1965 dhe e ka bërë këtë komunë një qendër të rëndësishme të transportit ajror në Kosovë.[7]

Rrjeti hidrografik i Komunës së Fushë Kosovës është i formuar në harmoni me rënien e relievit, duke drejtuar ujërat në drejtim verior. Ky rrjet përfshin lumenjtë, akumulimet sipërfaqësore dhe përrenj me rrjedhje të përhershme dhe të përkohshme, të cilët derdhen në lumin Sitnica, që është ujëmbledhësi kryesor i komunës. Lumenjtë kryesorë të kësaj zone janë Sitnica, Drenica, Graçanka dhe Prishtevka, të cilët përshkojnë territorin e komunës. Përveç tyre, komuna ka disa përrocka të rëndësishme, si Gjelbëzaku dhe Zanoga. Një vlerë e madhe për biodiversitetin e zonës është edhe liqeni-akumulacioni sipërfaqësor në fshatin Henc.

Lumi Sitnica kalon përmes pjesës qendrore të komunës dhe është lumi më i madh i rajonit për nga madhësia e pellgut dhe prurja mesatare e ujit. Karakterizohet si lumë fushor, me një shtrat gjarpërues të formuar në rrafshinat aluviale. Përshkon rreth 80% të Boshtit Gjatësor të Pellgut Qymyror të Kosovës dhe rrjedh nga jugu në lindje. Sitnica është një lumë tipik i rrafshët dhe pa shtrat të qëndrueshëm, ku reshjet atmosferike ndikojnë në daljen e tij nga shtrati dhe përmbytjen e sipërfaqeve përreth. Në rrugëtimin e tij, ai mbledh ujërat e lumenjve Gadime, Janjevë, Prishtevkë, Graçankë dhe Llapi nga e djathta, ndërsa nga e majta Samadregjë, Lushtë dhe Drenicë.

Lumi Drenica është një degë e majtë e Sitnicës dhe përshkon komunën duke kaluar nëpër fshatrat Graboc i Poshtëm, Bardh i Madh, Pomazotin, Bardh i Vogël dhe Vragoli, ku derdhet në Sitnicë. Pellgu i tij është 477 km^2, ndërsa gjatësia prej burimit deri në derdhje është 50 km.

[7] https://sq.wikipedia.org/wiki/Fush%C3%AB_Kosova

Karakterizohet si lumë fushor me pjerrësi të vogël, por ngushtohet në rrjedhën e tij drejt Sitnicës. Prurja mesatare e ujit në derdhjen e tij është 2 m^3/s.

Lumi Graçanka është një degë e djathtë e Sitnicës, me burim në majën Zllash në një lartësi prej 1,210 metrash mbi nivelin e detit dhe me një gjatësi prej 34 km. Në pjesën e sipërme, ai ka rrjedhje të shpejtë dhe pjerrësi të theksuar, ndërsa në vendin e derdhjes fiton tiparet e një lumi fushor.

Lumi Prishtevka buron midis maleve Prugovc dhe Kozmik dhe ka një gjatësi prej 26.5 km. Në pjesën e sipërme është lumë malor, me një shtrat të ngushtë dhe të thellë, ndërsa duke kaluar nëpër Llukar dhe Bresje të Fushë Kosovës, shtrati i tij zgjerohet dhe rrjedha bëhet më e qetë. Prishtevka derdhet në Sitnicë afër fshatit Vragoli.[8]

Përveç tyre, ujërat nëntokësorë të komunës pasurojnë burimet e saj natyrore, duke përfshirë Kroin e Malit në Sllatinë të Madhe, Kroin e Spahisë në Harilaç dhe burimet e fshatit Kroj-Ish Kuzmini. Këto burime ujore përbëjnë një element të rëndësishëm natyror për territorin e Fushë Kosovës, duke krijuar mundësi të mëdha për zhvillimin e bujqësisë dhe aktiviteteve ekonomike, si dhe për ruajtjen e një ekosistemi të qëndrueshëm. Lumenjtë dhe burimet e ujit luajnë një rol kyç në strukturimin e fizionomisë së peizazhit të komunës dhe në përdorimin e qëndrueshëm të tokave të saj pjellore.[9] [10]

Klima: Komuna Fushë Kosovës ndodhet në pjesën jugore të brezit të mesëm gjeografik të hemisferës veriore dhe ndikohet nga një kombinim i faktorëve klimatikë mesdhetarë dhe kontinentalë evropianë. Klima e saj formësohet nga disa makrofaktorë të rëndësishëm, përfshirë pozicionin gjeografik ndaj masave tokësore si Euroazia dhe Afrika, masat ujore si Oqeani Atlantik dhe Deti Mesdhe, si dhe masat e ajrit, që përfshijnë ato tropikale dhe arktike, me ndikime maritime apo kontinentale. Gjithashtu, pozita e sistemeve barike, si maksimumi i Azoreve dhe minimumi i Islandës, ka një rol të rëndësishëm në modelimin e kushteve klimatike të zonës.

Përveç faktorëve të gjerë klimatikë, klima e Fushë Kosovës ndikohet edhe nga faktorë lokalë si relievi, ujërat, trualli dhe bimësia, të cilët krijojnë variacione të klimës brenda territorit të komunës dhe ndikojnë në biodiversitetin dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore.[11]

Komuna e Fushë Kosovës karakterizohet nga një klimë mesatare kontinentale, e cila përfshin temperatura mesatare vjetore prej 9.8°C dhe reshje atmosferike vjetore mesatarisht 628 mm. Periudha e thatësisë zakonisht shtrihet gjatë muajve të verës, përkatësisht korrikun, gushtin dhe shtatorin, me temperaturat e larta dhe kushtet e thata të këtyre stinëve. Dimrat në këtë komunë

[8] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 19-20.
[9] Strategjia e zhvillimit lokal ekonomik 2015-2020, fq. 9.
[10] https://sq.wikipedia.org/wiki/Fush%C3%AB_Kosova
[11] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 18.


janë të ftohtë dhe relativisht të lagësht, ndërsa pranvera dhe vjeshta shfaqin ndryshueshmëri të lartë klimatike.[12] [13]

Fushë Kosova ka mesatarisht 2,066 orë me diell gjatë vitit, ku Prishtina, që i referohet edhe territorit të kësaj komune, regjistron 2,140 orë diellore. Muaji korrik shënon rrezatimin më të lartë, ndërsa dhjetori ka më pak ekspozim ndaj diellit.

Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është 71.4%, me një maksimum prej 84% në dhjetor dhe një minimum prej 63% në korrik. Ndërkohë, vlera mesatare vjetore e shtypjes së avullit të ujit është 9.5 mb, ku vlera më e lartë regjistrohet në korrik me 14.4 mb, ndërsa më e ulëta në janar me 5.0 mb. Temperaturat dhe lagështia e ajrit janë monitoruar në pellgun e lumit Sitnicë, duke siguruar të dhëna të rëndësishme për karakteristikat klimatike të zonës.[14]

POPULLSIA - Sipas regjistrimit më të fundit të vitit 2024, Komuna e Fushë Kosovës numëron gjithsej **63,949 banorë**. Të dhënat e regjistrimeve të popullsisë në këtë komunë, që përfshijnë periudhën nga viti 1948 deri në vitin 2024, janë prezantuar në grafikonin nr. 1.


Statistikat e popullsisë së Komunës së Fushë Kosovës tregojnë një ndryshim të dukshëm gjatë periudhës 1948-2024. Nga 1948 deri në 1961, popullsia ka shënuar një rritje prej 57.1%, duke reflektuar një zhvillim gradual demografik. Më pas, periudha ndërmjet 1961 dhe 1981 shfaqi një rritje të përshpejtuar prej 155.1%, duke treguar për një migrim intensiv dhe zhvillim urban.



Ndërkohë, nga 1981 deri në 2011, ritmi i rritjes u ngadalësua, me një rritje prej vetëm 22.8%, që reflekton ndikimin e kushteve socio-politike dhe ekonomike. Së fundmi, periudha 2011-2024 shënoi një rritje të konsiderueshme prej 82.3%, duke treguar një stabilizim dhe zhvillim të shpejtë urban, që ndikoi në dyfishimin e popullsisë brenda më pak se 15 vjetësh. Këto statistika pasqyrojnë faza të dallueshme të rritjes demografike dhe transformimeve të rëndësishme në këtë komunë.

[12] Strategjia e zhvillimit lokal ekonomik 2015-2020, fq. 9.
[13] https://sq.wikipedia.org/wiki/Fush%C3%AB_Kosova
[14] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 18-19.

Graf. 1 Popullsia në komunën e Fushë Kosovës sipas regjistrimeve, periudha 1948-2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia sipas vendbanimeve në komunën e Fushë Kosovës, 1948-2024*


Dendësia: Dendësia e popullsisë në komunën e Fushë Kosovës është 420 banorë në 1 km^2, duke e bërë atë një nga komunat me zhvillim të shpejtë demografik. Paslufta solli një valë të madhe zhvendosjesh, ku shumë qytetarë e zgjodhën këtë zonë si vendbanim për shkak të afërsisë me Prishtinën dhe mundësive për zhvillim ekonomik. Bazuar në analizat e kryera mbi trendet demografike dhe zhvillimin urban, pritet që ky ritëm i rritjes së popullsisë të vazhdojë për dhjetë vitet e ardhshme, duke ndikuar në planifikimin e infrastrukturës dhe shërbimeve publike.[15]

Shtimi natyror: Analiza e shtimit natyror për komunën e Fushë Kosovës pasqyron një rritje të konsiderueshme të popullsisë për periudhën 1948-2024, ku komuna e ka tetëfishuar popullsinë e saj. Duke krahasuar regjistrimet, në vitin 2024 u raportua një rritje prej 83.6% krahasuar me vitin 2011, duke reflektuar zhvillimin intensiv dhe potencialin demografik të zonës.

Në analizën për vitet e fundit, statistikat për periudhën 2022-2024 nga Agjencia e Statistikave të Kosovës tregojnë ndryshime të dukshme në treguesit demografikë. Në vitin 2023, shtimi natyror pësoi një rënie prej 26.4% krahasuar me vitin 2022, ndërsa në vitin 2024 u shënua një rritje prej 38.0%. Po ashtu, nataliteti ra me 19.3% në vitin 2023, por më pas pati një rritje prej 25.6% në vitin 2024. Ndërkohë, mortaliteti shënoi një rënie prej 2.5% në vitin 2023 krahasuar me vitin 2022, por në vitin 2024 u regjistrua një rritje prej 3.5% krahasuar me vitin 2023. Këto të dhëna pasqyrojnë dinamika komplekse që ndikojnë drejtpërdrejt në strukturën demografike të komunës, duke theksuar luhatjet e dukshme në trendet e lindshmërisë, vdekshmërisë dhe shtimit natyror.

[15] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 11.


Graf. 2 Shtimi natyror në komunën e Fushë Kosovës, periudha 2022-2024



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Popullsia e Kosovës dhe shtimi natyror në nivel të komunave, 2022-2024.*

Struktura gjinore: Sa i përket strukturës gjinore në këtë komunë, ka pak diferencë. Sipas regjistrimit të vitit 2024, 49.80% (31,847) janë meshkuj, ndërsa 50.20% (32,102) janë femra.


Graf. 3 Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Fushë Kosovës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Fushë Kosovës sipas gjinisë 2024.*

Struktura etnike: Struktura etnike e popullsisë në Komunën e Fushë Kosovës është kryesisht homogjene, ku 91.32% e popullsisë janë shqiptarë. Grupet e tjera etnike përfshijnë ashkalinj me 5.04%, egjiptianë me 1.33%, serbë me 0.81%, si dhe 1.50% të tjerë që përfshijnë romë, turq, boshnjakë, goranë, etj. Për një pasqyrë të plotë, etnicitetet dhe pjesëmarrja e tyre në përqindje janë paraqitur në mënyrë grafike në figurën që vijon, duke përfaqësuar ndarjen totale prej 100%.


Graf. 4 Struktura etnike e popullsisë në komunën e Fushë Kosovës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Fushë Kosovës sipas etnicitetit 2024*.

Struktura religjioze: Struktura religjioze e popullsisë në Komunën e Fushë Kosovës është kryesisht homogjene. Sipas të dhënave të fundit të vitit 2024, 96.07% e banorëve i përkasin besimit islam, ndërsa grupet tjera përfaqësohen me përqindje më të vogla: 0.85% i përkasin besimit ortodoks dhe 0.39% besimit katolik. Përveç këtyre, 2.69% e popullsisë nuk janë deklaruar ose u përkasin besimeve të tjera. Për një pasqyrë më të detajuar, figura që vijon paraqet grafikisht përqindjet e këtyre grupeve fetare në ndarjen totale prej 100%.

Graf. 5 Struktura religjioze e popullsisë në komunën e Fushë Kosovës




Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Fushë Kosovës sipas religjionit 2024*.

Struktura moshore: Komuna e Fushë Kosovës shfaq një strukturë moshore të re dhe dinamike, ku një pjesë e madhe e popullsisë, rreth 41%, janë nën moshën 24 vjeçare. Kjo dëshmon për një bazë solide rinore, e cila mund të jetë vendimtare për zhvillimin e qëndrueshëm të komunës në aspektin ekonomik dhe social.

Në krahasim, vetëm 7.7% e popullsisë i përkasin grupmoshave 65 vjeç e tutje, të cilat konsiderohen si jo aktive për tregun e punës. Kjo përqindje e vogël sugjeron një strukturë demografike ku pjesa më e madhe e popullsisë është në grupmoshat potencialisht aktive dhe produktive. Për detaje të mëtejshme dhe ndarjen e saktë të çdo grupmoshe, figura në vijim paraqet këto të dhëna në mënyrë grafike.

Graf. 6 Struktura moshore e popullsisë në komunën e Fushë Kosovës



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Fushë Kosovës sipas grupmoshës 2024*.

VENDBANIMET - Komuna e Fushë Kosovës përbëhet nga gjithsej 16 vendbanime, ku pjesa më e madhe e tyre kanë popullsi relativisht të vogël. Tetë nga këto vendbanime numërojnë më pak se 1,000 banorë. Qyteti i Fushë Kosovës është vendbanimi më i madh në këtë komunë, me 40,962 banorë, duke e bërë atë qendrën kryesore urbane të zonës.

Gjithashtu, struktura e shtrirjes së popullsisë tregon për një dominim të zonës urbane, ku jetojnë 64% e banorëve të komunës, ndërsa vetëm 36% e popullsisë janë të vendosur në zona rurale. Ky trend pasqyron urbanizimin e intensifikuar dhe ndikimin e tij në shtrirjen dhe përqendrimin demografik të popullsisë.

Numri total i ekonomive familjare në Komunën e Fushë Kosovës arrin në 16,085, duke treguar një shpërndarje të ndryshme ndërmjet vendbanimeve. Qyteti i Fushë Kosovës përmban numrin më të madh të ekonomive familjare, me 11,034, ndërsa vendbanimet më të vogla regjistrojnë numra minimalë deri në 94 ekonomi familjare. Kjo ndarje tregon për një përqendrim të lartë të

familjeve në zonën urbane krahasuar me zonat rurale. Për të parë më shumë detaje mbi shpërndarjen specifike, shih tabelën që vijon.

Fig. 4 Pamje e qytetit të Fushë Kosovës



Tab. 1 Popullsia e komunës së Fushë Kosovës sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare


Nr.	VENDBANIMI	POPULLSIA	EKONOMITË FAMILJARE
1	Bardh i Madh	2,434	548
2	Bardh i Vogël	468	94
3	Bresje	7,606	1,666
4	Fushë Kosovë	40,962	11,034
5	Graboc i Poshtëm	758	169
6	Harilaç	669	142
7	Henc	560	113
8	Kuzmin	475	143
9	Lismir	672	148
10	Miradi e Epërme	1,312	283
11	Miradi e Poshtme	1,579	330
12	Nakaradë	2,336	542
13	Pomazotin	742	165
14	Sllatinë e Madhe	1,608	339
15	Sllatinë e Vogël	531	112
16	Vragoli	1,237	257
	Gjithsej	**63,949**	**16,085**

Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Fushë Kosovës sipas vendbanimit dhe ekonomive familjare 2024*.

Bazuar në të dhënat mbi popullsinë e Komunës së Fushë Kosovës, 16 vendbanimet mund të kategorizohen sipas madhësisë demografike si më poshtë: një vendbanim (6.25%) ka mbi 40,000 banorë, 1 (6.25%) ka ndërmjet 5,000-9,999 banorë, 2 vendbanime (12.5%) kanë ndërmjet 2,000-4,999 banorë, 4 (25.0%) kanë nga 1,000-1,999 banorë, 6 (37.5%) kanë ndërmjet 500-999 banorë, dhe 2 vendbanime (12.5%) ka më pak se 500 banorë.

Kjo ndarje e vendbanimeve sipas madhësisë së popullsisë reflekton shpërndarjen e qartë demografike dhe dominimin e popullsisë urbane në qytetin e Fushë Kosovës, i cili përfaqëson shumicën dërrmuese të popullsisë. Për detaje më të hollësishme, referojuni grafikonit dhe tabelës n vijim.

Graf. 7 Kategorizimi i vendbanimeve në komunën e Fushë Kosovës



Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Fushë Kosovës mund të kategorizohen si në vijim.


Tab. 2 Klasifikimi i vendbanimeve në komunën e Fushë Kosovës

Deri në 500 banorë	500-999 banorë	1,000-1,999 banorë	2,000-4,999 banorë	Mbi 5000 banorë
Kuzmin Bardh i Vogël	Graboc i Poshtëm Pomazotin Lismir Harilaç Henc Sllatinë e Vogël	Sllatinë e Madhe Miradi e Poshtme Miradi e Epërme Vragoli	Bardh i Madh Nakaradë	Fushë Kosovë Bresje

Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Fushë Kosovës sipas vendbanimit, 2024.*

Në vijim është paraqitur grafikisht, numri i popullsisë sipas vendbanimeve, bazuar në regjistrimet 1948-2024.

Graf. 8 Regjistrimi i popullsisë sipas vendbanimeve, 1948-2024



Burimi: ASKDATA: *Popullsia e komunës së Fushë Kosovës sipas vendbanimit, 1948-2024*.

Nga gjithsej 16 vendbanimet e komunës së Fushë Kosovës, shumica kanë shënuar rënie të ndjeshme në regjistrimin e vitit 2024 krahasuar me atë të vitit 2011. Megjithatë, qyteti i Fushë Kosovës ka shënuar një rritje të konsiderueshme prej rreth 217%, ndërsa Nakarada (55%), Bresja (36%) dhe Kuzmini (42%) gjithashtu kanë shënuar rritje.

MIGRIMI - Migrimi përfaqëson procesin e lëvizjes së njerëzve nga një vend në tjetrin, i motivuar nga qëllime të ndryshme, si vendosja e përkohshme apo e përhershme. Ky fenomen ka ndikim të thellë mbi kulturën, mënyrën e jetesës dhe orientimin politik të një kombi.



Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në komunën e Fushë Kosovës migrimi kombëtar gjatë vitit 2024 ka shënuar një rritje prej 5% krahasuar me vitin 2023. Ndërkohë, viti 2023 kishte regjistruar një rritje jashtëzakonisht të lartë prej rreth 360% në krahasim me vitin 2022.

Nga ana tjetër, migrimi ndërkombëtar ka pasur luhatje të mëdha në përqindje gjatë periudhës së fundit. Në vitin 2023, bilanci negativ u ul me rreth 97% krahasuar me vitin 2022, duke kaluar nga -1,489 në -46. Ky ishte një përmirësim i dukshëm, që tregonte një afrim mes imigrimit dhe emigrimit. Megjithatë, në vitin 2024, bilanci negativ u rrit me rreth 285% krahasuar me vitin 2023, duke kaluar nga -46 në -177. Ky ndryshim tregon një përkeqësim të bilancit të migrimit ndërkombëtare pas stabilizimit të vitit 2023.

Tab. 3a Migrimi kombëtar në komunën e Fushë Kosovës, periudha 2022-2024

Migrimi kombëtar	2022	2023	2024
Imigrimi	995	4,303	4,518
Emigrimi	208	688	722
Bilanci i migrimit kombëtar	**787**	**3,615**	**3,796**

Tab. 3b Migrimi ndërkombëtar në komunën e Fushë Kosovës, periudha 2022-2024

Migrimi ndërkombëtar	2022	2023	2024
Imigrimi	593	442	683
Emigrimi	2,082	488	860
Bilanci i migrimit ndërkombëtar	**-1,489**	**-46**	**-177**

Burimi: ASKDATA: *Gjithsej popullsia e Kosovës dhe migrimi, 2022 – 2024.*

ARSIMI – Arsimi në Kosovë luan një rol kyç në ndërtimin e një shoqërie të zhvilluar dhe gjithëpërfshirëse. Ai jo vetëm që ofron mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët, por kontribuon edhe në fuqizimin e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Institucionet e arsimit, nga ai fillor deri tek arsimi i lartë, janë të fokusuara në përgatitjen e të rinjve për sfidat e kohës moderne.[16]

Sistemi arsimor në Kosovë: Sistemi arsimor në Kosovë përbëhet nga arsimi parashkollor, fillor, i mesëm dhe i lartë, duke u fokusuar në zhvillimin e njohurive dhe aftësive për të gjitha grupmoshat. Arsimi fillor dhe i mesëm janë obligative, duke garantuar përfshirjen e çdo fëmije në procesin mësimor. Arsimi i lartë ofron mundësi për avancim profesional dhe akademik për të rinjtë. Megjithëse ka sfida si infrastruktura dhe cilësia e mësimdhënies, përpjekjet për përmirësimin e kurrikulave dhe përfshirjen sociale vazhdojnë. Arsimi mbetet shtyllë kryesore për zhvillimin e vendit dhe krijimin e një shoqërie të arsimuar e konkurente në nivel ndërkombëtar.


[16] ASKDATA: *Institucionet shkollore sipas niveleve, 2023/2024*.

Që nga viti 2002, sistemi arsimor në Kosovë funksionon sipas modelit 5+4+3. Ky model përfshin 5 vite arsimi fillor, të ndjekura nga 4 vite shkollim të mesëm të ulët dhe 3 ose 4 vite shkollim të mesëm të lartë.

Struktura arsimore në Komunën e Fushë Kosovës ndjek modelin e tri niveleve: arsimi fillor (klasat I–V), arsimi i mesëm i ulët (klasat VI–IX) dhe arsimi i mesëm i lartë (klasat X–XII). Brenda kësaj komune, arsimi është i organizuar në 17 institucione shkollore, duke përfshirë një çerdhe, 13 shkolla të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, si dhe 3 shkolla të arsimit të mesëm të lartë. Në këtë komunë ka edhe një çerdhe publiko-privte dhe 31 çerdhe private.

Bazuar në të dhënat e komunës, mungesa e hapësirave shkollore po e vështirëson organizimin e mësimit parashkollor në qytet, ndërsa në zonat rurale ky nivel arsimor është i organizuar në 10 shkolla. Aktualisht, në Fushë Kosovë po ndërtohen dy shkolla fillore dhe një qerdhe, me synimin për të zgjeruar kapacitetet arsimore dhe përmirësuar qasjen në edukimin parashkollor. Ndërkohë, mbingarkesa e objekteve mësimore në qytet për shkak të rritjes së numrit të nxënësve e bën ndërtimin e një shkolle fillore një prioritet urgjent.

Arsimi parashkollor dhe parafillor: Sipas të dhënave dhe statistikave nga ASK, në komunën e Fushë Kosovës ka një çerdhe për fëmijët e moshës nën 5 vjet. Mirëpo, në shumicën e shkollave fillore në vend ofrohet arsimim njëvjeçar parashkollor për fëmijët e moshës 5 dhe 6 vjeçare.



Burimi i njëjtë qet në pah një numër të vogël që kanë vijuar arsimin parashkollor. Në vitin 2022/2023, 143 fëmijë. Ndërsa, në vitin vijues (2023/2024), kanë vijuar mësimin 138 fëmijë. Vërehet një rënie prej 3.5 % në vitin e fundit (në vitin 2023/2024 mesatarja e parashkollorëve ishte 9.4, në nivel vendi).

Numri i mësimdhënësve për periudhën 2023-2024 për nivelin parashkollor ishte 22. Rrjedhimisht raporti mesatar nxënës/mësimdhënës për këtë periudhë është 6.3 (i favorshëm krahasuar me 16 në në nivel vendi).

Arsimin parafillor në vitin 2022/2023, e kanë ndjekur 150 nxënës. Në vitin 2023/2024, këtë nivel e kanë ndjekur 140 nxënës. Vërehet një rënie prej 6.7% në vitin e fundit.

Arsimi fillor/i mesëm i ultë: Bazuar në statistikat e ASK-së për komunën e Fushë Kosovës, këtë nivel arsimi në vitin shkollor 2022/2023 e kanë ndjekur 8,334 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 2023/2024, 8,645 nxënës. Siç shihet ka pasur një rritje prej 3.7% nga viti në vit.

Në vitin shkollor 2023/2024 raporti nxënës për paralele në komunën e Fushë Kosovës ishte 26.2, kundrejt 16.91 në nivel vendi.

Numri i mësimdhënësve për periudhën 2023-2024 për nivelin parafillor dhe të mesëm të ultë ishte 372. Rrjedhimisht raporti mesatar nxënës/mësimdhënës për këtë periudhë është 23.2 (i pafavorshëm kundrejt mesatares 13 në nivel vendi).


Arsimi i mesëm i lartë: Këtë nivel arsimi në vitin 2022/2023 e kanë ndjekur 1,375 nxënës. Në vitin 2023/2024, 1,323 nxënës. Ka një më rënie prej 3.8% nga viti në vit. Prej tyre, në vitin

2023/2024, 658 nxënës (50.3%) u takojnë gjimnazeve, ndërsa, 665 (49.7%) shkollave profesionale.

Në vitin shkollor 2023/2024 raporti nxënës për paralele në komunën e Fushë Kosovës ishte 28.1, kundrejt 20.2 në nivel vendi.

Numri i mësimdhënësve për periudhën 2023-2024 për nivelin e mesëm të lartë ishte 76. Rrjedhimisht raporti mesatar nxënës/mësimdhënës për këtë periudhë është 17.4 (më i lartë se mesatarja 12 në nivel vendi).

Graf. 9 Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare në komunën e Fushë Kosovës, 2019-2024



Burimi: ASKDATA: *Numri i nxënësve në institucionet publike parauniversitare, 2019-2024.*

Siç shihet në grafikun e mësipërm, ka rritje të numrit të nxënësve nga viti në vit për periudhën e analizuar, mesatarisht 3.8%.

Bazuar në të dhënat nga ASK (2023-2024), raporti mesatar nxënës/mësimdhënës sipas niveleve në arsimin publik është:

- Arsimi parashkollor: 9.4;
- Arsimi parafillor: 16;
- Arsimi fillor/i mesëm i ultë: 13.0;
- Arsimi i mesëm i lartë: 12.

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) krijon një kornizë bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian (BE) për përmirësimin e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet. Kjo marrëveshje synon zhvillimin e aftësive, rritjen e mundësive për punësim, përfshirjen sociale dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik të vendit. Një element i rëndësishëm i MSA-së është fokusi i

saj në sigurimin e gjithëpërfshirjes dhe barazisë në arsim, duke u ndalur veçanërisht tek gjinia, përkatësia etnike e fetare, si dhe tek mbështetja për personat me aftësi të veçanta.

Bashkëpunimi i BE-së me Kosovën pritet të përfshijë asistencë teknike për zbatimin e masave të përfshira në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovë (PSAK). Ky bashkëpunim ndihmon në realizimin e qëllimeve të lidhura me barazinë dhe gjithëpërfshirjen, duke kontribuar në transformimin e sistemit arsimor për të garantuar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët.

SHËNDETËSIA – Në komunën e Fushë Kosovës, pas përfundimit të luftës, në tetor të vitit 2000 rifilloi funksionimi i qendrës kryesore të mjekësisë familjare (QKMF). Në fillim, kushtet për ofrimin e shërbimeve shëndetësore ishin të papërshtatshme, pasi në objektin shëndetësor të Bresjes funksiononte ende shëndetësia e pushtetit paralel serb, në të cilën popullsia shqiptare nuk kishte qasje. Vetëm në vitin 2004, pas lirimit të objektit dhe angazhimit të administratës komunale, filloi punësimi i personelit shëndetësor dhe rifillimi i shërbimeve të plota në vitin 2008.[17]

Bazuar në të dhënat e komunës, sot shërbimet shëndetësore ofrohen në 11 objekte, duke përfshirë:

- 1 QKMF – në qytetin e Fushë Kosovës;
- 5 QMF – në Fushë Kosovë, Miradi e Poshtme, Sllatinë e Madhe dhe Bardh i Madh;
- 2 QMF – në Miradi të Epërme dhe Vragoli.



Fusha shëndetësore mbulohet edhe nga sektori privat, ku operojnë një numër i konsiderueshëm i subjekteve shëndetësore, duke ofruar shërbime të ndryshme për komunitetin.

Qendra kryesore e mjekësisë familjare ofron mbi 150,000 shërbime në vit, duke përfshirë shërbime pediatrike, laboratorike, stomatologjike, gjinekologjike dhe vaksinime. QKMF operon me dy ndërrime në ditë, ndërsa shërbimi i emergjencës është i disponueshëm 24 orë. Me rritjen e popullsisë si rezultat i migrimit të brendshëm nga pjesë të ndryshme të Kosovës, kërkesat për shërbime shëndetësore dhe sociale janë në rritje të vazhdueshme.[18]

Sipas ASK-së, gjatë periudhës 2021–2023, Qendrat e Mjekësisë Familjare në Komunën e Fushë Kosovës kanë pasur një numër të qëndrueshëm prej 103 të punësuarish. Prej tyre, 23 mjekë, katër (4) stomatologë, 52 infermierë, një (1) farmacist dhe 23 punëtorë jo shëndetësorë.[19] Ndërsa, sipas të dhënave të komunës për vitin 2024, numri i të punësuarve në sektorin e shëndetësisë është 149 punëtorë shëndetësorë, duke reflektuar nevojën për zgjerimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Në këtë kuadër, stafi i zgjeruar përfshin 32 mjekë, 76 infermierë, dhe 35 punëtorë jo shëndetësorë.

[17] Strategjia e zhvillimit lokal ekonomik 2015-2020, fq. 13-14.
[18] Po aty, fq. 13-14.
[19] ASKDATA: *Të punësuarit në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas profesioneve*, 2021-2023.


të dhënat e komunës për vitin 2024 Numri i të punësuarve në sektorin e Shëndetësisë është 149 punëtorë shëndetësor. Prej tyre 32 mjekë të mjekësis së përgjithshme, 76 infermierë dhe 35 punëtorë teknik dhe administrativ.

Grafiku në vijim tregon numrin e vizitave të përgjithshme në QMF në komunën e Fushë Kosovës në vitin 2022 dhe 2023.

Në Komunën e Fushë Kosovës, mesatarja e vizitave mjekësore vjetore për person tregoi një rritje domethënëse gjatë viteve 2022–2023. Në vitin 2022, mesatarisht çdo person vizitoi Qendrën e Mjekësisë Familjare rreth 7 herë, ndërsa në vitin 2023 kjo mesatare u rrit në 8 vizita për person. Kjo reflekton një rritje të përgjithshme prej 8.8% të vizitave mjekësore në QMF.

Për sa i përket kategorive specifike, shërbimet e mjekësisë familjare shënuan një rritje të ndjeshme prej 20% në vitin 2023, ndërsa shërbimet e intervenimeve dhe shërbimeve tjera u rritën me 7.4%. Megjithatë, laboratoret përjetuan një rënie të dukshme prej 45%, dhe shërbimet stomatologjike shënuan një ulje prej 10%. Këto ndryshime pasqyrojnë tendencat dhe kërkesat e ndryshme për shërbime shëndetësore në komunë, të cilat janë analizuar më tej në grafikun përkatës.


Graf. 10 Krahasim i numrit të vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare sipas kategorive, 2022-2023



Burimi: ASKDATA: *Numri i vizitave në Qendrat e Mjekësisë Familjare, 2022-2023.*

Sipas statistikave të ASK-së për periudhën 2020–2023, numri i të infektuarve me Covid-19 në këtë komunë në vitin 2020 ishte 2,495 raste. Në vitin 2021, numri u rrit ndjeshëm me 86.3%, ndërsa në vitin 2022 pati një rritje më të vogël prej 13.9%. Megjithatë, në vitin 2023 u regjistrua një rënie drastike prej 96.7% të rasteve të reja, duke reflektuar përmirësimin e situatës epidemiologjike.

Graf. 11 Të infektuarit me COVID-19 në komunën e Fushë Kosovës, 2020-2023



Burimi: ASKDATA: *Të infektuarit me COVID-19 në komunën e Fushë Kosovës, 2020-2023.*

Statistikat e ASK për periudhën 2018-2023 tregojnë se mesatarja vjetore e të sëmurëve me sëmundje malinje në këtë komunë është 95. Vërehet një rritje prej 96.6% në vitin 2023 kundrejt vitit 2022 dhe kundrejt mesatares së viteve paraprake, 119%.

Në vijim janë ranguar shkaqet kryesore të vdekjes në komunën e Fushë Kosovës, bazuar në statistikat e ASK për vitin 2020 dhe 2021.

Tab. 4 Rangimi i grupeve kryesore të shkaqeve të vdekjes në komunën e Fushë Kosovës, 2020-2021

Nr.	GRUPET KRYESORE TË SHKAQEVE TË VDEKJES	2020 (%)	2021 (%)
1	Sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut	44.5	35.3
2	Simptomat, shenjat dhe rezultatet jonormale klinike dhe laboratorike të paklasifikuara gjetiu	6.3	18.4
3	Tumoret	19	14.7
4	Sëmundjet e sistemit urogjenital	3.2	2.6
5	Shkaktarët e jashtëm të sëmundëshmërisë dhe vdekshmërisë	1.6	1.6
6	Sëmundjet endokrine, të ushqyeshmerisë dhe metabolike	6.3	2.6
7	Sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes	14.3	16.3
8	Sëmundjet infektive dhe parazitare	1.6	2.1
9	Sëmundjet e sistemit nervor	0.8	1.1
10	Sëmundjet tjera	2.4	5.3
	Gjithsej	**100**	**100**

Burimi: *ASKDATA: Rangimi i 10 grupeve të shkaqeve të vdekjes sipas vendqëndrimit (komunës) në Kosovë, 2020-2021.*

Siç shihet nga tabela e mësipërme, dominojnë sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, pastaj tumoret dhe sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes.

MIRËQENIA SOCIALE – është një element themelor i një shoqërie të qëndrueshme, që përfshin kujdesin shëndetësor, strehimin, fuqizimin ekonomik dhe mbështetjen për të varfrit, të papunët dhe grupet e margjinalizuara. Ajo synon jo vetëm sigurimin e nevojave bazike, por edhe fuqizimin e individëve për të përmirësuar jetën e tyre dhe integrimin e plotë në shoqëri.

Qendra për Punë Sociale në Komunën e Fushë Kosovës është e organizuar për të mbështetur familjet dhe individët në nevojë, duke siguruar shërbime të integruara për mirëqenien sociale. Në qytetin e Fushë Kosovës operon një Qendër për Punë Sociale (QPS) dhe një shtëpi integruese, ndërsa në Miradi e Epërme janë të disponueshme banesa sociale, që ofrojnë strehim dhe mbështetje për grupe të cenueshme të popullatës. Në këtë komunë, 11% e popullatës jeton në gjendje të rëndë ekonomike, ku 2.1% mbështeten nga ndihmat sociale, ndërsa 9.1% mbështeten nga pensionet.[20]

Sipas të dhënave të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2020 (TM1-TM4), në komunën e Fushë Kosovës mesatarisht 916 familje kanë përfituar nga skema e ndihmës sociale. Ndërsa, gjatë vitit 2021 (TM1-TM4), numri mesatar i familjeve përfituese u rrit në 961, që përfaqëson një rritje prej 4.9%

Tab. 5 Shërbimet sociale në komunën e Fushë Kosovës


Nr.	KATEGORITË E KLIENTËVE	RASTE	SHËRBIME PËR KLIENTË	RASTE
1	Fëmijë i braktisur	3	Vendosje në strehim familjar	2
2	Fëmijë i keqtrajtuar	-	Bashkim familjar	1
3	Fëmijë me sjellje asociale	18	Kujdestaria, shërbime sociale	50
4	Të miturit në konflikt me ligjin	22	Shërbime për të miturit në konflikt me ligjin	30
5	Besimi i fëmijëve për Gjykatë	66	Këshillim për bashkëshortët	150
6	Strehim familjar tek të afërmit	18		23
7	Strehim familjar në familje strehues	3		5
8	Përdorues të substancave narkotike	1	Besim i fëmijëve dhe mbikëqyrje e vizitës	1
9	Klientë të tjerë në nevojë për shërbime	396	Intervenim të përgjithshëm	396
10	Klient vendor për adoptim	5	Vlerësim i familjeve	5
11	Klientë të dhunës në familje / Viktima të trafikimit	155		220
12	Fëmijë me aftësi të kufizuara	41	Vlerësim komision mjekësor	41
13	Ngacmim seksual	2		4
14	Dhunim	5		20
	Gjithsej	**646**		**928**

Burimi: *Të dhënat nga komuna*.

[20] Të dhënat nga drejtoria përkatëse e komunës së Fushë Kosovës.

TREGU I PUNËS – Në vijim janë përmbledhur disa statistika të përgjithshme mbi tregun e punës në Kosovë.

Graf. 12 Statistikat e tregut të punës, 2025, në Republikën e Kosovës



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës: *Vjetari Statistikor i Republikës së Kosovës 2025*, fq. 14-15.

Sipas grafikut, fuqia ekonomikisht aktive për vitin 2024 ishte 464,567 persona, me shkallën e pjesëmarrjes prej 43.2%, duke shënuar një rritje prej 2.5% krahasuar me vitin 2023. Popullsia ekonomikisht jo aktive për të njëjtin vit ishte 610,137 persona, që përbën 56.8% të pjesëmarrjes në këtë kategori.

Gjithashtu, të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2024 tregojnë se numri i të punësuarve ishte 414,493 persona, me një shkallë punësimi prej 38.6%, 2.3% më e lartë se në vitin 2023. Ndërkohë, numri i të papunëve në vitin 2024 ishte 50,070 persona, duke rezultuar në një shkallë papunësie prej 10.8%, që është 0.1% më pak krahasuar me vitin e kaluar. Këto shifra reflektojnë trendin e përmirësimit në tregun e punës.

SHËRBIMET ADMINISTRATIVE - Komuna e Fushë Kosovës ka gjithsej 14 drejtori të cilat janë prezantuar detajisht te skema organizative e komunës.

Komuna është përgjegjëse kryesisht për ofrimin dhe kryerjen e shërbimeve primare ndaj qytetarëve, sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale - Ligji Nr. 03/L-040. Si rezultat, komuna e Fushë Kosovës i ofron të gjitha shërbimet dhe merr përgjegjësitë e përcaktuara nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale.

Tab. 6 Numri i të punësuarve në komunës së Fushë Kosovës, sipas drejtorive

Nr.	Të punësuarit sipas drejtorive në komunë	
1	Drejtoria për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit	11
2	Drejtoria për Arsim	6
3	Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport	11
4	Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale	12
5	Drejtoria për Infrastrukturë	5
6	Drejtoria për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim	14
7	Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër	10
8	Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari	9
9	Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	9
10	Drejtoria për Inspektoriat	8
11	Drejtoria për Buxhet dhe Financa	8
12	Drejtoria për Prokurim	5
13	Drejtoria për Administratë / Zyra e Kryetarit/Z. Komuniteteve /Çështja gjinore	39
14	Drejtoria për Integrime Evropiane dhe Inovacion	4
Gjithsej		**151**

Burimi: *Draft-plani zhvillimor komunal i Fushë Kosovës 2024-2032,* fq. 152.

INFRASTRUKTURA - Qyteti i Fushë Kosovës ndodhet në një pozicion strategjik, duke shërbyer si një nyje kyçe për lidhjen rrugore me qytetet e tjera të Kosovës dhe aeroportin. Trafiku në këtë zonë është i dendur, veçanërisht përgjatë autostradës M9, e cila lidh Prishtinën me Pejën dhe më tej me Podgoricën në Malin e Zi. Një tjetër arter i rëndësishëm është autostrada M2, që kryqëzohet me M9 në pjesën lindore të qytetit dhe luan një rol thelbësor në lidhjen e Kosovës me rajonin.

Sa i përket transportit urban, Fushë Kosova ka një lidhje të drejtpërdrejtë me Prishtinën, si dhe me fshatrat përreth përmes trafikut ndër-urban, duke mundësuar lëvizjen e qytetarëve dhe shkëmbimin e mallrave. Një aspekt tjetër i infrastrukturës së transportit është hekurudha që kalon nëpër komunë, e cila aktualisht ka një strukturë të vjetruar dhe kërkon investime të mëdha për përmirësimin e saj. Modernizimi i saj do të ndihmonte në integrimin më të mirë të sistemit të transportit dhe në rritjen e efikasitetit të lëvizjes për qytetarët dhe sektorin ekonomik.[21]

Rrugët: Ekzistojnë katër kategori kryesore të rrugëve në Kosovë, duke filluar nga rrugët nacionale e deri tek ato të pa kategorizuara.


Rrjeti rrugor i komunës së Fushë Kosovës përbëhet nga:

- Rruga nacionale N-9: Prishtinë-Pejë: Kjo rrugë kalon përmes pjesës qendrore të komunës dhe e ndan qytetin në dy pjesë. Rruga është e pajisur me dy korsi trafiku për çdo drejtim dhe një korsi ndihmëse, e cila është e ndarë fizikisht. Në Fushë Kosovë, qarkullimi është i

[21] Plani lokal i veprimit në mjedis, 2012/2017.

rregulluar në mënyrë të ngjashme në të dy kahet, por ekziston një mungesë kontinuiteti në shtrirjen e korsive të trafikut, duke krijuar sfida për këmbësorët dhe çiklistët.

- Autostrada "Ibrahim Rugova": Morinë-Merdare: Një nga autostradat kryesore të Kosovës, e cila shtrihet rreth 12 km në territorin e Fushë Kosovës, duke filluar nga nyja e saj me autostradën "Arbër Xhaferi" (Prishtinë-Shkup) dhe duke vazhduar drejt kufirit administrativ me komunën e Drenasit.



- Autostrada "Arbër Xhaferi": Prishtinë-Shkup: Kjo autostradë fillon në territorin e Fushë Kosovës, duke krijuar një nyje të rëndësishme për lidhjen e rajonit me zonat tjera të Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.
- Rruga rajonale R120: Lidh fshatrat e komunës me zonat rurale të Lipjanit dhe Drenasit, duke kaluar përmes rrugës së vjetër të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari".
- Rruga rajonale R208: Vazhdim i R120, duke ofruar një lidhje të rëndësishme për fshatrat e komunës së Drenasit dhe Lipjanit.

Për shkak të pozitës strategjike të komunës së Fushë Kosovës, qarkullimi rrugor është i dendur, veçanërisht në rrugën nacionale N9, e cila kalon përmes qytetit dhe përballet me fluks të lartë automjetesh. Bazuar në të dhënat e matjes së trafikut, rruga "Nënë Tereza" mbetet një ndër rrugët më të ngarkuara, me mbi 58,000 automjete/ditë në të dy drejtimet (rreth 30,463 automjete në drejtimin Prishtinë-Pejë dhe rreth 27,525 automjete në drejtimin Pejë-Prishtinë).

Komuna ka ndërmarrë masa për përmirësimin e infrastrukturës rrugore. Një projekt i rëndësishëm i planifikuar është ndërtimi i një rruge lidhëse në pjesën perëndimore të qytetit, e cila do të mundësojë akses më të lehtë nga rruga "Pajazit Islami' deri në rrugën 'Hamdi Grajçevci". Gjithashtu, është paraparë ndërtimi i një rruge tranzitore përgjatë linjës hekurudhore, e cila do të ndihmojë në devijimin e trafikut të rënduar.

Sipas Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban (PMQU), komuna ka propozuar rikonstruktimin e rrethrrotullimit në nyjën kryesore të M9, si dhe ndërtimin e dy rrethrrotullimeve të reja në segmentin e rrugës nacionale M9 për të lehtësuar qarkullimin. Këto investime jo vetëm që do të përmirësojnë fluksin e trafikut, por edhe do të ndihmojnë në zhvillimin ekonomik të zonës, duke krijuar hapësirë për biznese të reja dhe zgjerimin e bizneseve ekzistuese.

Përmirësimi i infrastrukturës rrugore do të ofrojë alternativa për qarkullim, duke krijuar një sistem të integruar rrugor që do të ndikojë pozitivisht në lidhjen e vendbanimeve rurale me qendrën urbane dhe do të sigurojë qarkullim më efikas në të gjithë territorin e komunës.[22]

Rrjeti hekurudhor: Terminali hekurudhor në Fushë Kosovë është një nyje kryesore për transportin e udhëtarëve në Kosovë. Hekurudhat e Kosovës janë ndarë në INFRAKOS, që menaxhon infrastrukturën, dhe TRAINKOS, që operon transportin e udhëtarëve dhe mallrave.

Rrjeti hekurudhor lidh qytetet kryesore, përveç Gjilanit dhe Gjakovës, dhe ka akses ndërkufitar me Maqedoninë e Veriut dhe Serbinë. Megjithatë, përdorimi i trenave mbetet i ulët, me vetëm dy linja aktive: Prishtinë–Pejë dhe Prishtinë–Hani i Elezit–Shkup, të subvencionuara nga qeveria për shkak të kërkesës së kufizuar dhe çmimit të lirë të biletave. Mungesa e koordinimit me transportin tjetër dhe shpejtësia e ulët (maksimumi 80 km/h) e bëjnë trenat më pak tërheqës për qytetarët.

Transporti hekurudhor ka rënë për shkak të pasojave të luftës, vështirësive ekonomike dhe mungesës së investimeve. Binarët janë të paelektrifikuar, infrastruktura është e vjetruar dhe linjat njëfishe kufizojnë efikasitetin.

Komuna e Fushë Kosovës e ka përmirësimin e rrjetit hekurudhor si një nga prioritetet kryesore. Investimet në rehabilitimin e linjave synojnë të rrisin përdorimin e transportit hekurudhor, të përmirësojnë transportin e mallrave dhe të nxisin zhvillimin ekonomik në zone.[23]

Rrjeti ajror: Në territorin e komunës së Fushë Kosovës ndodhet Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës "Adem Jashari", i cili ka një rëndësi të madhe për transportin ajror dhe e pozicionon këtë komunë në një vend të favorshëm për zhvillimin e bizneseve, veçanërisht atyrë hoteliere dhe shërbimeve të lidhura me turizmin.

Megjithëse aeroporti është një nyje e rëndësishme, ai gjithashtu përballet me rreziqe të mundshme, si aksidente ajrore, kërcënime të mundshme me bombë, rrëmbime aeroplanësh, prani e materieve të rrezikshme dhe zjarre në ndërtesa. Gjithashtu, katastrofat natyrore mund të ndikojnë në operacionet e aeroportit, sidomos gjatë periudhave të shiut dhe dimrit, kur terreni bëhet i papërshtatshëm për reagime emergjente. Afërsia me Liqenin e Hencit dhe largësia nga spitalet mund të krijojnë sfida në trajtimin e të lënduarve në raste emergjente. Po ashtu, kapacitetet e zjarrfikësve dhe pajisjet e tyre janë të kufizuara, ndërsa stafi i trajnuar për aksidente ajrore mbetet i pamjaftueshëm.

Aeroporti i Prishtinës është qendra kryesore e trafikut ajror civil në Kosovë dhe mbulon të gjitha aktivitetet komerciale të fluturimeve. Ai është i vendosur 15 kilometra në jug-perëndim të Prishtinës, në një lartësi mbidetare prej 545 metrash dhe shtrihet në një sipërfaqe prej 194.28 ha. Aeroporti operon linja të rregullta me kompani të njohura ndërkombëtare, si Adria Airways,

[22] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 21-24.
[23] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 25-26.

Austrian Airlines, Edelweiss, Germanwings, Hamburg International, Scandinavian Airlines, Swiss, Turkish Airlines, Condor, Wizz Air etj.[24]

TELEKOMUNIKACIONI - Rrjeti telekomunikues i komunës së Fush Kosovës lidhet me qendrën telekomunikuese në Prishtinë përmes kabllos optike, duke përfshirë postat e Fushë Kosovës, Sllatinës së Madhe dhe Bardhit të Madh. Përveç kabllos optike, si lidhje rezervë, ekziston edhe sistemi i antenave, i cili mundëson transmetim të sinjalit në rast të problemeve teknike.

Nga këto qendra, rrjeti telekomunikues shpërndahet përmes kabllove nëntokësore shumëfijore, të cilat ndjekin infrastrukturën rrugore. Kur afrohen lagjeve, këto linja ngrihen në shtylla, duke e shpërndarë sinjalin në zonat e banuara. Posta e Bardhit të Madh lidh fshatrat Graboci i Poshtëm dhe Pomazotini, ndërsa ajo e Sllatinës së Madhe lidh fshatrat Sllatina e Vogël, Bardhi i Vogël, Henci dhe Harilaçi. Qyteti i Fushë Kosovës dhe fshatrat përreth lidhen kryesisht me postën kryesore të qytetit. Telefonia fikse është e shtrirë në gjithë territorin e komunës, duke u mundësuar qasje në komunikim për të gjithë banorët. Kodi postal i komunës është 12000, ndërsa prefiksi telefonik është 038.

Shërbimet telekomunikuese janë një nevojë esenciale për qytetarët, duke përfshirë ndihmën emergjente, sigurinë publike, arsimimin online dhe sistemet e monitorimit. Megjithatë, sfidat infrastrukturore si mungesa e koordinimit ndërmjet operatorëve, shpërndarja e pabarabartë e rrjetit dhe teknologjia e përzier e sistemit kabllor HFC (Hybrid Fiber Coax) dhe GPON (Fiber) e bëjnë të domosdoshëm një plan të integruar zhvillimor.

Një problem i madh është shtrirja e pakontrolluar e kabllove në shtyllat e distribucionit, e cila jo vetëm që dëmton stabilitetin e shërbimit, por edhe ndikon në estetikën urbane dhe paraqet rreziqe për punëtorët. Komuna synon të zhvendosë këtë infrastrukturë në rrjet të unifikuar nëntokësor, që do të shfrytëzohet nga të gjithë operatorët dhe do të jetë pronë komunale.

Shërbimet mobile kanë mbulueshmëri të mirë për telefonatat (voice), por shërbimet e internetit si 3G dhe LTE janë të kufizuara në zonat rurale. Komuna e Fushë Kosovës në bashkëpunim me operatorët e rrjetit po shqyrton mundësinë e ndërtimit të infrastrukturës nëntokësore për zgjerimin e sinjalit në këto zona.

Në përputhje me trendet globale, infrastruktura telekomunikuese po zhvillohet drejt teknologjisë 5G, e cila do të mundësojë shërbime më të shpejta dhe të besueshme. Implementimi i 5G në Kosovë kërkon përmirësim të rrjetit të transportit dhe lirimin e frekuencave të reja nga autoriteti rregullator ARKEP, duke përfshirë brezat 800MHz, 2100MHz dhe 2600MHz.

Në vijim, komuna e Fushë Kosovës dhe operatorët do të ndërmarrin masa për rritjen e numrit të stacioneve bazë (BTS) në zonat me dendësi të lartë të popullsisë, ndërtimin e BTS-ve të përbashkëta nga operatorët për të reduktuar kostot dhe përmirësuar mbulueshmërinë, zëvendësimin e infrastrukturës ajrore me fibra optike nëntokësore, sigurimin e ndërtimit të BTS-ve sipas standardeve teknike.

[24] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 26.

Edhe pse shërbimet me internet janë të pranishme, infrastruktura e paunifikuar dhe mungesa e koordinimit midis operatorëve ka krijuar rrjete të paorganizuara. Operatorët shfrytëzojnë shtyllat e distribucionit, por kalimi në rrjetin nëntokësor është parashikuar deri në vitin 2031.

Komuna do ta zbatojë planin sipas prioriteteve të zonave, duke filluar nga pjesët më problem dhe më të rëndësishme për qytetin e Fushë Kosovës, me qëllim rehabilitimin dhe sistemimin e rrjeteve të telekomunikimit.[25]

Kamerat e sigurisë dhe sirenat: Komuna e Fushë Kosovës ka ndërmarrë masa konkrete për përmirësimin e sigurisë publike, duke realizuar projekte për vendosjen e kamerave të sigurisë dhe sirenave në qytet dhe në zonat rurale. Ky sistem synon mbrojtjen e jetës dhe pronës së qytetarëve, si dhe rritjen e sigurisë në hapësirat publike.



Vendosja e kamerave të sigurisë ka një rol kyç në parandalimin e veprave penale dhe kundërvajtjeve, duke lehtësuar monitorimin e lëvizjes së qytetarëve, veçanërisht në zonat me frekuentim të lartë, si autostrada, rruga magjistrale dhe zona industriale. Për shkak të pozicionit strategjik të Fushë Kosovës, ku qytetarët udhëtojnë nga rajone të ndryshme, nevoja për siguri të shtuar është e domosdoshme.

Përveç garantimit të sigurisë për qytetarët, sistemi i kamerave ndihmon hetuesit policorë në identifikimin e personave të dyshuar, duke rritur efikasitetin në zbulimin e veprave penale. Ky sistem është një mjet i rëndësishëm për zgjidhjen e rasteve kriminale dhe siguron një ambient më të sigurt për komunitetin.

Vendosja e sirenave paralajmëruese në pikat kryesore të qytetit dhe institucionet publike mundëson një reagim më të shpejtë në raste emergjente, duke informuar qytetarët për rreziqet potenciale dhe situatat që kërkojnë veprim të menjëhershëm. Kjo masë e shtuar siguron një menaxhim më efektiv të krizave, duke garantuar një nivel më të lartë të mbrojtjes për banorët dhe vizitorët e komunës. Ky sistem modern i sigurisë është një hap i rëndësishëm drejt zvogëlimit të kriminalitetit dhe krijimit të një mjedisi më të sigurt për të gjithë qytetarët e Komunës së Fushë Kosovës.[26]

RRJETI ENERGJETIK - në komunën e Fushë Kosovës është pjesë e planifikimeve zhvillimore të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) dhe KOSTT, të cilat synojnë përmirësimin e furnizimit me energji elektrike dhe modernizimin e infrastrukturës. Strategjia energjetike për periudhën 2017-2026 fokusohet në sigurimin e një rrjeti të qëndrueshëm, që plotëson kërkesat në rritje të popullsisë dhe bizneseve.

[25] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 34-37.
[26] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 38.

Një nga objektivat kryesore është zëvendësimi i trafo-stacioneve 35/10kV me trafo-stacione 110/20(10)kV, në përputhje me Master Planin e Republikës së Kosovës. Ky investim synon reduktimin e mbingarkesës, përmirësimin e shpërndarjes së energjisë dhe furnizimin më efikas për konsumatorët. Po ashtu, është planifikuar ndërtimi i linjave të reja dhe trafo-stacioneve, për të optimizuar rrjetin dhe për të garantuar një cilësi më të mirë të energjisë.


Në zonat urbane të komunës, rrjeti ajror po zëvendësohet me kabllot nëntokësore, duke eliminuar problemet e lidhjeve të vjetra dhe rrëzimit të shtyllave gjatë kushteve të vështira atmosferike. Një tjetër masë e rëndësishme është zhvendosja e njehsorëve jashtë shtëpive, për të lehtësuar menaxhimin e konsumit dhe për të reduktuar humbjet teknike dhe komerciale.

Një sfidë e madhe për rrjetin e furnizimit është mungesa e izolimit në përçuesit elektrikë. Rrjeti aktual nuk përmban përçues të izoluar, ndaj është bërë zëvendësimi me përçues kabllorë të izoluar për të shmangur rreziqet dhe për të rritur efikasitetin e sistemit. Investimet e vazhdueshme në rrjetin e tensionit të ulët janë kyçe për të siguruar stabilitetin energjetik në zonat me mbingarkesë dhe për të ofruar një furnizim më cilësor.

Komuna e Fushë Kosovës ka prioritet zhvillimin e energjisë së ripërtërishme, duke synuar krijimin e hapësirave për panele solare për prodhimin e energjisë elektrike. Projekti i KEDS për panele solare, i planifikuar në pjesën veri-perëndimore të qytetit, do të ketë një ndikim të madh në reduktimin e varësisë nga burimet tradicionale dhe në përmirësimin e stabilitetit të rrjetit energjetik. Përveç ndikimit ekonomik, ky investim do të kontribuojë në redukimin e emetimeve të karbonit, duke përmbushur standardet ndërkombëtare, si Marrëveshja e Parisit.

Përmirësimi i rrjetit elektrik ka një ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të komunës. Me investime të reja në energji, parashikohet krijimi i vendeve të reja të punës, rritja e sigurisë energjetike dhe stimulimi i industrisë. Përmirësimi i rrjetit të tensionit të ulët dhe zhvillimi i sistemeve inteligjente për monitorimin e konsumit janë hapa të rëndësishëm drejt një furnizimi më efikas dhe të qëndrueshëm.[27]

NDRIÇIMI PUBLIK - Ndriçimi i hapësirave publike dhe rrugëve në komunën e Fushë Kosovës është i realizuar kryesisht përgjatë rrugëve magjistrale, si dhe në disa rrugë brenda qytetit dhe disa fshatra. Megjithatë, gjendja aktuale nuk është plotësisht e kënaqshme, pasi shumë lokalitete ende mbeten pa ndriçim adekuat. Në disa zona, sistemi i ndriçimit nuk është eficient, ndërsa një numër i konsiderueshëm i trupave ndriçues janë të vendosur në shtylla të rrjetit të tensionit të ulët të KEDS, gjë që mund të ndikojë në cilësinë dhe stabilitetin e furnizimit me energji.[28]



FURNIZIMI ME UJË - Në Komunën e Fushë Kosovës, furnizimi me ujë menaxhohet nga KRU Prishtina Sh.A., e cila siguron ujë të pijshëm për të gjithë konsumatorët. Sistemi i ujësjellësit garanton furnizim të vazhdueshëm, pavarësisht

[27] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 31-32.
[28] Draft-plani zhvillimor komunal i Fushë Kosovës 2024-2032, fq. 81.

kërkesës dhe numrit të përdoruesve. Përkundër zhvillimit të teknologjisë, planifikimi afatgjatë i ujësjellësit mbetet një sfidë e rëndësishme, duke garantuar furnizim të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm me ujë të pastër.

Zhvillimi urban dhe nevojat e popullsisë kërkojnë strategji të forta për ruajtjen dhe menaxhimin e burimeve ujore, ndërsa disa sfida si vjetërsimi i infrastrukturës, ndryshimet klimatike, ndotja, urbanizimi i shpejtë dhe humbjet teknike ndikojnë negativisht në sistemin e furnizimit. Për të përmirësuar këtë situatë, janë propozuar masa të modernizimit të rrjetit, përfshirë zëvendësimin e gypave të vjetërsuar, zgjerimin e rezervuarëve dhe instalimin e sistemeve SMART për monitorimin e konsumit të ujit.

Burimet kryesore të ujit për furnizimin e komunës së Fushë Kosovës përfshijnë një sërë pusësh dhe një fabrikë për përpunimin e ujit në Shkabaj, me një kapacitet total prej 251.3 litra/sek. Për të siguruar një furnizim të vazhdueshëm, kapacitetet prodhuese dhe përpunuese të ujit duhet të rriten, duke integruar sisteme të avancuara për ruajtjen dhe shpërndarjen e tij.

Sipas të dhënave nga KRU "Prishtina" Sh.A. për vitin 2023 (Plani i Biznesit 2024-2026), komuna, duke përfshirë edhe zonat rurale, është furnizuar me ujë të pijshëm me një kapacitet total prej 6,950,544 m^3, që përkthehet në një rrjedhë prej 219.80 l/s. Ndërsa, gjatësia e përgjithshme e rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm në zonën e Fushë Kosovës është rreth 176,000 m (176 km), duke përfshirë edhe zonat rurale. Ky sistem është i regjistruar dhe monitoruar përmes Sistemit Operativ GIS, duke mundësuar një menaxhim më efikas dhe një shpërndarje më të mirë të ujit për banorët e komunës.[29]

Për të plotësuar kërkesat e popullsisë, plani i zhvillimit përfshin edhe rritjen e kapacitetit të rezervuarëve dhe pompave, si dhe krijimin e zonave të mbrojtura sanitare për të garantuar sigurinë e burimeve ujore. Në zonat rurale, ku furnizimi është më i vështirë, është sugjeruar ndërtimi i puseve kolektive me kosto të arsyeshme dhe kontroll të rregullt nga IKSHP.

Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë mbetet një prioritet i komunës, ku teknologjitë e reja, si ujëmatësit SMART dhe sensorët e monitorimit, do të ndihmojnë në menaxhimin më efikas të konsumit dhe humbjeve të ujit.[30]

[29] Draft-plani zhvillimor komunal i Fushë Kosovës 2024-2032, fq. 72-75.
[30] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 29-30.

Tab. 7 Burimet e ujit në komunën e Fushë Kosovës

Nr.	EMRI I BURIMIT	LLOJI I BURIMIT	KAPACITETI (litra/sek)
1	Puset Kuzmin	Pus	36 [litra/sek]
2	Puset Vragoli	Pus	64 [litra/sek]
3	Puset Miradi e Poshtme	Pus	63 [litra/sek]
4	Pusi Bardh i Madh	Pus	5 [litra/sek]
5	Puset Vragoli 1	Pus	20 [litra/sek]
6	Miradi e Epërme	Pus	20 [litra/sek]
7	Fabrika Shkabaj	Fabrikë	100 [litra/sek]
	Gjithsej		**251.3 [litra/sek]**

Burimi: *Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës*, 2024, fq. 28.

KANALIZIMI - Në komunën e Fushë Kosovës, kanalizimi i ujërave të ndotura është shumë pak i zhvilluar përkundër investimeve të mëdha nga investimet e komunës të cilat janë kryer më parë. Ndërtimi i rrjetit është bërë pa ndonjë planifikim të mirëfilltë, varësisht prej nevojave të kohës dhe mjeteve në dispozicion dhe si i tillë përcillet me probleme dhe vështirësi të shumta. Sistemi i kanalizimit të ujërave të zeza është në menaxhim të njësisë operative të KRU "Prishtina" Sh.A., i cili ballafaqohet me vështirësi të shumta në mirëmbajtja e rrjetit për shkak të vjetërsisë, dimensioneve joadekuate të gypave, mosfunksionalitetit të tyre si dhe mospagesës së rregullt të shërbimeve. Në komunën e Fushë Kosovës, rrjeti i kanalizimit të ujërave të ndotura përfshin tubacionet primare dhe sekondare, pusetat dhe kolektorët kryesorë, të ndërtuar në periudha të ndryshme nga 1979 deri në 2010. Ky sistem mbulon rreth 90% të popullsisë në zonën urbane dhe 80% në zonat rurale, duke grumbulluar jo vetëm ujërat e ndotura, por edhe ujërat atmosferike.

Mungesa e impianteve të trajtimit bën që ujërat e ndotura të shkarkohen drejtpërdrejt në lumenj, kryesisht në Sitnicë dhe Drenicë, pa trajtim paraprak. Një burim i rëndësishëm ndotjeje është lumi Prishtevkë, i cili e ndot lumin Sitnicë dhe ujërat nëntokësore. Materiali i ndërtimit të tubacioneve përbëhet nga AÇ (10%), PVC (25%), beton (15%) dhe PE (50%), me rreth 7200 kyçje që përfshijnë amvisëri, biznese të vogla, industri dhe institucione.

Rrjeti i kanalizimit atmosferik u ndërtua kryesisht midis 2000 dhe 2010 dhe mbulon vetëm 10% të popullsisë urbane, ndërsa në disa zonat rurale të asfaltuara, nuk ka ende një sistem të kanalizimit atmosferik. Shkarkimi i ujërave atmosferike bëhet në tre pika kryesore, pa trajtim paraprak, ku një pikë kryesore e tërë qytetit derdhet në lumin Sitnicë.

Në fshatin Harilaq gjendet një impiant i trajtimit të ujërave të ndotura, por pjesa tjetër e komunës vazhdon të shkarkojë ujërat e ndotura drejtpërdrejt në lumenj, ose në gropa septike në disa vendbanime rurale. Densiteti i lartë urban dhe mungesa e impianteve të trajtimit paraqesin sfida të mëdha për zhvillimin e kanalizimit, andaj komuna e Fushë Kosovës, në bashkëpunim me KRU "Prishtina" Sh.A., ka planifikuar projekte të rivitalizimit dhe zgjerimit të rrjetit të kanalizimit.

Plani përfshin ndërtimin e kolektorëve kryesorë, që do të grumbullojnë dhe transportojnë ujërat e ndotura drejt impianteve të trajtimit, si dhe zbatimin e sistemeve të ndara të kanalizimit për zonat e reja në zhvillim. Në zonat ekzistuese, do të bëhet rehabilitimi i rrjetit për të zvogëluar kombinimin e ujërave atmosferike me ujërat e ndotura, duke minimizuar përqendrimin e ujërave të shiut në impiantet e trajtimit.

Në zonat rurale, janë propozuar dy opsione për trajtimin e ujërave të zeza: gropa septike kolektive të menaxhuara nga KRU Prishtina, ose ndërtimi i kolektorëve të veçantë për trajtimin e ujërave të ndotura. Studimet e fizibilitetit do të ndihmojnë në përcaktimin e zgjidhjes më të favorshme.

Për përmirësimin e menaxhimit të rrjetit të kanalizimit, janë planifikuar: ndërtimi i impiantit kryesor për trajtimin e ujërave të zeza, ndërtimi i kolektorëve të rinj, vendosja e sistemeve të trajtimit në lokacione teknike të favorshme, reduktimi i kostove të investimeve, përfshirja e sa më shumë vendbanimeve në rrjetin e kanalizimit dhe respektimi i kushteve mjedisore për vendosjen e impianteve.

Këto masa synojnë redukimin e ndotjes së lumenjve, mbrojtjen e burimeve ujore dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, duke krijuar një rrjet kanalizimi të qëndrueshëm në të gjithë territorin e komunës së Fushë Kosovës.[31]

MBETURINAT - Komuna e Fushë Kosovës është një nga zonat me nivelin më të lartë të gjenerimit të mbeturinave në Kosovë, si rezultat i urbanizimit të shpejtë, zhvillimit ekonomik dhe fluksit të madh të popullsisë. Shërbimi i grumbullimit dhe transportit të mbeturinave në tërë territorin e komunës ofrohet nga KRM "Pastrimi" Sh.A., njësia në Fushë Kosovë. Ky operator mbledh mbeturinat nga ekonomitë familjare, bizneset dhe institucionet, duke i transportuar për deponim në deponinë sanitare rajonale në Mirash.

Përveç mbeturinave komunale, KRM "Pastrimi" Sh.A. ofron edhe grumbullimin e mbeturinave masive dhe të ndërtim-rënimit, edhe pse për këtë veprimtari nuk posedon licencë valide. Shërbimi bazik që komuna ka deleguar te operatori për qytetarët përfshin mbledhjen, transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale, si dhe eliminimin e deponive ilegale.

Komuna ka bërë përpjekje për të organizuar grumbullimin dhe transportin e mbeturinave masive dhe të ndërtim-rënimit, por është përballur me sfida infrastrukturore dhe organizative, që kanë penguar një menaxhim më efikas të këtij procesi. Megjithatë, mbulimi me shërbim në komunë është i plotë, duke arritur një shkallë prej 100%.

Në vitin 2021, në komunë u grumbulluan 17,627 ton mbeturina komunale, ndërsa numri i banorëve të shërbyer u vlerësua në 69,448, duke rezultuar në një gjenerim mesatar prej 253.81 kg mbeturina për banor/vit apo 0.70 kg mbeturina për banor/ditë.

[31] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 29-30.

Menaxhimi i mbeturinave mbetet një prioritet për komunën, duke kërkuar strategji të qarta dhe investime në sistemet e grumbullimit, riciklimit dhe trajtimit, për të minimizuar ndikimin në mjedis dhe për të krijuar një qasje më të qëndrueshme ndaj mbetjeve urbane.[32]

KULTURA – Komuna e Fushë Kosovës është një rajon që ruan trashëgimi të pasur historike dhe kulturore, duke përfshirë lokalitete arkeologjike, fortesa antike, nekropole mesjetare dhe monumente të tjera të rëndësishme. Ky nënseksion synon të përmbledhë detaje të zgjeruara mbi këto pasuri kulturore, duke ofruar një pasqyrë më të plotë.

Zbulimi i një lënde arkeologjike relativisht të pasur gjatë dekadave të fundit në disa qendra të komunës së Fushë Kosovës mundëson paraqitjen e tipareve të përgjithshme të vërejtura nga periudhat e mëhershme të shoqërisë njerëzore që nga mijëvjeçari VI para Krishtit e deri në mesjetë.

Materialet e mbledhura vijnë nga gërmimet arkeologjike sistematike dhe nga vrojtimet në terren. Falë kërkimeve arkeologjike të kryera në fushat para dhe protohistorike, antikitetit dhe mesjetës së hershme shqiptare, tashmë është ofrua një panoramë më e qartë rreth zhvillimit kulturor të kësaj treve, e cila që në lashtësi ishte pjesë përbërëse e kulturës dardane.

Gërmimet arkeologjike, sistematike të zhvilluara në disa lokalitete të komunës së Fushë Kosovës kanë histori të re që lidhet me pavarësinë e Kosovës, gjatë kësaj periudhe 10-vjeçare u gërmuan disa qendra arkeologjike, të financuara nga komuna e Fushë Kosovës, si: Bardhi i Madh, Harilaq, Grabovc, Miradi e Poshtme, Lismir etj. Po ashtu janë realizua edhe disa ekspedita në terren në të gjitha fshatrat e tjera të kësaj Komune.

Komuna e Fushë Kosovës është e pasur me monumente të lashtësisë. Në territorin e saj janë evidentuar mbi 22 qendra arkeologjike: në Harilaq, Grabovc Miradi e Poshtme, Sllatinë e Vogël, Henc, Lismir, Vragoli etj, si dhe gjurmët e rrugës antike pranë kalasë së Harilaqit.

Qyteza e Harilaqit përfaqëson një ndër monumentet më të rëndësishme arkeologjike të antikitetit në Kosovë. Jeta në këtë vendbanim ka fillua në epokën e parahistorike, por zhvillimin më të madh e mori gjatë shekullit VI mbas Krishtit. Në këtë kohë u ndërtuan muret rrethuese, kullat, portat si dhe kompleksi paleo-kristian i përbërë nga bazilika, pagëzimorja binjake dhe ambiente të tjera luksoze.

Kërkimet e kryera në vendbanimin dardan të Bardhit të Madh, njërin ndër vendbanimet më të rëndësishme parahistorike në Kosovë, kanë pasqyruar jetën gjatë neoloitit të hershëm, bronzit të vonë e veçanërisht vazhdimin e jetës ne shek.VIII-V para Krishtit

Fortesa parahistorike e Bellaçecit (Bardh i Madh): Fortesa e Bellaçecit, e njohur edhe si Bardh i Madh, ndodhet mbi një kodër të mbrojtur natyrshëm nga terreni në anët veriore, jugore dhe lindore, ndërsa nga perëndimi mbrohet nga ledhet dhe hendeqet mbrojtëse. Poshtë saj kalon lumi Drenicë, ndërsa disa qindra metra në veri shtrihet mali i Çiçavicës. Kjo kala e lashtë ka trajtë

[32] Vlerësimi i rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera për territorin e komunës së Fushë Kosovës, 2024, fq. 54-55.

trapezoidale dhe një sipërfaqe të brendshme prej 70 x 50 metrash. Rrethina e saj, që përfshin disa hektarë, karakterizohet nga ledhe dhe mure të thata të ndërtuara me gurë dhe dhe.

Pozita gjeografike strategjike dhe dominante e kësaj fortese ofron një pamje të gjerë drejt fshatrave të Fushë Kosovës.

Fig. 5 Enë me dy doreza nga Epoka e Hekurit (Muzeu i Kosovës)



Nga shtresat kulturore janë zbuluar artefakte të vjetra mbi 28 shekuj, duke përfshirë enë qeramike të zbukuruara me kanelyra dhe vija të pikëzuara, tipike për stilin dardan të periudhës së hekurit. Këto enë pasqyrojnë krijimtarinë e avancuar artizanale dhe traditën lokale të asaj kohe. Hulumtimet arkeologjike, të filluara në fund të viteve 1960, janë zhvilluar në disa faza për dekada me radhë.

Në vitin 2011, një surve me teknologji gjeomagnetike regjistroi gjurmë të ambienteve të nëndheshme, të cilat pritet të eksplorohen më tej. Ky lokalitet daton që nga shekujt VIII deri në shekullin V para erës sonë, duke ofruar një pasqyrë të rëndësishme për historinë dhe kulturën e kësaj periudhe.[33]

Burimi: Archaeological Guide of Kosovo, fq. 48.

Fig. 6 Fortesa parahistorike e Bellaçecit



Burimi: https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageId=2399 (*qasur për herë të fundit më 20.04. 2025*).

[33] https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageId=2399

Nekropoli Mesjetar në Graboc të Ulët: Hulumtimet e reja në fshatin Grabovc kanë qitur në shesh vendbanimin dardan të epokës së bronzit të vonë të shekujve XIII – XI para Krishtit. Vendbanimi në Miradi të poshtme dhe varrezat në fshatin Grabovc përfaqësojnë dy qendra të rëndësishme mesjetare të shekujve IX-XI dhe XII-XIV.

Lokaliteti arkeologjik në Graboc të Ulët ndodhet pranë lumit Drenicë, rreth 10 kilometra në perëndim të Fushë Kosovës. Gërmimet e para nisën në vitin 2004 dhe zbuluan një varrezë me inhumacione nga koha e mesjetës së hershme. Dhjetëra varre u evidentuan, shumica me skelete në gjendje të mirë, të orientuara perëndim-lindje.

Inventari i varreve përfshinte stoli, armë, vegla pune, qeramikë dhe, më rrallë, enë qelqi. Ndër gjetjet veçohen unaza bronzi, byzylykë, vathë të granuluar dhe një monedhë e shpuar, e përdorur si varëse. Gjithashtu, u identifikuan fragmente qeramike mesjetare dhe parahistorike.

Përveç zbulimit të rrënojave funerare dhe artefakteve të kulturës arbërore, ky lokalitet ofron të dhëna të rëndësishme mbi vazhdimësinë e jetës dhe traditave të komuniteteve në këtë rajon. Një ndërthurje e elementeve mesjetare dhe parahistorike e bën Grabocin e Ulët një burim të çmuar për arkeologjinë dhe studimet kulturore.[34]

Fig. 7 Stoli mesjetare





Burimi: https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageId=2375 (*qasur për herë të fundit më 20.04. 2025*).

Kalaja e Harilaqit: Kalaja e Harilaqit është një ndër monumentet më të rëndësishme të këtij rajoni dhe daton nga shekujt IV-VI. E ngritur mbi kodrën e njohur si Gradina e Harilaqit, kalaja shtrihet në një lartësi prej 766 metrash mbi nivelin e detit dhe zë një hapësirë prej rreth 1.3 hektarësh, e rrethuar me mure mbrojtëse. Gërmimet arkeologjike të zhvilluara nga viti 2005 deri në vitin 2010 nxorën në pah struktura të rëndësishme, si kisha me tri nefe, një kompleks sakral unazor dhe objekte sakrale e profane. Artefaktet e gjetura, përfshirë monedha, stoli, fragmente qeramike dhe vegla pune, dëshmojnë për periudhën e antikitetit të vonë, veçanërisht për kohën e Justinianit. Gjithashtu, indikacione të periudhave parahistorike tregojnë për vazhdimësinë e jetës në kala ndër shekuj.[35] Në listën e Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përhershme

[34] https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageId=2384
[35] https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageId=2384

(2024) është edhe Kalaja e Harilaqit (antikitet i vonë), si lokalitet në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike.[36]

Fig. 8 Kalaja e Harilaqit



Burimi: https://dtk.rks-gov.net/Objekti?heritageId=2384 (*qasur për herë të fundit më 20.04. 2025*).

[36] https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/5367-2.pdf

Në listën e fundit të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme (06.10.2024-06.10.2025) janë përfshirë 5 monumente dhe lokalitete në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike dhe 3 monumente në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore. Po ashtu, janë përfshirë edhe 4 objekte të luajtshme, të cilat janë paraqitur në vijim.[37]

Si lokalitete të trashëgimisë arkeologjike janë listuar: Nekropoli Mesjetar (mesjetë); Fortesa parahistorike ne Bellaçec (parahistori); Fortifikata Maja e Zeze në Graboc të Epërm (antikitet i vonë); Lokaliteti neolitik në Nakaradë (parahistori); Lokaliteti arkeologjik "Llatkavica" Miradi e Madhe (mesjetë).

Tab. 8 Trashëgimia kulturore

Nr.	EMRI	PERIUDHA	VENDI	KATEGORIA
1	Nekropoli Mesjetar	Mesjetë	Grabovc i Ulët Fushë Kosovë Nr.u.D 704	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
2	Fortesa Parahistorike	Parahistori	Bardh i Madh Fushë Kosovë Nr.u.D 712	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
3	Kalaja e Harilaqit	Eneolit, Bronz, Hekur, Antikitet i Vonë	Harilaq Fushë Kosovë 69/2016 Nr.u.D 707	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat Mb. Përhershme
4	Lokaliteti Arkeologjik "Llatkavica"	Mesjetë	Miradi e Epërme Fushë Kosovë Nr.u.D 11	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
5	Fortifikata Maja e Zezë	Antikitet i Vonë	Grabovc i Eperm Fushë Kosovë Nr.u.D 696	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
6	Lokaliteti Neolitik	Parahistori	Nakaradë Fushë Kosovë Nr.u.D 3722	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Lokalitet Arkeologjik/Rezervat
7	Kisha e Shën Ekatarinës	Shek XX.	Bresje Fushë Kosovë Nr.u.D 4030	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Monument/Ansambël
8	Ish Baza e ushtrisë Italiano-gjermane dhe ish Stacioni Hekurudhor	1943	Fushë Kosovë Nr.u.D 4029	Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike Nënkategoria: Monument/Ansambël

Burimi: Departamenti i kulturës së komunës.

Monumentet e listuara të trashëgimisë arkitekturore janë: Stacioni i vjeter Hekurudhorë në Fushë Kosovë (1943); Kisha e Shën Ekatarines në Bresjë (shek. XX); Kulla e Hamit Berishes në

[37] https://www.mkrs-ks.org/repository/docs/5360_2_2.pdf

Harilaq (shek. XVIII). Ndërsa, objektet e luajtshme janë gjetur: Byzylyk (mesjetë e hershme); Peshorja, Muzeu i Hekurudhave (1874); Lokomotiva me Avull (1922).

Ne listën e përkohshme të trashëgimisë arkitekturore të komunës së Fushë Kosovës gjendet mulliri në Graboc të Epërm në toponimin "Kërshi i Plakës" dhe Kisha e Shën Nikollës në Fushë Kosovë. Të dyja objektet janë ngritur në gjysmën e parë të shek.XX.

Tab. 9 Objektet e luajtshme

Nr.	EMËRTIMI	PERIUDHA	VENDI	KATEGORIA
1	Pjatë	1100-850 p.e.s	Bardh i Madh Fushë Kosovë	Kategoria: Objektet e Luajtshme
2	Byzylyk	Mesjete e hershme	Grabovc i Ulët Fushë Kosovë	Kategoria: Objektet e Luajtshme
3	Peshorja	1874	Muzeu i Hekurudhave Fushë Kosovë	Kategoria: Objektet e Luajtshme
4	Lokomotiva me Avull	1922	Muzeu i Hekurudhave Fushë Kosovë	Kategoria: Objektet e Luajtshme

Burimi: Departamenti i kulturës së komunës.

Edhe pse është komunë e re, Fushë Kosova ka trashëgimi të lidhur me zonat përreth si Prishtina, Lipjani, Drenasi dhe Obiliqi, kurse kultura urbane dhe rurale ndërlihet me jetën që e përfaqëson popullata e ardhur nga Lugina e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit si dhe nga Maqedonia e Veriut.

Ngjarjet kulturore si më të rëndësishme që organizohen në nivel komunal janë: Dita e Çlirimit, Festivali Internacional "EURO KOSOVA ART", një ngjarje e rëndësishme që mbledh artistë nga e gjithë bota për të prezantuar artin e tyre në qytetin tonë.

Në Fushë Kosovë ekziston Muzeu i qytetit, Arkivi dhe Biblioteka me dy sektorët: Sektorin për të rritur dhe sektorin për fëmijë. Këtu organizohen panaire artizanale ku ruhen traditat dhe kulturat e komuniteteve që jetojnë në këtë komunë ndërkohë që shënohen edhe festat e të gjitha komuniteteve pa përjashtim.

Fushë Kosova ruan një sasi tepër të konsiderueshme të hartave historike të gjithë Kosovës dhe jo vetëm e që janë në gjuhë të ndryshme, që ofrojnë një perspektivë të gjerë mbi historinë e vendit tonë.

Duhet përmendur se në Sllatinë është në përfundim e sipër ndërtimi i Palestrës Sportive me një kapacitet prej mbi 1,000 ulëseve kurse është po ashtu në vazhdën e punimeve edhe renovimi i Stadiumit të KF Fushë Kosovë "Ekrem Grajqevci" i cili pritet të përfundojë në vitin 2027. Faza e parë ka përfunduar, kurse tani është në fazën e dytë të ndërtimit.

Në përgjithësi sipërfaqja e terreneve sportive dhe palestrave sportive në territorin e komunës së Fushë Kosovës është rreth 11,635 m^2, dhe 65,300 m^2 të sipërfaqeve të terreneve (fushave sportive).

Fig. 9 Rekonstruimi i stadiumit të qytetit – projekti ideor



Fig. 10 Palestra në ndërtim e Sporteve



Me një infrastrukturë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, komuna e Fushë Kosovës vazhdon të mbështesë ngjarjet dhe organizimet artistike e sportive, duke ofruar hapësira dhe mbështetje për qytetarët e saj.[38]

Ndërsa, numri i lexuesve në bibliotekën e qytetit gjatë vitit 2020 ishte 670, ndërsa gjatë vitit 2021, 542. Biblioteka në vitin 2020 kishte 8,920 tituj, ndërsa në vitin 2021, 9,020 tituj.

PROFILI EKONOMIK I KOMUNËS SË FUSHË KOSOVËS – Ekonomia e komunë së Fushë Kosovës mbështetet kryesisht në sektorin e tregtisë, shërbimeve dhe industrisë së lehtë, duke shfrytëzuar afërsinë e saj me kryeqytetin dhe nyjet kryesore të transportit.[39] Bujqësia mbetet një sektor me potencial të lartë, pasi komuna ka toka pjellore që lehtësojnë kultivimin dhe blegtorinë. Megjithatë, urbanizimi i shpejtë dhe zgjerimi i ndërtimeve po shfaq rreziqe për ruajtjen e hapësirave bujqësore.

Fushë Kosova gëzon një infrastrukturë të përmirësuar rrugore, me akses të drejtpërdrejtë në autostradat kryesore dhe linjat hekurudhore, që lehtësojnë qarkullimin e mallrave dhe njerëzve.[40] Sektori i energjisë dhe telekomunikacionit po përjeton përmirësime graduale, ndërsa sfidat mbeten në furnizimin e qëndrueshëm me ujë dhe menaxhimin e mbetjeve[41]. Kjo komunë ka përfituar nga fondet qeveritare dhe ndërkombëtare për investime në infrastrukturë dhe zhvillim ekonomik, megjithëse disa projekte kanë pasur vonesa për shkak të burokracisë dhe mungesës së politikave të qarta investuese.

Ndër sfidat kryesore të komunës së Fushë Kosovës mbeten papunësia e lartë, veçanërisht te të rinjtë, të cilët shpesh kërkojnë mundësi punësimi jashtë vendit e Kosovës. Migrimi rural-urban po ndikon në shpërndarjen e burimeve, duke krijuar dendësi të ulët në zonat bujqësore dhe presion mbi shërbimet publike në qendrat urbane.[42] Megjithatë, komuna ka mundësi të shumta për zhvillim, duke përfshirë zhvillimin e turizmit kulturor dhe ekologjik, zgjerimin e infrastrukturës sportive dhe rekreative, si dhe mbështetjen për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.[43] Me politika të qarta ekonomike dhe investime të qëndrueshme, Fushë Kosova mund të bëhet një qendër e rëndësishme për tregti, industri dhe shërbime, duke forcuar pozitën e saj si një nyje kyçe në zhvillimin rajonal të Kosovës.

Bizneset: Sipas të dhënave zyrtare nga komuna e Fushë Kosovës janë aktive gjithsej 3,518 biznese. Struktura ekonomike dominohet nga ndërmarrjet me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k.), të cilat përbëjnë 57.7% të totalit, pasuar nga bizneset individuale me 38.2%, ndërsa format tjera të organizimit përfaqësojnë 4.1%.

Sa i përket klasifikimit sipas veprimtarisë ekonomike, bizneset tregtare zënë pjesën më të madhe me 30.5%, pasuar nga ato prodhuese me 12.2%, akomoduese me 11.1%, ndërtimore me 9.3%, dhe veprimtari të tjera shërbyese me 36.9%.

[38] Strategjia e zhvillimit lokal ekonomik 2015-2020, fq. 19.
[39] OSCE. (2018). *Municipal profile: Fushë Kosovë/Kosovo Polje*. https://www.osce.org/files/f/documents/0/3/13118_1.pdf
[40] Po aty.
[41] Instituti GAP. (2022). *Zhvillimi ekonomik dhe sfidat në komunat e Kosovës*. https://www.institutigap.org
[42] Po aty.
[43] Instituti GAP. (2022). *Zhvillimi ekonomik dhe sfidat në komunat e Kosovës*. https://www.institutigap.org

Tab. 10 Profilet e aktiviteteve ekonomike, numri i tyre dhe %

Nr.	SEKTORËT DHE AKTIVITETET EKONOMIKE	NR. I BIZNESEVE	%
1	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	120	3.4%
2	Xehetari dhe gurëthyes	19	0.5%
3	Prodhim	430	12.2%
4	Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	21	0.6%
5	Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	25	0.7%
6	Ndërtimtari	327	9.3%
7	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	1,080	30.7%
8	Transport dhe ruajtje	211	6.0%
9	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	391	11.1%
10	Informacion dhe komunikim	142	4.0%
11	Aktivitete financiare dhe sigurimit	78	2.2%
12	Aktivitete të patundshmërisë	43	1.2%
13	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	96	2.7%
14	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	84	2.4%
15	Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social i detyrueshëm	16	0.5%
16	Arsim	94	2.7%
17	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	105	3.0%
18	Art, zbavitje dhe rekreacion	54	1.5%
19	Aktivitete të shërbimeve tjera	182	5.2%
Gjithsej		**3,518**	**100 %**

Burimi: Zyra për biznes, komuna e Fushë Kosovës.

Synimet kryesore të Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Lokal janë të përqendruara në promovimin e qëndrueshmërisë financiare të Komunës, avancimin e infrastrukturës në mbështetje të bizneseve lokale, si dhe krijimin e një mjedisi tërheqës për investime të reja. Po ashtu, prioritizohet fuqizimi i ekonomisë vendore në sektorë strategjik si prodhimi, bujqësia, turizmi dhe gastronomia.

Sektori privat luan rolin kryesor si motor i zhvillimit ekonomik lokal dhe kontribuues në krijimin e vendeve të reja të punës. Për këtë arsye, Komuna angazhohet në përmirësimin e kushteve dhe mbështetjen aktive për rritjen dhe zhvillimin e këtij sektori.

Gjatë viteve të fundit, komuna e Fushë Kosovës ka arritur të krijojë një ambient të favorshëm për zhvillimin dhe zgjerimin e bizneseve, falë mbështetjes së vazhdueshme, lehtësirave administrative dhe bashkëpunimit të ngushtë me sektorin privat dhe akterët relevantë në zhvillimin ekonomik lokal. Si një qendër me potencial të lartë ekonomik, Fushë Kosova ka fituar një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit, kryesisht për shkak të investimeve në infrastrukturën fizike që mundëson funksionimin efikas të bizneseve strategjike.

Zonat komerciale, ekonomike dhe industriale të komunës karakterizohen nga një prani e lartë e bizneseve me veprimtari të ndryshme, përfshirë tregtinë, prodhimin, hotelerinë, ndërtimin dhe shërbimet e tjera. Ndër ndërmarrjet më të njohura që operojnë në këto zona janë: Bylmeti sh.p.k., Euro Lona sh.p.k., Baumarket LLC, Altrade sh.p.k., Metalteknika Asllani sh.p.k., Extra Al PVC sh.p.k., Shell sh.p.k., Dilloni Benz N.T.SH., Petrol Company N.T.SH., Terminali Doganor sh.p.k., Devolli Group sh.p.k., Nora Market sh.p.k., Bitex sh.p.k., Pro Agro sh.p.k., Hotel Vita sh.p.k., NPT


Cufa, Madekos Medical, Contact Generator sh.p.k., Jaha Solar sh.p.k., Agrounion sh.p.k., Hotel Ana Benz, Santefarm sh.p.k., Trefarm sh.p.k., Kosmonte Foods, dhe të tjera.

Shfrytëzimi i tokës: Në Komunën e Fushë Kosovës, bujqësia mbetet një sektor kryesor ekonomik, duke përfshirë një pjesë të madhe të territorit me tokë të dedikuar për aktivitete bujqësore dhe blegtorale. Sipërfaqja e tokës bujqësore përbën 52.24% të totalit, duke përfshirë 3,500 ha tokë arë, që është pjesa më dominuese e tokës për kultivimin e kulturave bujqësore.

Krahas tokës arë, 100 ha janë të dedikuara për kopshte, që mundësojnë kultivimin e perimeve dhe kulturave të ndryshme në nivel familjar apo industrial. Pemishtet zënë 80 ha, duke përfaqësuar një potencial të rëndësishëm për prodhimin e frutave dhe zhvillimin e agrobiznesit. Livadhet dhe kullotat zënë një sipërfaqe totale prej 710 ha, duke u shfrytëzuar për blegtorinë dhe sigurimin e ushqimit për kafshët.


Ndërkohë, sipërfaqja e tokës jobujqësore përbën 47.76% të territorit, ku pyjet zënë 17.22%, duke kontribuar në ekosistemin natyror dhe pasuritë e drurit. Deponitë mbulojnë 13.20%, duke reflektuar nevojën për menaxhim më efikas të mbetjeve. Tokat urbane përbëjnë 10.20%, duke treguar zgjerimin e zonave të banuara dhe zhvillimin urban të komunës. Ndërsa, tokat të tjera zënë 7.14%, që përfshijnë sipërfaqe të paurbanizuara ose me destinacion të veçantë.

Graf. 13 Sipërfaqja e tokës bujqësore në komunën e Fushë Kosovës



Burimi: Përpunuar nga të dhënat e Drejtorisë për Bujqësi.

Graf. 14 Sipërfaqja e tokës jobujqësore në komunën e Fushë Kosovës



Burimi: Përpunuar nga të dhënat e Drejtorisë për Bujqësi.

Bujqësia dhe blegtoria: mbeten ndër sektorët kryesorë të aktivitetit ekonomik në komunën e Fushë Kosovës. Shfrytëzimi optimal i tokës bujqësore mund të ndikojë drejtpërdrejt në rritjen e punësimit dhe të shërbejë si një burim kryesor jetese për popullatën që jeton në zonat rurale. Përmirësimi i infrastrukturës, mbështetja për fermerët dhe investimet në teknologjinë bujqësore mund të ndihmojnë në zgjerimin e këtij sektori, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të komunës.



Në komunën e Fushë Kosovës, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për vitin 2014, toka të punueshme (ara) përbëjnë një sipërfaqe prej 3,278 ha. Kulturat e drithërave mbulojnë gjithsej 2,788 ha, ku kultura e grurit zë vendin kryesor me 2,174 ha, pasuar nga misri me 494 ha dhe tërshëra me 62 ha. Elbi dhe thekra kultivohen në sipërfaqe më të vogla. Përsa i përket kulturave bishtajore, fasulja është kryesore me 375 hektarë, e ndjekur nga bishtajore të tjera. Patatet mbillen në një sipërfaqe prej 19 ha, ndërsa kulturat foragjere, si jonxha, tërfili dhe misri i gjelbër, mbulojnë 449 ha.

Pemët mbillen në një sipërfaqe prej 22.10 ha, ndërsa perimet zënë rreth 57 hektarë dhe vreshtat 0.73 ha (ASK, 2014). Livadhet dhe kullotat përbëjnë një sipërfaqe prej 1,398 ha.

Nga sipërfaqja totale për perime, e cila arrin 57 ha, kultura e qepës dominon me 22 ha, pasuar nga specat me 9.7 ha, dredhëzat me 9 ha, domatet me 4 ha, lakrat me 3.9 ha, karrotat me 1.5 ha dhe të tjera.

Sipas statistikave të ASK-së, komuna e Fushë Kosovës, në vitin 2014, kishte gjithsej 1,306 traktorë. Nga këta, 679 (52%) kishin vjetërsi 0-10 vjet, ndërsa 627 (48%) ishin mbi 10 vjet të përdorimit.

Në vitin 2014, sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), komuna e Fushë Kosovës regjistroi një total prej 2,266 gjedhësh, 1,167 dele dhe 28 dhi, si dhe 1,540 koshere bletësh.

Shpeztaria: Statistikat e vitit 2014 tregojnë se kjo komunë kishte gjithsej 35,784 shpezë. Nga ky total, 22,210 (62.1%) ishin pula për prodhimin e vezëve, 10,606 (29.6%) ishin zogj, pula dhe gjela, 340 (1%) zogj për majmëri, 640 (1.8%) biba, 449 (1.3%) rosa dhe pata, ndërsa të tjera ishin 1,539 shpezë (4.2%).

Pylltaria: Pylltaria në komunën e Fushë Kosovës është një sektor kyç ekonomik, veçanërisht për zonat rurale, ku operacionet pyjore sigurojnë jetesën e shumë banorëve. Komuna e Fushë Kosovës ka një sipërfaqe pyjore prej 1429.75 ha, që përbën 17% të territorit të përgjithshëm të komunës. Pyjet në këtë zonë luajnë një rol të rëndësishëm ekologjik, duke ndihmuar në ruajtjen e biodiversitetit, stabilizimin e klimës lokale dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit.[44]

Komuna synon të menaxhojë intensivisht pyjet për të krijuar mundësi punësimi dhe përfitime mjedisore, duke planifikuar ripyllëzimin e disa zonave. Pyllëzimet dhe menaxhimi i qëndrueshëm do të sjellin përfitime ekonomike dhe mjedisore. Komuna ka rehabilituar zona të degraduara, duke pyllëzuar 100 hektarë me pisha që nga viti 2008. Investimet në pylltari përfshijnë shfrytëzimin e fondeve pyjore për industrinë e drurit dhe bimët medicinale, të cilat kontribuojnë në ekonominë lokale.

Në të ardhmen, synimi kryesor është mbrojtja dhe menaxhimi adekuat i pyjeve për turizëm dhe rekreacion. Pyjet do të përdoren për aktivitete si ecja dhe kampingu, ndërsa do të promovohet shfrytëzimi i produkteve jo-drusore për industri të ndryshme. Zonat e pyllëzuara do të kombinojnë ruajtjen e natyrës me zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm.[45]

Resurset minerale: Në territorin e Komunës së Fushë Kosovës gjenden rezerva të mëdha të qymyrit linjit, i cili shfrytëzohet në minierën sipërfaqësore të Bardhit të Madh. Linjiti është një mineral energjetik i përhapur në pjesën qendrore të komunës dhe ka rëndësi të madhe për sektorin energjetik. Përveç linjitit, komuna ka rezerva të hekur-nikelit dhe magnezitit, kryesisht në fshatin Harilaç, në pjesën jugperëndimore të zonës. Këto minerale kanë vlera të mëdha industriale dhe mund të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të ardhshëm.

Pjesa veriperëndimore e komunës së Fushë Kosovës përbëhet kryesisht nga zona malore, e pasur me resurse natyrore për materiale ndërtimore. Në fshatin Harilaç gjenden shkëmbinj me fortësi të madhe, si dunite, serpentinite dhe harcburgite, të cilët parashihen të përdoren në projekte infrastrukturore në të ardhmen.

Gjithashtu, në fshatrat Graboc i Poshtëm dhe Bardh i Madh gjenden gurë gëlqerorë, që aktualisht shfrytëzohen gjerësisht në ndërtimin e rrugëve. Përveç shkëmbinjve të fortë, në pjesën qendrore të komunës hasen edhe shkëmbinj të butë, si argjila, nga e cila mund të prodhohen blloqe, tulla dhe tjegulla në forma dhe madhësi të ndryshme.

Megjithatë, shfrytëzimi dhe nxjerrja e mineraleve dhe materialeve ndërtimore ka ndikime të mëdha në mjedis. Aktivitetet minerare kontribuojnë në ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës, duke

[44] Draft-plani zhvillimor komunal i Fushë Kosovës 2024-2032, fq. 63.
[45] Po aty.

rrezikuar shëndetin e qytetarëve. Mbetjet industriale të krijuara nga këto procese kërkojnë menaxhim dhe trajtim të veçantë, për të minimizuar efektet e dëmshme për komunitetin dhe ekosistemin.[46]

Turizmi: Sektori i turizmit në Fushë Kosovë është ende në zhvillim, qyteti dhe rrethina e tij ofrojnë një sërë atraksionesh dhe aktivitete interesante për vizitorët që duan të eksplorojnë bukuritë natyrore dhe trashëgiminë kulturore të Kosovës. Pozita gjeografike e saj, e vendosur në kryqëzimin e rrugëve magjistrale, e bën turizmin më tërheqës, ndërsa komunikacioni ajror, hekurudhor dhe automobilistik ndihmojnë në rritjen e qasjes së vizitorëve.

Komuna e Fushë Kosovës ka një infrastrukturë turistike në rritje, ku operojnë një numër i konsiderueshëm njësish akomoduese, duke përfshirë hotele dhe motele të pajisura me objekte shoqëruese që ofrojnë ushqim dhe komoditet cilësor. Sipas të dhënave në dispozicion, në komunë ekzistojnë 63 njësi akomoduese dhe 19 restorante, të cilat plotësojnë nevojat e turistëve që vizitojnë këtë zonë.

Komuna e Fushë Kosovës ka një pasuri të madhe të resurseve turistike, të cilat e bëjnë këtë zonë një destinacion të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit kulturor dhe historik. Ndër vendet më të vizituara janë xhamia e qytetit, kisha serbe në qytet dhe fshatra serbe, si dhe muzeu i qytetit, ku prezantohet historia e zonës dhe trashëgimia e saj kulturore. Po ashtu, në territorin e komunës ndodhen monumente të rëndësishme, si Kalaja e Harilaçit dhe Kalaja e Bardhit të Madh, që përfaqësojnë një pjesë të identitetit historik të rajonit. Përveç këtyre, memorialet "Imer Sfarqa" dhe "Hashim Hajdini" janë pika të rëndësishme historike që shërbejnë për të nderuar figurat dhe ngjarjet që kanë shenjuar zhvillimin e komunitetit.

Kalaja e Harilaçit është një ndër atraksionet më të rëndësishme turistike në Fushë Kosovë. Ajo është ndërtuar në një pozitë gjeografike e cila mundëson një pamje panoramike të Rrafshit të Kosovës, duke përfshirë Fushë Kosovën, Obiliqin, Prishtinën, Lipjanin, Ferizajin, Shtimen dhe Drenasin. Ky vend historik përfaqëson një pjesë të rëndësishme të identitetit kulturor dhe është një nga pikëqëndrimet më të vizituara nga turistët vendas dhe të huaj.

Zhvillimi i turizmit kulturor në Komunën e Fushë Kosovës luan një rol kyç në zhvillimin social-ekonomik të rajonit. Banorët e zonës e konsiderojnë turizmin si një burim të rëndësishëm të ardhurash, sidomos për komunitetet që ruajnë traditat dhe trashëgiminë kulturore të vendit. Fshati Harilaç, dikur i panjohur për pjesën më të madhe të Kosovës, sot është një emër i njohur, duke tërhequr vëmendjen e studiuesve të huaj që janë të interesuar në historinë dhe rëndësinë kulturore të tij.

Afërsia e komunës me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës dhe kryeqytetin e Kosovës e bën atë një zonë lehtësisht të arritshme për turistët. Ky faktor ka ndikuar pozitivisht në promovimin e turizmit dhe në përfshirjen e Fushë Kosovës në hartën turistike të vendit.[47]

Turizmi lokal në Fushë Kosovë po shndërrohet në një mundësi të rëndësishme ekonomike dhe rekreative. Një nga atraksionet kryesore është Parku i Pishave në Sllatinë, i cili ofron shtigje

[46] Draft-plani zhvillimor komunal i Fushë Kosovës 2024-2032.
[47] Draft-plani zhvillimor komunal i Fushë Kosovës 2024-2032, fq. 61-62 .

tërheqëse për ecje, ambiente të sigurta për fëmijë, hapësira për lojëra dhe gjimanstikë në natyrë, si dhe shërbime me ushqime tradicionale dhe parkim të mjaftueshëm për vizitorët.


Një tjetër aset i rëndësishëm është shtegu multifunksional për ecje, vrapim dhe çiklizëm që lidh Bardhin e Madh, Sllatinën dhe Harilaqin, duke përfshirë edhe kalanë historike të Harilaqit. Ky shteg ofron mundësi të shkëlqyera për aktivitete rekreative dhe eksplorim natyror.

Komuna e Fushë Kosovës është e përkushtuar të vazhdojë investimet në zhvillimin e turizmit lokal dhe zgjerimin e hapësirave rekreative. Aktualisht është në proces realizimi projekti për vendosjen e tabelave informuese, me qëllim promovimin e resurseve natyrore dhe kulturore të zonës, si dhe orientimin më të mirë të vizitorëve.

Në këtë kontekst, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik, në bashkëpunim me Komunën e Lipjanit dhe me mbështetjen e organizatës Swisscontact, ka finalizuar Master Planin për Rajonin e Goleshit, të hartuar nga Agjencia EPOD GROUP. Ky plan strategjik synon zhvillimin e qëndrueshëm të zonës përreth Majës së Goleshit, përmes lidhjes funksionale të pikave me potencial turistik: Maja e Goleshit, Kalaja e Karilaqit dhe Parku i Pishave në Sllatinë-Bardh.

Master plani është prezantuar para investitorëve në maj 2025 dhe aktualisht janë duke u zhvilluar konsultime të vazhdueshme me investitorët potencialë për realizimin e projekteve konkrete.

Fig. 11 Parku i pishave në Sllatinë



KRAHASIMI ME VENDET/KOMUNAT TË TJERA – Komuna e Fushë Kosovës, pas rritjes së ndjeshme të popullsisë në regjistrimin e vitit 2024, është shndërruar në një qendër urbane me potencial të lartë zhvillimi. Pozita e saj gjeografike strategjike, afërsia me Prishtinën dhe lidhjet me rrugët nacionale e rajonale e vendosin komunën në një avantazh të qartë krahasuar me komuna më të brendshme si Malisheva apo Drenasi. Prania e qendrave tregtare, zonave industriale dhe kapaciteti për të tërhequr investime të reja e afron me Ferizajn dhe Prizrenin, ku industria dhe tregtia janë motorë kryesorë të zhvillimit ekonomik.

Forca kryesore e komunës qëndron në kombinimin e potencialit urban dhe rural. Nga njëra anë, rritja e popullsisë dhe dinamika e tregtisë e bëjnë Fushë Kosovën një qendër tërheqëse për investime private; nga ana tjetër, kapacitetet bujqësore dhe resurset natyrore ofrojnë bazë të qëndrueshme për zhvillim afatgjatë. Afërsia me kryeqytetin e vendos komunën në një pozitë të veçantë për të përfituar nga digjitalizimi, teknologjia dhe shërbimet moderne, duke e afruar me Prishtinën në aspektin e inovacionit.

Mundësitë e Fushë Kosovës janë të krahasueshme me ato të komunave që kanë nisur transformime të suksesshme. Zhvillimi i infrastrukturës rurale për mbështetjen e bujqësisë, investimet në teknologji të reja dhe digjitalizim, si dhe përmirësimi i shërbimeve publike në shëndetësi, arsim dhe sport e vendosin komunën pranë Prizrenit dhe Ferizajt, ku përmirësimi i cilësisë së jetës është prioritet. Kombinimi i industrisë, bujqësisë dhe shërbimeve publike e bën Fushë Kosovën një model të mundshëm të zhvillimit të balancuar urban-rural.

Edhe pse sfida si papunësia, migrimi dhe infrastruktura e vjetruar mbeten të pranishme, avantazhet gjeografike, resurset njerëzore dhe kapaciteti për të tërhequr investime e vendosin Fushë Kosovën në një pozitë të favorshme për të kapërcyer këto pengesa. Nëse menaxhohen me vizion strategjik, këto forca mund ta shndërrojnë komunën në një qendër të qëndrueshme ekonomike dhe sociale.

Në nivel rajonal, praktikat e komunave urbane në Shqipëri, Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut tregojnë se rritja e popullsisë dhe zhvillimi i qendrave tregtare mund të shfrytëzohen si motorë ekonomikë vetëm kur shoqërohen me investime të qëndrueshme në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi. Fushë Kosova ka ngjashmëri të dukshme me Kamzën në Shqipëri, Tetovën në Maqedoni dhe Tuzin në Mal të Zi, ku rritja e shpejtë demografike dhe afërsia me kryeqytetet kanë krijuar mundësi të mëdha për zhvillim, por edhe sfida të ngjashme me urbanizimin dhe presionin mbi shërbimet publike. Duke mësuar nga këto përvoja, Fushë Kosova mund të ndërtojë një model të balancuar urban-rural, duke shfrytëzuar avantazhet e saj gjeografike dhe resurset njerëzore për të siguruar zhvillim industrial të qëndrueshëm dhe përmirësim të cilësisë së jetës.

5. ANALIZA SWOT

Analiza SWOT është një nga veglat kyçe që lehtëson procesin e planifikimit strategjik, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi faktorët që ndikojnë në zhvillimin komunal. Kjo metodë ndihmon në identifikimin dhe diskutimin e aspekteve kyçe për hartimin e një strategjie efektive.

Analiza mbështetet në vlerësimin e dy kategorive kryesore: faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Faktorët e jashtëm përfshijnë mundësitë dhe kërcënimet që ndikojnë nga mjedisi i jashtëm, ndërsa faktorët e brendshëm përfshijnë përparësitë dhe dobësitë që lidhen me kapacitetet e brendshme të komunës.



Resurset dhe performanca e një komune shpesh përcaktojnë pikat e saj të forta dhe të dobëta, ndërsa mundësitë dhe kërcënimet burojnë nga tendencat dhe zhvillimet e jashtme që mund të ndikojnë pozitivisht ose negativisht në objektivat e saj. Identifikimi i këtyre faktorëve bëhet nëpërmjet vlerësimit të hollësishëm nga grupi punues, duke përfshirë analiza të sektorëve të ndryshëm.


Analiza SWOT është një instrument fleksibël që mund të përdoret në situata të ndryshme, qoftë për të vlerësuar opsionet e disponueshme për adresimin e një sfide specifike apo për të peshuar mundësitë kundrejt rreziqeve për të marrë vendime të informuara. Për më tepër, ky proces ndihmon komunat të përcaktojnë faktorët që do t'i ndihmojnë ose pengojnë në arritjen e objektivave të tyre.

Rezultatet e analizës SWOT luajnë një rol kyç në planifikimin strategjik. Identifikimi i çështjeve kyçe gjatë kësaj analize kontribuon në formulimin e vizionit, qëllimeve strategjike dhe objektivave, si dhe në hartimin e programeve dhe projekteve që synojnë maksimizimin e përparësive, reduktimin e dobësive, shfrytëzimin e mundësive dhe menaxhimin e rreziqeve.

Si rezultat, vlerësimi i përgjithshëm i situatës së komunës së Fushë Kosovës është realizuar nëpërmjet analizës SWOT. Matrica më poshtë përmbledh përparësitë, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet që janë identifikuar gjatë vlerësimit të gjendjes aktuale në komunë, bazuar në të dhënat e analizuara.




Përparësitë




- Pozitë gjeografike dhe klimë e favorshme për zhvillim të qëndrueshëm
- Popullsi e re në rrtije me potencial për zhvillim ekonomik dhe inovacion
- Resurse natyrore të bollshme, përfshirë tokë bujqësore dhe burime ujore
- Kapacitete bujqësore dhe blegtorale me mundësi për zhvillimin e agroturizmit
- Lidhje strategjike me rrugët nacionale dhe rajonale, që lehtësojnë qarkullimin dhe nxisin rritjen ekonomike
- Planifikim urban që synon balancimin mes zgjerimit të qendrës dhe ruajtjes së tokës bujqësore
- Përmirësime në infrastrukturën rrugore dhe ajrore, me potencial për zhvillim hekurudhor dhe transport publik
- Mbulim i gjerë me rrjetin e ujësjellësit dhe furnizim të qëndrueshëm me ujë cilësor
- Kanalizim i organizuar me rrjete të veçuara dhe ndërtim me materiale standarde
- Mbulueshmëri e mirë me internet në zonat urbane dhe rurale
- Infrastrukturë e shëndetësisë e shtrirë mirë, me qasje të përshtatshme për persona me nevoja të veçanta
- Investime në infrastrukturën shkollore dhe vetëdijesim për edukimin e hershëm që rrisin cilësinë e arsimit
- Hapësira kulturore dhe historike, përfshirë monumente dhe vende arkeologjike me vlerë
- Transparencë e lartë institucionale, me publikim të akteve dhe dokumenteve të rëndësishme për qytetarët
- Përmirësim i qasjes në shërbime administrative, me rritje të kërkesave të shqyrtuara brenda afateve ligjore
- Përdorimi i hapësirave shkollore për aktivitete komunitare dhe kulturore
- Hapësira publike që ofrojnë mundësi për aktivitete sociale dhe komunitare
- Legjislacion që mbështet monitorimin e ndotjes dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit
- Ndërtimi i banesave të reja dhe programe për përmirësimin e kushteve të banimit
- Lidhje e mirë e vendbanimeve me qendrën komunale dhe shpërndarje e shërbimeve shkollore dhe shëndetësore





Dobësitë


- Shkalla e lartë e papunësisë dhe mungesa e mundësive për punësim të rinisë, duke ndikuar në migrimin dhe stagnimin ekonomik
- Ndotje e tokave bujqësore dhe kanaleve të ujitjes, mungesë informimi dhe vetëdijesimi për mbrojtjen e tyre
- Ndërtimet ilegale dhe fragmentimi i tokës bujqësore, mungesë infrastrukture dhe konflikt mes zonave industriale dhe banimit
- Teknologji e vjetruar në bujqësi
- Probleme me furnizimin të ujit në disa zona, rrjet i vjetëruar
- Sistem kanalizimi i vjetëruar dhe joefikas, përzierje e ujërave fekale dhe atmosferike, mbulim i dobët i zonave rurale
- Infrastrukturë teknologjike e dobët, internet i kufizuar në zonat rurale dhe rrjet i vjetruar
- Ndërprerje të shpeshta dhe furnizim jostabil me energji si pasojë e rrjetit të vjetruar
- Furnizim i pamjaftueshëm me pajisje mjekësore, mungesë motivimi për punëtorët
- Rrjeti hekurudhor i dëmtuar, infrastruktura urbane e transportit publik e pamjaftueshme për nevojat e qytetarëve
- Transport urban i papërshtatshëm, mungesë korsish për autobusët, efikasitet i ulët në zonat rurale
- Mungesa e qendrave të formimit profesional, duke kufizuar përgatitjen e fuqisë punëtore për tregun e punës
- Sfida në arsim, zvogëlim i numrit të nxënësve në viset rurale dhe mbingarkesë klasash në shkollat urbane
- Mungesë hapësirash për shërbime publike, qasje e vështirë në administratë për shkak të zyrave të limituara në zona rurale dhe urbane
- Investime të pamjaftueshme në trashëgimi kulturore, mungesë hapësirash të mjaftueshme për aktivitete kulturore
- Mungesë infrastrukture për sport dhe rekreacion, vjetërsia e Shtëpisë së Kulturës dhe rënie e pjesëmarrjes në sport
- Mungesë hapësirash për shërbime sociale dhe komunitare, kufizim i zgjerimit në zonat urbane dhe rurale
- Probleme mjedisore, ndotje industriale, mungesë monitorimi të ajrit, mbetje të paligjshme dhe përkeqësim i cilësisë së ujit në lumin Sitnica
- Paqartësitë në kornizën ligjore dhe politikat ekonomike mund të kufizojnë investimet dhe zhvillimin lokal
- Mungesë mirëmbajtjeje dhe infrastrukture për vizitorët, që kufizon përdorimin e monumenteve historike për turizëm dhe punësim
- Dendësi e ulët e ndërtimit dhe përqendrim administrativ në qendër, krijon vështirësi për zonat periferike
- Probleme në sektorin e banimit, ndërtim pa leje, mungesë standardesh, zhvillim i kufizuar i qiradhënies dhe regjistrim i ulët i pronës
- Mungesa e pronës komunale dhe buxhet i limituar për banim, vështirësim i përmbushjes së nevojave për strehim



Mundësitë

- Ndërtimi i infrastrukturës rrugore rurale për zhvillimin e bujqësisë dhe lehtësimin e transportit të produkteve
- Investimi në teknologji të reja për përmirësimin e efikasitetit në sektorë të ndryshëm
- Kontrolli i ndërtimeve në zonat bujqësore, krijimi i hapësirave urbane të reja dhe densifikimi i fondit ndërtimor për ruajtjen e tokës bujqësore
- Mundësi për plasimin e mallrave në tregun ndërkombëtar dhe zgjerimin e kapaciteteve eksportuese
- Rritja e subvencioneve për fermerët për të mbështetur prodhimin dhe qëndrueshmërinë ekonomike
- Investime në infrastrukturë, avancim teknologjik dhe transparencë në sektorin e ujësjellësit për një furnizim më cilësor
- Mbështetje financiare nga grante qeveritare dhe investime të jashtme për trajnim të stafit dhe ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza
- Infrastrukturë e përbashkët për operatorët e shërbimeve të telekomunikimit për efikasitet më të madh
- Përmirësim i shërbimeve shëndetësore përmes ndërtimit të një QKMF me standarde ISO, zonifikimit të pacientëve dhe fuqizimit të ekipit mjekësor
- Ndërtimi dhe renovimi i çerdheve dhe shkollave, digjitalizimi i arsimit dhe trajnime profesionale për mësimdhënësit
- Zgjerimi i administratës publike dhe ndërtimi i Zyrave të Gjendjes Civile për qasje më të lehtë në shërbime
- Investime në mirëmbajtjen e monumenteve historike
- Zhvillimi i hapësirave sportive dhe rekreative dhe forcimi i aktiviteteve komunitare përmes bashkëpunimit me OJQ rinore, kulturore dhe sportive
- Rritja e qasjes në shërbime sociale dhe komunitare për një mbështetje më të madhe ndaj qytetarëve
- Zbatimi i strategjive mjedisore, me fokus në reduktimin e ndotjes nga industria dhe ndërtimin e hapësirave të gjelbra
- Rigjenerimi i trashëgimisë kulturore dhe sigurimi i fondeve ndërkombëtare për ruajtjen dhe promovimin e identitetit historik
- Hartimi i planeve hapësinore për një zhvillim urban të rregullt dhe menaxhim më të mirë të burimeve hapësinore
- Planifikimi kompakt i zonave të banimit dhe stimulimi i kërkesës për pronësi private për banim të përballueshëm
- Mbështetje financiare nga Qeveria dhe donatorët, me nevojë për politika më të qarta dhe të parashikueshme për investitorë





Rreziqet

- Braktisja e fshatrave dhe interesimi i ulët për bujqësi, duke kërcënuar qëndrueshmërinë e sektorit
- Mungesa e kredive të favorshme afatgjata, që kufizon investimet bujqësore dhe ekonomike
- Shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore për shkak të urbanizimit të shpejtë, duke rrezikuar ekuilibrin zhvillimor
- Migrimi rural-urban, duke shkaktuar dendësi të ulët në fshatra dhe mbingarkesë të shërbimeve në qytet
- Pronësi e paqartë dhe ndërtimet pa leje, duke penguar planifikimin urban dhe zhvillimin e qendrueshëm
- Humbje të mëdha të ujit dhe rrjet i vjetëruar, abuzim në shfrytëzim dhe politika joadekuate për mbrojtjen e burimeve ujore
- Sistem kanalizimi i vjetëruar dhe cenim i cilësisë së ujit
- Ndërprerje e shërbimeve për shkak të mungesës së infrastrukturës nëntokësore dhe ofrimit të shërbimeve pirate në zonat rurale
- Dobësi në transportin publik dhe rrjetin rrugor, përfshirë mungesën e stacioneve të autobusëve, parkingjeve publike dhe sinjalizimit të papërshtatshëm
- Mbingarkesë e trafikut motorik, për shkak të zhvillimit të pamjaftueshëm të transportit publik dhe infrastrukturës rrugore
- Bashkëpunim i dobët mes nivelit lokal dhe qendror, mungesë fondesh për projekte infrastrukturore
- Sfidat në sektorin shëndetësor, përfshirë mungesën e interesit për mjekësinë familjare, largimin e stafit dhe mbingarkesën e QKMF-së
- Mbyllja e shkollave në zona rurale, duke ndikuar negativisht në qasje dhe cilësi të arsimit
- Shuarja e OJQ-ve për shkak të fondeve të pamjaftueshme dhe dëmtimi i trashëgimisë kulturore për shkak të mungesës së menaxhimit efikas
- Mungesa e buxhetit dhe pronave komunale, duke penguar zgjerimin e infrastrukturës sportive e rekreative dhe aksesin e komunitetit
- Rritja e ndotjes së ajrit për shkak të industrisë dhe trafikut, duke ndikuar në shëndetin e popullsisë
- Industria pa monitorim adekuat dhe menaxhimi i mbetjeve të rrezikshme, duke ndikuar në cilësinë e ajrit dhe ujit
- Humbja e identitetit kulturor dhe dëmtimi i trashëgimisë, duke ndikuar negativisht në turizëm dhe ekonomi lokale
- Zgjerimi i vendbanimeve pa kritere dhe humbja e tokës bujqësore, duke penguar zhvillimin e planifikuar
- Ndërtimet pa leje dhe mungesa e standardeve të banimit, duke rrezikuar stabilitetin e tregut të qiradhënies dhe pronës
- Mungesa e pronës komunale për ndërtim dhe buxhet i limituar për banim, duke vështirësuar përmbushjen e nevojave për strehim
- Jo stabiliteti politik dhe mungesa e fondeve, duke vështirësuar realizimin e programeve të banimit social

6. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM EKONOMIK

QËLLIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Për të siguruar realizimin e vizionit dhe misionit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, komuna e Fushë Kosovës ka përkufizuar pesë fusha kryesore strategjike që balancojnë zhvillimin ekonomik, mirëqenien sociale, urbanizimin, mbrojtjen e mjedisit dhe qeverisjen e mirë.

1. **Zhvillimi ekonomik dhe fuqizimi i sektorit privat** (Mbështetja e bizneseve të vogla dhe të mesme; Zhvillimi i zonave industriale dhe fuqizimi i eksportit, duke përmirësuar kapacitetet lokale prodhuese; Përmirësimi i kushteve për investime të huaja, duke ofruar incentiva dhe infrastrukturë moderne; Inicimi i programeve të veçanta për gratë dhe të rinjtë; Nxitja e bujqësisë moderne, përfshirë investime në teknologji, mekanizim dhe agroturizëm).
2. **Rritja e cilësisë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale** (Ndërtimi dhe modernizimi i objekteve shkollore, duke përmirësuar infrastrukturën arsimore; Fuqizimi i programeve të aftësimit profesional, veçanërisht për të rinjtë dhe grupet e margjinalizuara; Zhvillimi i sistemit shëndetësor përmes investimeve në pajisje dhe infrastruktura mjekësore moderne; Përmirësimi i shërbimeve sociale, duke ofruar mbështetje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara; Digjitalizimi i shërbimeve publike, duke lehtësuar qasjen e qytetarëve në dokumente dhe procedura).
3. **Urbanizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës** (Ndërtimi, zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve për qasje më të lehtë; Zgjerimi dhe modernizimi i sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit si dhe shtrirja e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave; Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik, veçanërisht në zonat rurale dhe periferike; Rritja e eficiencës në transportin publik dhe infrastrukturën ndërlidhëse; Integrimi i planeve të zhvillimit urban me mbrojtjen e tokës bujqësore, për një ekuilibër mes urbanizmit dhe ruajtjes së hapësirave të gjelbra).
4. **Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm** (Implementimi i strategjive të reduktimit të ndotjes; Zhvillimi i hapësirave të gjelbëruara, përfshirë pyllëzimin dhe ruajtjen e lumenjve; Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe riciklimi, duke zvogëluar ndikimin negativ në mjedis; Promovimi i ekoturizmit dhe trashëgimisë kulturore, duke ruajtur identitetin historik të komunës; Ndërtimi i sistemeve të efiçiencës së energjisë, për të ulur konsumimin e burimeve natyrore).
5. **Qeverisja e mirë dhe bashkëpunimi me komunitetin** (Rritja e transparencës në vendimmarrje, duke përmirësuar qasjen e qytetarëve në informacione publike; Fuqizimi i mekanizmave të llogaridhënies, për një administratë më efikase dhe të besueshme; Angazhimi i komunitetit në zhvillim, përmes forumeve dhe iniciativave të bashkëpunimit; Modernizimi i administratës, për një shërbim më efikas dhe cilësor; Përmirësimi i

komunikimit mes qeverisjes lokale dhe qendrore, për të rritur fondet dhe investimet në projekte strategjike).

Qëllimi strategjik 1: Zhvillimi ekonomik dhe fuqizimi i sektorit privat

Objektivi specifik 1.1 Mbështetja e së paku 20 bizneseve të vogla dhe të mesme.

Projekti 1.1.1 Hartimi i profilit ekonomik të komunës: Ky projekt ka për qëllim përgatitjen e një dokumenti analitik që pasqyron gjendjen aktuale ekonomike të komunës, sektorët kryesorë, potencialet për zhvillim dhe sfidat ekzistuese.
Projekti 1.1.2 Programi i zhvillimit të bizneseve të vogla: Përcaktimi i një fondi subvencionues për mbështetjen e bizneseve të reja, duke ofruar grante konkurruese për investime në pajisje, teknologji dhe shërbime për rritjen e kapaciteteve.
Projekti 1.1.2 Krijimi i platformës për mbështetje të ndërmarrësve: Zhvillimi i një platforme digjitale ku ndërmarrësit mund të marrin këshilla ligjore, financiare dhe administrative, si dhe të kenë qasje në mentorim për menaxhimin e bizneseve.

Projekti 1.1.4 Fondi i investimeve për bizneset e reja: Ngritja e një mekanizmi financues që lehtëson qasjen e bizneseve në kredi me kushte të favorshme dhe ofron garanci për investime strategjike në sektorë me potencial rritjeje.

Projekti 1.1.5 Ekspozita e bizneseve lokale: Organizimi i një panairi vjetor ku bizneset e vogla dhe të mesme promovojnë produktet dhe shërbimet e tyre, duke krijuar mundësi bashkëpunimi dhe zgjerim të tregut.

Projekti 1.1.6 Programi i trajnimit për ndërmarrësit e rinj: Realizimi i trajnimeve praktike mbi menaxhimin, marketingun dhe zhvillimin e produktit, për të fuqizuar aftësitë e sipërmarrësve dhe përmirësuar konkurrencën në treg.

Objektivi specifik 1.2 Zhvillimi i zonave industriale dhe fuqizimi i eksportit, duke përmirësuar kapacitetet lokale prodhuese.

Projekti 1.2.1 Planifikimi dhe krijimi i zonës industriale: Hartimi i një plani urbanistik për zhvillimin e një zone industriale të strukturuar, e pajisur me infrastrukturë moderne, rrjet energjetik të qëndrueshëm dhe qasje të lehtë në rrugët kryesore.

Projekti 1.2.2 Ndërtimi i infrastrukturës së prodhimit dhe logjistikës: Investime në magazina, zona të përpunimit dhe hapësira transporti për të lehtësuar prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve. Përfshirja e teknologjive moderne për menaxhimin efikas të stokut dhe logjistikës.

Projekti 1.2.3 Mbështetja financiare për prodhuesit lokalë: Të ofrohen subvencione dhe lehtësira tatimore për bizneset prodhuese që modernizojnë makinerinë dhe proceset e tyre, duke rritur kapacitetin e prodhimit dhe cilësinë e produkteve për eksport.

Projekti 1.2.4 Lehtësimi i procedurave për eksport dhe qasje në tregjet ndërkombëtare: Organizimi i seminareve dhe trajnimeve për kompanitë prodhuese mbi standardet ndërkombëtare, proceset e certifikimit dhe mundësitë për bashkëpunim me tregjet e huaja.

Projekti 1.2.5 Nxitja e partneriteteve me investitorë dhe kompani ndërkombëtare: Krijimi i një programi për tërheqjen e investitorëve të huaj, duke promovuar avantazhet e zonës industriale dhe kapacitetet lokale prodhuese në ekspozita dhe forume ekonomike.

Objektivi specifik 1.3 Përmirësimi i kushteve për investime të huaja, duke ofruar incentiva dhe infrastrukturë moderne.

Projekti 1.3.1 Zhvillimi i parkut industrial të Fushë Kosovës: Identifikimi dhe zhvillimi i një zone të veçantë për investime të huaja, me infrastrukturë moderne, rrjet energjetik të qëndrueshëm, qasje në rrugët kryesore dhe lehtësira fiskale për bizneset që vendosen aty. Kjo do të përfshijë qendrat e përpunimit, magazinimit dhe logjistikës për investitorët e huaj.

Projekti 1.3.2 Lehtësira fiskale dhe administrimi i investimeve të huaja: Krijimi i një pakete incentiva, përfshirë ulje tatimore, lehtësira administrative dhe subvencione për sektorë strategjikë si teknologjia, prodhimi dhe logjistika. Vendosja e një mekanizmi të veçantë për përshpejtimin e procedurave të licencimit dhe regjistrimit të bizneseve.

Projekti 1.3.3 Qendra për investitorët e huaj: Zhvillimi i një platforme digjitale dhe një qendre të dedikuar ku investitorët e huaj mund të marrin informacione mbi procedurat, mundësitë e investimit dhe mbështetjen institucionale. Kjo do të ndihmojë në lidhjen e bizneseve lokale me partnerët ndërkombëtarë, duke rritur komunikimin dhe transparencën.

Objektivi specifik 1.4 Inicimi i programeve të veçanta për gratë dhe të rinjtë.

Projekti 1.4.1 Programi i mbështetjes për gratë në ndërmarrësi: Krijimi i një fondi subvencionues për gratë sipërmarrëse, duke ofruar trajnime në menaxhimin e biznesit, financim fillestar dhe qasje në rrjetet e biznesit për rritjen e bashkëpunimeve.

Projekti 1.4.2 Akademia e inovacionit për të rinjtë: Organizimi i një akademie për të rinjtë ku marrin pjesë në kurse mbi teknologjinë, dizajnin dhe sipërmarrjen. Mbështetje për të zhvilluar startup-e, duke siguruar mentorim dhe financim pilot.

Projekti 1.4.3 Qendra e aftësimit profesional për gratë dhe të rinjtë, duke bashkëpunuar me kompani vendore për të krijuar mundësi punësimi dhe trajnime të specializuara.

Objektivi specifik 1.5 Nxitja e bujqësisë moderne, përfshirë investime në teknologji, mekanizim dhe agroturizëm

Projekti 1.5.1 Fondi për mekanizimin bujqësor: Sigurimi i një skeme financimi për fermerët e Fushë Kosovës, duke mundësuar blerjen e pajisjeve moderne bujqësore, makineri për përpunimin e produkteve dhe sistemet e ujitjes me eficiencë të lartë.

Projekti 1.5.2 Zhvillimi i agroturizmit në zonat rurale: Krijimi i një programi për promovimin e agroturizmit, duke ndihmuar fermerët të hapin ferma turistike, të ofrojnë eksperienca të drejtpërdrejta për vizitorët dhe të diversifikojnë burimet e tyre të të ardhurave.

Projekti 1.5.3 Subvencionimi i sistemeve të ujitjes dhe mbrojtjes së tokës: Mbështetje financiare për fermerët që investojnë në sisteme të avancuara të ujitjes dhe teknologji për ruajtjen e cilësisë së tokës, duke rritur produktivitetin dhe qëndrueshmërinë.

Projekti 1.5.4 Programi i certifikimit për produktet bujqësore: Ndihma për fermerët në certifikimin e produkteve të tyre sipas standardeve ndërkombëtare, duke lehtësuar eksportin dhe rritjen e konkurrencës në tregjet e jashtme.

Projekti 1.5.5 Diversifikimi i prodhimit bujqësor: Nxitja e kultivimit të kulturave të reja bujqësore dhe produkteve me vlerë të shtuar, si bimët medicinale dhe produktet organike, për të rritur mundësitë e tregut dhe të ardhurat e fermerëve.

Projekti 1.5.6 Ndërtimi i rrugëve bujqësore dhe kanaleve kulluese në Fushë Kosovë dhe fshatrat, Kuzmin, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Vragoli, Henc, Harilaq, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Bardh i Madh, Bardhi i Vogël, Graboc, Pomozotin, Lismir dhe Nakaradë: Ky projekt synon përmirësimin e infrastrukturës bujqësore në Fushë Kosovë dhe fshatrat përreth, përmes ndërtimit të rrugëve me zhavor dhe kanaleve kulluese për ujërat atmosferike. Kjo do të lehtësojë qasjen në tokat bujqësore, do të përmirësojë lëvizjen e mjeteve bujqësore dhe do të mbrojë tokën nga përmbytjet dhe erozioni.

Qëllimi strategjik 2: Rritja e cilësisë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale

Objektivi specifik 2.1. Ndërtimi dhe modernizimi i objekteve shkollore, duke përmirësuar infrastrukturën arsimore.

Projekti 2.1.1 Ndërtimi i shkollës në Fushë Kosovë – Faza II, në rrugën "Fazli Grajqevci".

Projekti 2.1.2 Instalimi i pompave termike në institucionet edukativo-arsimore: "Gëzimi Ynë", "Mihal Grameno – Anex I dhe Anex II" dhe "Daut Bogujevci".

Projekti 2.1.3 Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Lismir, Komuna e Fushë Kosovës.

Projekti 2.1.4 Ndërtimi i çerdhës në rrugën "Shukri Obertinca" – Faza II.

Projekti 2.1.5 Ndërtimi i çerdheve në fshatin Sllatinë e Madhe dhe në fshatin Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovës.

Projekti 2.1.6 Renovimi i objekteve shkollore përfshin shkollat: "Bajram Curri", "Mihal Grameno", "Mihal Grameno – Anex II", "Daut Bogujevci", "Vëllezërit Frashëri", "Zenel Salihu" dhe "Hivzi Sulejmani".

Projekti 2.1.7 Ndërtimi i sallave shkollore në shkollën "Mihal Grameno" – Anex III dhe në shkollën e re në rrugën "Fazli Grajqevci" në Fushë Kosovë.

Projekti 2.1.8 Digjitalizimi në objektet shkollore për shkollat fillore në Fushë Kosovë, përmes blerjes së smart boards për realizimin e orës mësimore në formë vizuale.

Projekti 2.1.9 Sigurimi i qasjes të barabartë për nxënësit me aftësi të kufizuara: Adaptimi i objekteve shkollore me rampa dhe ambiente të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke garantuar një sistem arsimor inkluziv.

Projekti 2.1.10 Blerja e paisjeve për shkollat fillore në Fushë Kosovë.

Objektivi specifik 2.2. Fuqizimi i programeve të aftësimit profesional, veçanërisht për të rinjtë dhe grupet e margjinalizuara.

Projekti 2.2.1 Qendra e aftësimit profesional: Hapja e një qendre me trajnime praktike në teknologji, zanate, bujqësi dhe shërbime, duke u fokusuar te grupet me më pak mundësi.

Projekti 2.2.2 Partneritete me bizneset për praktika pune: Marrëveshje me kompani vendore për ofrimin e trajnimeve dhe praktikave të punës, duke lidhur të rinjtë me tregun e punës.

Projekti 2.2.3 Subvencionimi i kurseve të certifikimit: Mbështetje financiare për kurse profesionale të akredituara, duke rritur mundësitë për punësim.

Projekti 2.2.4 Programi i mentorimit dhe zhvillimit të karrierës: Rrjet mentorësh për udhëzimin e të rinjve në karrierë, përgatitjen për intervista dhe zhvillimin e aftësive profesionale.

Objektivi specifik 2.3. Zhvillimi i sistemit shëndetësor përmes investimeve në pajisje dhe infrastruktura mjekësore moderne.

Projekti 2.3.1 Blerja e pajisjeve mjekësore për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Fushë Kosovë.

Projekti 2.3.2 Ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare (QMF) – Faza II, në rrugën "Gjergj Fishta", që përfshin përfundimin e pjesës së mbetur të oborrit.

Projekti 2.3.3 Digjitalizimi i sistemit shëndetësor: Implementimi i një sistemi elektronik për menaxhimin e dosjeve mjekësore dhe qasjen e pacientëve në konsultime online, duke përmirësuar efikasitetin dhe aksesin në shërbime shëndetësore.

Projekti 2.3.4 Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit parësor dhe preventiv: Fuqizimi i programeve të vaksinimit, kontrolleve periodike dhe fushatave ndërgjegjësuese për sëmundjet kronike, duke përmirësuar shëndetin publik në komunë.

Projekti 2.3.5 Blerja e autoambulancës për Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Fushë Kosovë.

Objektivi specifik 2.4. Përmirësimi i shërbimeve sociale, duke ofruar mbështetje për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.

Projekti 2.4.1 Ndihmë financiare për familjet në nevojë (800).

Projekti 2.4.2 Ndërtimi i shtëpisë për përkujdesjen e të moshuarve në fshatin Miradi e Poshtme, Komuna e Fushë Kosovës.

Projekti 2.4.3 Renovimi i objekteve banesore në rrugën "Bedri Pejani", Lagjja Bresje, Fushë Kosovë.

Projekti 2.4.4 Programi i asistencës për personat me aftësi të kufizuara: Sigurimi i shërbimeve të personalizuara për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë transport të përshtatur, pajisje ndihmëse dhe qasje më të lehtë në institucionet publike.

Projekti 2.4.5 Fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi për përfshirjen sociale: Organizimi i aktiviteteve informuese dhe edukative mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve, duke nxitur përfshirjen dhe eliminimin e barrierave në shoqëri.

Objektivi specifik 2.5. Digjitalizimi i shërbimeve publike, duke lehtësuar qasjen e qytetarëve në dokumente dhe procedura.

Projekti 2.5.1 Automatizimi dhe integrimi i bazave të të dhënave komunale: Lidhja e sistemeve të ndryshme të administratës publike për të lehtësuar qasjen e

institucioneve dhe qytetarëve në të dhëna zyrtare, duke reduktuar vonesat dhe rritjen e efikasitetit.

Projekti 2.5.2 Digjitalizimi i arkivave dhe dokumenteve publike: Transformimi i arkivave komunale në format elektronik, duke mundësuar qasje të shpejtë dhe të sigurt në dokumentacionin historik dhe administrativ për qytetarët dhe institucionet.

Qëllimi strategjik 3: Urbanizimi dhe përmirësimi i infrastrukturës

Objektivi specifik 3.1 Ndërtimi, zgjerimi dhe mirëmbajtja e rrugëve dhe trotuareve për qasje më të lehtë.

Projekti 3.1.1 Asfaltimi i rrugëve në Fushë Kosovë: "Pajazit Islami" me infrastrukturë përcjellëse dhe "Xheladin Idrizi".

Projekti 3.1.2 Asfaltimi i rrugës "Tahir Zemaj" në Fushë Kosovë, së bashku me infrastrukturën përcjellëse.

Projekti 3.1.3 Asfaltimi në Fushë Kosovë: Rrugët "Amir Elmazi" – Lot II, "Ymer Prizreni".

Projekti 3.1.4 Asfaltimi i rrugës dytësore – krah i rrugës "Fehmi Lladrovci" në fshatin Nakaradë.

Projekti 3.1.5 Asfaltimi i rrugës "Pashko Vasa" në Fushë Kosovë, lagjet 028 dhe 029.

Projekti 3.1.6 Asfaltimi i rrugës "Sogojeva" në fshatin Graboc.

Projekti 3.1.7 Asfaltimi i rrugëve në Bardh të Madh: "Qyqalla", "Nënhekurudha" (dytësore), "UÇK Bardhi" dhe "Rashica".

Projekti 3.1.8 Asfaltimi i rrugës "Lisi" në fshatin Bardh i Vogël.

Projekti 3.1.9 Asfaltimi i rrugëve në Sllatinë të Madhe: "Rruga e Pejës" (dytësore) dhe "Udha e Malit".

Projekti 3.1.10 Asfaltimi i rrugës "1 Tetori" (dytësore) në fshatin Sllatinë e Vogël.

Projekti 3.1.11 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Vragoli: "Butrinti", "Mahalla e Lartë", "9 Prilli", "Livadheve" dhe "Lidhja e Pejës".

Projekti 3.1.12 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Miradi e Epërme: "Bregu i Madh", "Lumi", "Gërvalla" dhe "Dëshmori".

Projekti 3.1.13 Asfaltimi i rrugës "Otava" në fshatin Harilaq.

Projekti 3.1.14 Asfaltimi i rrugës dytësore "Abdyl Henci" në fshatin Henc.

Projekti 3.1.15 Asfaltimi i rrugëve "Tahir Mehaj" dhe "Ejup Gashi" në fshatin Lismir.

Projekti 3.1.16 Asfaltimi i rrugëve "Meshari" dhe "Dimitrie Tocovic" në fshatin Kuzmin.

Projekti 3.1.17 Asfaltimi i rrugës dytësore "Kroi" dhe degëzimeve 1, 2 dhe 3 në fshatin Pomozotin.

Projekti 3.1.18 Asfaltimi i rrugëve në fshatin Miradi e Poshtme: "Miradi", "Graqanka", "Bllata", "Bardhosh Gërvalla", "Ylli i Dritës", "Përtej Lumit" dhe "Gjin Gazulli".

Projekti 3.1.19 Asfaltimi pranë parkut rekreativ "Pishat" në fshatin Sllatinë e Vogël.

Projekti 3.1.20 Blerja e automjetit për pastrim të rrugëve (Kamion me korpë dhe cisternë)

Projekti 3.1.21 Riparimi i rrugëve të asfaltuara në vendbanimet e komunës së Fushë Kosovës, përfshirë Fushë Kosovën dhe fshatrat: Kuzmin, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Vragoli, Henc, Harilaq, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Bardh i Madh, Graboc, Pomozotin, Lismir dhe Nakaradë.

Projekti 3.1.22 Ndërtimi dhe riparimi i trotuareve në vendbanimet e Komunës së Fushë Kosovës, përfshirë qytetin dhe fshatrat: Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Vragoli, Sllatinë e Madhe, Lismir, Bardh i Madh dhe Graboc.

Projekti 3.1.23 Rregullimi i rrugës Dardania në Fushë Kosovë – Lot II, që përfshin ndërtimin dhe riparimin e trotuareve, vendosjen e ndriçimit publik, largimin e terrasave, sinjalizimin rrugor dhe përmirësimin e infrastrukturës elektrike

Projekti 3.1.24 Rikonstruimi i rrugëve "Hajrullah Zymi" dhe "Enver Maloku" – Lot II, që përfshin ndërtimin e trotuareve, vendosjen e ndriçimit publik dhe përmirësimin e infrastrukturës elektrike.

Projekti 3.1.25 Rregullimi i hapësirave publike përgjatë rrugës "UÇK" në Bardh i Madh, Sllatinë e Vogël, Sllatinë e Madhe, Pomozotin dhe Graboc – Lot II, që përfshin ndërtimin e trotuareve, vendosjen e ndriçimit publik dhe gjelbërimin e zonës.

Projekti 3.1.26 Ndërtimi i rrethojave mbrojtëse për siguri në komunikacion përgjatë rrugës Pejë–M9, në segmentet që kalojnë nëpër fshatrat Vragoli dhe Sllatinë e Madhe.

Projekti 3.1.27 Shenjëzimi horizontal dhe vertikal i rrugëve në qytetin e Fushë Kosovës dhe në fshatrat e komunës.

Projekti 3.1.28 Renovimi dhe zgjerimi i stadiumit të qytetit "Ekrem Grajqevci" në Fushë Kosovë – Faza e dytë.

Projekti 3.1.29 Renovimi i fushave të futbollit me bari sintetik pranë shkollave: "Bajram Curri" në Henc, "Vëllezërit Frashëri" në Vragoli, "Zenel Salihu" në Pomozotin dhe "Lismiri" në Lismir.

Projekti 3.1.30 Ndërtimi i qendrës multifunksionale me objektet përcjellëse në rrugën "Nëna Tereza".

Objektivi specifik 3.2 Zgjerimi dhe modernizimi i sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit, duke reduktuar humbjet dhe ndotjen.

Projekti 3.2.1 Evidentimi i gjendjes së rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit.

Projekti 3.2.2 Ndërtimi i ujësjellësit në fshatin Harilaq - Loti II

Projekti 3.2.3 Ndërtimi i kanalizimeve atmosferike në Fushë Kosovë.

Projekti 3.2.4 Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit në fshatrat Sllatinë e Madhe dhe Sllatinë e Vogël.

Projekti 3.2.5 Impianti i ujërave të zeza.

Projekti 3.2.6 Fushata ndërgjegjësuese mbi përdorimin e qëndrueshëm të ujit Organizimi i aktiviteteve informuese për qytetarët dhe bizneset mbi mënyrat për kursimin dhe ruajtjen e cilësisë së ujit, duke promovuar praktika të qëndrueshme në nivel komunitar.

Projekti 3.2.7 Evidentimi i gjendjes ekzistuese të lokaliteteve të pambuluara më shërbime të grumbullimit të mbeturinave.

Projekti 3.2.8 Përpilimi i listës prioritare për zgjerimin e shërbimit të grumbullimit të mbeturinave.

Projekti 3.2.9 Rritja e mbulueshmërisë me shërbime për mbeturina rreth 90%, deri në fund të vitit 2029.

Objektivi specifik 3.3 Zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në qytet, e veçanërisht në zonat rurale dhe periferike.

Projekti 3.3.1 Evidentimi i gjendjes ekzistuese.

Projekti 3.3.2 Përpilimi i listës për ndriçim sipas prioritetit.

Projekti 3.3.3 Vendosja e ndriçimit publik dhe mirëmbajtja e plotë e tij në qytetin e Fushë Kosovës dhe në fshatrat.

Projekti 3.3.4 Ndriçimi i hapësirave publike dhe parqeve: Sigurimi i ndriçimit adekuat në parqe, sheshe dhe zona rekreative për të rritur sigurinë dhe qasjen në hapësirat publike gjatë orëve të mbrëmjes.

Projekti 3.3.5 Mirëmbajtja dhe modernizimi i ndriçimit ekzistues.

Objektivi specifik 3.4. Rritja e eficiencës në transportin publik dhe infrastrukturën ndërlidhëse.

Projekti 3.4.1 Zgjerimi i linjave të transportit urban dhe ndërurban: Rritja e numrit të linjave të autobusëve në zonat periferike dhe rurale, duke siguruar lidhje më të shpejtë dhe të rregullt me qendrën e qytetit dhe rajonet përreth.

Projekti 3.4.2 Modernizimi i sistemit të biletave dhe informacionit për pasagjerët: Implementimi i biletave elektronike dhe aplikacioneve mobile për ndjekjen e orareve, duke reduktuar vonesat dhe lehtësuar aksesin në transportin publik.

Projekti 3.4.3 Ndërtimi i urave në Pomozotin, Miradi e Poshtme dhe Vragoli: Ky projekt synon ndërtimin e urave funksionale për të përmirësuar lëvizjen e qytetarëve dhe integrimin e zonave rurale me rrjetin e transportit publik.

Objektivi specifik 3.5. Integrimi i planeve të zhvillimit urban me mbrojtjen e tokës bujqësore, për një ekuilibër mes urbanizmit dhe ruajtjes së hapësirave të gjelbra.

Projekti 3.5.1 Hartimi i një plani urbanistik të qëndrueshëm: Krijimi i një strategjie që balancon zgjerimin urban me mbrojtjen e tokës bujqësore, duke përcaktuar zona të dedikuara për ndërtim dhe hapësira të ruajtura për bujqësi dhe natyrë.

Projekti 3.5.2 Subvencionimi i fermerëve për ruajtjen e tokës bujqësore: Të ofrohen stimuj për fermerët që mbajnë tokën e tyre bujqësore aktive, duke përfshirë mbështetje financiare dhe asistencë teknike për menaxhimin e qëndrueshëm të tokës.

Projekti 3.5.3 Fushata ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e mbrojtjes së tokës bujqësore.

Projekti 3.5.4 Ndërtimi i parqeve, hapësirave të reja rekreative dhe këndeve të lojërave në vendbanimet e Komunës së Fushë Kosovës, përfshirë qytetin dhe fshatrat.

Qëllimi strategjik 4: Mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Objektivi specifik 4.1 Implementimi i strategjive të reduktimit të ndotjes.

Projekti 4.1.1 Fushata ndërgjegjësimi për reduktimin e ndotjes: Organizimi i aktiviteteve edukative për qytetarët dhe bizneset mbi ndikimin e ndotjes dhe mënyrat për zvogëlimin e saj në jetën e përditshme.

Projekti 4.1.2 Nxitja e përdorimit të mjeteve të transportit të pastër: Nxitja e përdorimit të biçikletave, transportit elektrik dhe masave të gjelbra për lëvizje urbane më të qëndrueshme.

Projekti 4.1.3 Zhvillimi i sistemit të riciklimit dhe menaxhimit të mbetjeve: Zgjerimi i programeve të riciklimit dhe vendosja e sistemeve moderne për trajtimin e mbetjeve urbane dhe industriale.

Objektivi specifik 4.2 Zhvillimi i hapësirave të gjelbëruara, përfshirë pyllëzimin dhe ruajtjen e lumenjve.

Projekti 4.2.1 Mbjellja e pemëve dekorative si dhe vendosja e ulëseve dhe shportave për mbeturina në vendbanimet e Komunës së Fushë Kosovës, përfshirë qytetin dhe fshatrat.

Projekti 4.2.2 Mirëmbajtja e vazhdueshme e sipërfaqeve të gjelbëruara.

Projekti 4.2.3 Parandalimi i prerjes ilegale të pyjeve.

Projekti 4.2.4 Krijimi i shtabit të emergjencës në rast të paraqitjes së zjarreve në pyje.

Projekti 4.2.5 Restaurimi dhe mbrojtja e lumit Sitnica: Zbatimi i masave për pastrimin dhe ruajtjen e lumit Sitnica, i cili përshkon komunën e Fushë Kosovës, me qëllim të parandalimit të ndotjes dhe mbrojtjes së biodiversitetit ujor. Ky projekt synon rikthimin e funksionit ekologjik të lumit dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit përgjatë brigjeve të tij.

Objektivi specifik 4.3 Menaxhimi i mbetjeve urbane dhe riciklimi, duke zvogëluar ndikimin negativ në mjedis.

Projekti 4.3.1 Zhvillimi i sistemit të selektimit dhe riciklimit të mbetjeve: Vendosja e kontejnerëve të ndarë për mbetjet plastike, organike dhe të tjera, duke rritur riciklimin dhe reduktuar mbetjet e dëmshme për mjedisin.

Projekti 4.3.2 Ndërtimi i impianteve të përpunimit të mbetjeve: Krijimi i qendrave moderne për trajtimin e mbetjeve dhe shndërrimin e tyre në materiale të ripërdorshme, duke reduktuar ndotjen dhe kostot e depozitimit.

Projekti 4.3.3 Fushata ndërgjegjësimi për riciklimin dhe reduktimin e mbetjeve: Organizimi i programeve edukative për komunitetin mbi rëndësinë e riciklimit dhe metodat praktike për zvogëlimin e mbetjeve të përditshme.

Projekti 4.3.4 Subvencionimi i bizneseve për përdorimin e materialeve të riciklueshme: Mbështetje për kompanitë që adoptojnë materiale të riciklueshme dhe sisteme të qëndrueshme, duke ulur konsumimin e plastikës dhe mbetjeve të pakalueshme.

Objektivi specifik 4.4 Promovimi i ekoturizmit dhe trashëgimisë kulturore, duke ruajtur identitetin historik të komunës.

Projekti 4.4.1 Investim në infrastrukturë të turizmit.

Projekti 4.4.2 Ndërtimi i terreneve sportive dhe rekreacionit.

Projekti 4.4.3 Restaurimi dhe promovimi i monumenteve historike: Restaurimi i monumenteve dhe objekteve me rëndësi kulturore, duke i integruar në udhëzuesit turistik për të rritur vizitat dhe ndërgjegjësimin mbi trashëgiminë lokale.

Projekti 4.4.4 Themelimi i qendrës informative të trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Projekti 4.4.5 Shenjëzimi me tabela informuese vlerave të trashëgimisë kulturore.

Projekti 4.4.6 Shenjëzimi i drejtimeve rrugore që çojnë drejt monumenteve të trashëgimisë.

Projekti 4.4.7 Përgatitja e broshurave informuese, deri në mars të vitit 2026.

Projekti 4.4.8 Promovimi i atraksioneve turistike të komunës në platformat më të njohura online.

Objektivi specifik 4.5 Ndërtimi i sistemeve të efiçiencës së energjisë, për të ulur konsumimin e burimeve natyrore.

Projekti 4.5.1 Aplikimi i masave të EE-së në ndërtesën e komunës.

Projekti 4.5.2 Sistemi solar në administratë.

Projekti 4.5.3 Sistemi solar në QKMF.

Projekti 4.5.4 Sistemi solar në objektet arsimore.

Projekti 4.5.5 Aplikimi i masave të EE-së në ndriçimin publik.

Qëllimi strategjik 5: Qeverisja e mirë dhe bashkëpunimi me komunitetin

Objektivi specifik 5.1 Rritja e transparencës në vendimmarrje, duke përmirësuar qasjen e qytetarëve në informacione publike.

Projekti 5.1.1 Informimi i vazhdueshëm mbi shërbimet komunale: Krijimi i mekanizmave për njoftimin e shpejtë të qytetarëve dhe bizneseve mbi format e reja të shërbimeve komunale, përmes kanaleve digjitale dhe komunikimit direkt.

Projekti 5.1.2 Përditësimi i informacionit në uebfaqen zyrtare: Rishikimi dhe rifreskimi i përmbajtjes së uebfaqes komunale për të garantuar informacione të sakta mbi shërbimet dhe dokumentet e nevojshme për qytetarët.

Projekti 5.1.3 Publikimi i rregullt i raporteve: Sigurimi i qasjes në raporte gjashtëmujore, vjetore dhe analiza të tjera relevante në uebfaqe, duke rritur llogaridhënien institucionale dhe besimin e qytetarëve.

Objektivi specifik 5.2 Fuqizimi i mekanizmave të llogaridhënies, për një administratë më efikase dhe të besueshme.

Projekti 5.2.1 Vlerësimi i kënaqshmërisë për shërbimet komunale: Implementimi i një sistemi të matjes së përvojës së qytetarëve dhe bizneseve përmes pyetësorëve *online*, duke identifikuar sfidat dhe fushat për përmirësim.

Projekti 5.2.2 Takime publike dhe konsultime: Organizimi i diskutimeve të hapura për pjesëmarrjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Projekti 5.2.3 Mekanizma raportimi dhe reagimi: Krijimi i sistemit ku qytetarët mund të raportojnë shqetësime dhe sugjerojnë përmirësime.

Objektivi specifik 5.3 Angazhimi i komunitetit në zhvillim, përmes forumeve dhe iniciativave të bashkëpunimit.

Projekti 5.3.1 Organizimi i forumeve publike për çështje lokale: Takime periodike ku qytetarët mund të diskutojnë sfidat dhe propozimet për përmirësime në komunitet.

Projekti 5.3.2 Fushata ndërgjegjësimi mbi përfshirjen aktive të komunitetit: Edukimi i qytetarëve mbi rëndësinë e angazhimit në politikat lokale dhe mënyrat për të kontribuar në zhvillimin e qytetit.

Objektivi specifik 5.4 Modernizimi i administratës, për një shërbim më efikas dhe cilësor.

Projekti 5.4.1 Sistematizimi dhe digjitalizimi i arkivit komunal.

Projekti 5.4.2 Zhvillimi i sistemit elektronik për menaxhimin e dokumenteve: Implementimi i një sistemi elektronik për arkivimin dhe qarkullimin e dokumenteve, duke rritur efikasitetin dhe qasjen e shpejtë në informacion.

Projekti 5.4.3 Blerja e makinave për pastrim të dyshemeve në objektet e administratës, shëndetësisë dhe arsimit – përmirësimi i kushteve higjienike dhe efikasitetit në mirëmbajtjen e hapësirave publike.

Projekti 5.4.4 Trajnimi i stafit administrativ për rritjen e performancës: Program i vazhdueshëm për përmirësimin e aftësive të stafit në përdorimin e teknologjive të reja dhe metodave moderne të menaxhimit.

Projekti 5.4.5 Ndërtimi i rrethojave me infrastrukturë përcjellëse në varrezat e qytetit të Fushë Kosovës, si dhe në varrezat e fshatrave Miradi e Epërme dhe Sllatinë e Madhe. Ky projekt synon përmirësimin e kushteve fizike dhe funksionale në varrezat publike, përmes ndërtimit të rrethojave mbrojtëse, shtigjeve të qasjes, ndriçimit dhe elementeve përcjellëse, duke kontribuar në ofrimin e një shërbimi më të organizuar, të sigurt dhe me dinjitet për komunitetin.

Projekti 5.4.6 Ndërtimi i pllakave memoriale në varrezat e dëshmorëve në Fushë Kosovë.

Objektivi specifik 5.5 Përmirësimi i komunikimit mes qeverisjes lokale dhe qendrore, për të rritur fondet dhe investimet në projekte strategjike.

Projekti 5.5.1 Krijimi i mekanizmave të koordinimit institucional: Vendosja e strukturave të rregullta për dialog mes komunës dhe institucioneve qendrore, duke garantuar sinkronizim efektiv të prioriteteve.

Projekti 5.5.2 Hartimi i projekteve të detajuara për financim: Zhvillimi i dokumentacionit dhe studimeve të fizibilitetit për të siguruar mbështetje financiare nga niveli qendror dhe donatorët ndërkombëtarë.

Projekti 5.5.3 Nxitja e partneriteteve për investime strategjike: Promovimi i bashkëpunimeve me institucionet qendrore dhe sektorin privat për të zhvilluar projekte infrastrukturore dhe zhvillimore në komunë.

7. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2026–2030 e komunës së Fushë Kosovës përfshin një plan veprimi trevjeçar (*shih shtojcën 1*), që mbulon periudhën 2026–2028 dhe përcakton aktivitetet, afatet kohore, kostot, burimet e financimit dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin. Ky plan do të rishikohet çdo vit, ose sipas nevojës, në kuadër të sistemit të monitorimit të përcaktuar në strategji.

Monitorimi i zbatimit të strategjisë do të realizohet përmes indikatorëve matës të vendosur në nivel të objektivave specifike, duke mundësuar një vlerësim të vazhdueshëm dhe të matshëm të progresit. Për të siguruar transparencë dhe llogaridhënie, komuna e Fushë Kosovës do të zbatojë një mekanizëm të rregullt raportimi.

Komuna do të formojë një grup punues për monitorimin e implementimit të planit të veprimit, i cili do të ketë mandat të qartë dhe afate kohore për raportim. Raportet e grupit punues do të dorëzohen në Kuvendin Komunal brenda tremujorit të parë të vitit pasues dhe do të përmbajnë: shkallën e zbatimit të treguesve, problemet e hasura gjatë zbatimit, masat korrigjuese të ndërmarra dhe ndikimin e projekteve dhe qëndrueshmërinë e rezultateve.

Një vlerësim afatmesëm i planifikuar për vitin 2028 do të shërbejë për identifikimin e progresit dhe sfidave, si dhe për ri-vlerësimin e treguesve dhe aktiviteteve aty ku është e nevojshme, pa ndryshuar objektivat e përgjithshme dhe specifike të strategjisë. Një vlerësim përfundimtar në vitin 2030 do të analizojë ndikimin e përgjithshëm të Strategjisë, do të vlerësojë arritjen e rezultateve të synuara dhe do të japë rekomandime konkrete për periudhat pasuese.

Monitorimi i vazhdueshëm do të shërbejë si mekanizëm kyç për përmirësimin e politikave lokale, identifikimin e sfidave dhe pengesave, si dhe rritjen e efikasitetit të investimeve publike. Ky proces do të forcojë kapacitetet institucionale të komunës për menaxhimin e zhvillimit ekonomik lokal dhe për zbatimin e projekteve strategjike.

Qasja gjithëpërfshirëse e monitorimit synon të garantojë zhvillim të qëndrueshëm, progres të vazhdueshëm dhe krijimin e një baze solide për rritjen ekonomike të Komunës së Fushë Kosovës. Në këtë mënyrë, strategjia do të nxisë investime të reja, do të kontribuojë në rritjen e punësimit dhe do të përmirësojë mirëqenien e qytetarëve, duke krijuar një mjedis më të favorshëm për zhvillim afatgjatë.

8. NDIKIMI BUXHETOR

BUXHETI KOMUNAL – Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Fushë Kosovës përfaqëson një dokument thelbësor të nivelit të lartë strategjik komunal. Ky dokument pasqyron objektivat e përgjithshme të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, si dhe strukturën e tyre sipas kategorive ekonomike, në përputhje me qëllimet zhvillimore të komunës së Fushë Kosovës. Për më tepër, KAB shërben si një mjet strategjik për procesin e hartimit të buxhetit, duke lidhur burimet e disponueshme me prioritetet e komunës, bazuar në vazhdimësinë e programeve komunale gjatë tre viteve të ardhshme.

Një nga sfidat kryesore për komunat në Kosovë është mungesa e një fondi qendror të strukturuar për investime kapitale, që do të menaxhohej në mënyrë të unifikuar nga qeveria. Po ashtu, mungesa e një tregu kreditor funksional e kufizon aftësinë e komunave për të siguruar financime me kamata të ulëta për projekte zhvillimore. Mungesa e mekanizmave për fonde emergjente gjithashtu vështirëson përgjigjen ndaj situatave të paparashikuara.

Komunat përballen me pabarazi të theksuar financiare, ku vetëm 18% e të hyrave vijnë nga të hyrat vetanake, ndërsa 82% e buxhetit mbështetet nga granti qendror (Buxheti i Kosovës), duke rritur varësinë nga fondet qeveritare dhe kufizuar autonominë lokale për investime.[48]

Buxheti i komunës së Fushë Kosovës bazohet në dy burime kryesore: grantet nga qeveria dhe të hyrat vetanake. Për vitin 2025, buxheti i përgjithshëm i komunës është 16,747,839€. Nga këto, 13,288,164€ (79.34%) janë siguruar nga granti qeveritar, ndërsa 3,459,675€ (20.66%) pritet të gjenerohen nga të hyrat vetanake.

Pjesa më e madhe e buxhetit total të komunës së Fushë Kosovës vazhdon të mbështetet kryesisht nga transferet qeveritare, një trend që pritet të vazhdojë edhe gjatë tri viteve të ardhshme. Për më shumë detaje, referojuni tabelës dhe grafikut të mëposhtëm.

Burimet e financimit: Përbëhen nga të hyrat vetanake të komunës, grantet qeveritare, grantet e donatorëve të jashtëm dhe huamarrja komunale.



Të hyrat vetanake komunale janë mjetet financiare që mblidhen nga taksat, tarifat, gjobat, pagesat për shërbimet publike të ofruara nga komuna, qiratë nga pronat e paluajtshme në pronësi të komunës, të hyrat nga shitja e pasurive komunale, ato nga ndërmarrjet komunale, bashkë pagesat nga shërbimet në arsim dhe shëndetësi, etj.[49]

Komunat pranojnë grante operative nga Buxheti i Konsoliduar i Republikës së Kosovës. Grantet operative janë: grantet e përgjithshme, grantet specifike për arsim dhe grantet specifike për shëndetësi. Në vitin 2025, totali i grantit qeveritar për komunën e Fushë Kosovës ishte 13,288,164€. Nga kjo shumë, granti i përgjithshëm ishte 5,916,282€, duke përbërë 44.5% të

[48] Strategjinë për vetëqeverisje lokale 2016-2026, fq. 23.
[49] Ligji nr. 03/l-049 për financat e pushtetit lokal.


totalit, granti për arsim ishte 5,530,790€, që përfaqësonte 41.6%. Ndërsa granti për shëndetësi arriti në 1,841,091€, ose 13.9%.

Tab. 11 Burimet e financimit në komunën e Fushë Kosovës (€), periudha 2026-2028

BURIMI I TË HYRAVE	2025	Planifikimi 2026	Vlerësimi 2027	Vlerësimi 2028
Granti i përgjithshëm	5,916,282	12,603,039	13,575,325	14,665,952
Granti i arsimit	5,530,790	7,221,020	7,437,651	7,660,780
Granti i shëndetësisë	1,841,091	2,555,776	2,632,449	2,711,422
Gjithsej granti qeveritar	**13,288,163**	**22,379,835**	**23,645,425**	**25,038,154**
Huamarrja në shëndetësi	-	-	-	-
Të hyrat vetanake	**3,459,675**	**4,423,751**	**4,713,766**	**4,727,669**
GJITHSEJ BUXHETI	**16,747,838**	**26,803,586**	**28,359,191**	**29,765,823**

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Fushë Kosovës 2026-2028.

Graf. 15 Mesatarja e burimeve të financimit në komunën e Fushë Kosovës (%), periudha 2025-2028



Duke u bazuar në të dhënat e tabelës nr. 6, është kalkuluar mesatarja e grantit qeveritar dhe e të hyrave vetanake për periudhën 2025-2028. Rezultatet tregojnë se mesatarisht 83% e buxhetit të komunës së Fushë Kosovës mbështetet nga grantet qeveritare, ndërsa 17% nga të hyrat vetanake.

Burimi: Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Fushë Kosovës 2026-2028.

Tab. 12 Planifikimi i të hyrave vetanake në komunën e Fushë Kosovës (€), 2026-2028

STRUKTURA E TË HYRAVE VETANAKE	2026	2027	2028
Taksa për regjistrimin e automjeteve	180,000	181,000	181,600
Taksa komunale për leje ndërtimi	1,600,000	1,610,000	1,625,000
Taksa për regjistrimin e trashëgimisë - bartja e pronës	86,000	86,500	90,000
Taksë administrative (certifikata, etj.)	50,000	52,000	53,000
Taksë administrative - fletëkërkesat	12,800	13,000	13,500
Taksa për legalizimin e objekteve	37,000	37,800	38,500
Taksa për leje rrënimi	9,800	10,000	11,000
Taksa ndërrimi i destinimit të tokës	175,000	177,000	185,000
Taksë për certifikata të pronësisë dhe kopje plani	100,000	110,000	120,000
Leje mjedisore komunale	177,500	180,000	185,000
Regjistrimi i pengut - hipoteka	25,000	25,500	26,000
Gjobat nga inspektorati	6,200	6,350	7,000
Inspektimet (ushqimore, higjieniko-sanitare, veterinë etj.)	10,000	10,200	10,800
Të hyrat nga shërbimet e ndryshme (qiraja etj.)	2,500	2,700	2,800
Të hyrat nga tatimi në pronë	1,144,460	1,227,434	1,239,708
Të hyrat nga tatimi në tokë	269,231	325,769	327,398
Të hyrat nga arsimi	140,000	155,000	170,000
Të hyrat nga shëndetësia	85,000	95,000	100,000
Të tjera	413,260	408,513	341,363
GJITHSEJ	**4,523,751**	**4,713,766**	**4,727,669**

Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Fushë Kosovës 2026-2028.*

Në tabelën e mëparshme është paraqitur struktura e planifikuar e të hyrave vetanake të komunës së Fushë Kosovës për periudhën 2026-2028. Siç mund të vërehet, burimet kryesore të këtyre të hyrave përbëhen kryesisht nga taksat dhe tatimet lokale. Konkretisht, mesatarisht 35% e të hyrave vetanake janë planifikuar të sigurohen nga taksa komunale për leje ndërtimi, që përbën pjesën më të madhe të të ardhurave. Ndërsa, rreth 26% e të hyrave vetanake pritet të gjenerohen nga tatimi në pronë, duke reflektuar rëndësinë e këtij burimi në strukturën financiare të komunës. Pjesa e mbetur, që përbën rreth 39% të të ardhurave totale, është e shpërndarë në burime të tjera të hyrash, si taksat administrative, tarifat për shërbime komunale dhe të ardhura nga sektorë të ndryshëm, të cilat kontribuojnë në mënyrë më të vogël por të qëndrueshme në buxhet.

Struktura e shpenzimeve: Siç shihet në vijim, shpenzimet rrjedhëse përbëjnë mesatarisht 62.9%, ndërsa shpenzimet kapitale zënë 37.1%. Brenda kategorisë së shpenzimeve rrjedhëse, shumat


më të larta dedikohen për paga dhe mëditje, të ndjekura nga shpenzimet për mallra dhe shërbime, subvencione dhe shpenzimet komunale.

Tab. 13 Struktura e shpenzimeve buxhetore në komunën e Fushë Kosovës (€), vlerësim për periudhën 2026-2028

STRUKTURA E SHPENZIMEVE BUXHETORE	2026	%	2027	%	2028	%
Pagat dhe mëditjet	11,098,312	68.1	12,130,205	68.0	12,815,790	66.3
Mallrat dhe shërbimet	3,057,122	18.8	3,464,419	19.4	3,990,929	20.7
Subvencionet dhe transferet	1,708,751	10.5	1,786,075	10.0	2,023,000	10.5
Shpenzime komunale	428,400	2.6	466,000	2.6	496,800	2.6
Gjithsej shpenzime rrjedhëse	*16,292,585*	*100.0*	*17,846,699*	*100.0*	*19,326,519*	*100.0*
Shpenzimet rrjedhëse	**16,292,585**	**60.8**	**17,846,699**	**62.9**	**19,326,519**	**64.9**
Shpenzime kapitale	**10,511,000**	**39.2**	**10,512,491**	**37.1**	**10,439,302**	**35.1**
GJITHSEJ	**26,803,586**	**100.0**	**28,359,191**	**100.0**	**29,765,823**	**100.0**

Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Fushë Kosovës 2026-2028*.

Graf. 16 Struktura mesatare e shpenzimeve në komunën e Fushë Kosovës (%), vlerësim për periudhën 2026-2028



Burimi: Adaptuar nga: *Korniza afatmesme buxhetore e komunës së Fushë Kosovës 2026-2028*.

VLERËSIMI BUXHETOR – ***Vlerësimi i përgjithshëm i kostos së aktiviteteve:*** Plani i veprimit të strategjisë për zhvillim ekonomik lokal 2026-2028 për komunën e Fushë Kosovës, ka një kosto totale të zbatimit prej 17,829,000€, duke përfshirë shpenzimet për projekte kapitale, subvencione për sektorin privat, si dhe investime në zhvillimin e kapaciteteve lokale.

Burimet e financimit të strategjisë: Ky vlerësim buxhetor është ndarë sipas kategori specifike, ku një pjesë e financimit është e mbështetur nga buxheti komunal, ndërsa burime shtesë pritet të vijnë nga grantet qeveritare, donatorë ndërkombëtarë dhe investime të sektorit privat. Monitorimi i zbatimit do të kryhet në bazë të indikatorëve ekonomikë dhe socialë, për të garantuar transparencë dhe efektivitet në alokimin e fondeve.

SHTOJCA 1

Plani për zbatimin e strategjisë për zhvillim ekonomik lokal

PLANI I VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E SZHEL

Qëllimi strategjik #1: Zhvillimi ekonomik dhe fuqizimi i sektorit privat

Objektivi specifik 1.1	**Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit**			**Gjendja bazë**	**Caku 2026**	**Caku 2027**	
	- Numri i bizneseve të mbështetura - Numri i ndërmarrësve të trajnuar - Funksionalizimi i platformës digjitale - Numri i bizneseve pjesëmarrëse në ekspozitën vjetore - Rritja e numrit të vendeve të punës - Dokumenti i profilit ekonomik të komunës			0%	67%	100%	
	Aktiviteti/Projekti	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale**	**Burimi i financimit**	**Institucioni udhëheqës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultati**
Mbështetja e së paku 20 bizneseve të vogla dhe të mesme	1.1.1 Hartimi i profilit ekonomik të komunës	2027	10,000€	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Dokument i profilit ekonomik i hartuar dhe i publikuar si bazë për politika dhe investime
	1.1.2 Programi i zhvillimit të bizneseve të vogla	2026-2028	**200,000€** *2026: 70,000€* *2027: 65,000€* *2028: 65,000€*	Komuna e Fushë Kosovës në bashkëpunim me sektorin publiko-privat si dhe me OJQ-të e ndryshme lokale dhe ndërkombëtare	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, OJQ	Bizneset e vogla të mbështetura dhe të zhvilluara përmes trajnimeve, subvencioneve dhe partneriteteve
	1.1.3 Krijimi i platformës për mbështetje të ndërmarrësve	2026-2028	**15,000€** *2026: 5,000€* *2027: 5,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, donatorët, ministritë relevante, OJQ	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, donatorët, ministritë	Platformë digjitale funksionale për mbështetje të ndërmarrësve

			2028: 5,000€			relevante, OJQ	
	1.1.4 Fondi i investimeve për bizneset e reja	2026-2028	**300,000€** *2026: 100,000€* *2027: 100,000€* *2028: 100,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, donatorët, ministritë relevante, OJQ	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, donatorët, ministritë relevante, OJQ	Fondi i krijuar i investimeve për bizneset e reja
	1.1.5 Ekspozita e bizneseve lokale	2026-2028	**5,000€** *2026: 2,000€* *2027: 1,500€* *2028: 1,500€*	Komuna e Fushë Kosovës, bizneset	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Ekspozita vjetore me pjesëmarrje të bizneseve lokale
	1.1.6 Programi i trajnimit për ndërmarrësit e rinj	2026-2028	**10,000€** *2026: 4,000€* *2027: 3,000€* *2028: 3,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, OJQ	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, OJQ	Ndërmarrësit e rinj të trajnuar për menaxhim dhe zhvillim të bizneseve
Objektivi specifik 1.2	**Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit**			**Gjendja bazë**	**Caku 2026**	**Caku 2027**	
	- Hartimi dhe miratimi i planit urbanistik - Numri i bizneseve prodhuese të mbështetura - Numri i kompanive pjesëmarrëse në trajnime për eksport - Numri i investitorëve të huaj të kontaktuar - Rritja e kapacitetit prodhues dhe eksportues			0%	40%	100%	
	Aktiviteti/Projekti	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale**	**Burimi i financimit**	**Institucioni udhëheqës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultati**
Zhvillimi i zonave industriale dhe fuqizimi i eksportit, duke përmirësuar kapacitetet	1.2.1 Planifikimi dhe krijimi i zonës industriale	2026-2028	**150,000€** *2026: 50,000€* *2027: 50,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës,	Zona industriale e planifikuar dhe krijuar

lokale prodhuese			*2028: 50,000€*	relevante		ministritë relevante	
	1.2.2 Ndërtimi i infrastrukturës së prodhimit dhe logjistikës	2026-2028	**300,000€** *2026: 100,000€* *2027: 100,000€* *2028: 100,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Infrastruktura e prodhimit dhe logjistikës e ndërtuar
	1.2.3 Mbështetja financiare për prodhuesit lokalë	2026-2028	**100,000€** *2026: 40,000€* *2027: 30,000€* *2028: 30,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Prodhuesit lokalë të mbështetur financiarisht
	1.2.4 Lehtësimi i procedurave për eksport dhe qasje në tregjet ndërkombëtare	2026-2028	**50,000€** *2026: 20,000€* *2027: 15,000€* *2028: 15,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Procedurat për eksport të lehtësuara dhe bizneset lokale me qasje më të thjeshtë në tregjet ndërkombëtare
	1.2.5 Nxitja e partneriteteve me investitorë dhe kompani ndërkombëtare	2026-2028	**100,000€** *2026: 40,000€* *2027: 30,000€* *2028: 30,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Partneritete me investitorë dhe kompani ndërkombëtare janë krijuar
Objektivi specifik 1.3	**Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit**			**Gjendja bazë**	**Caku 2026**	**Caku 2027**	

	- Sipërfaqja e parkut industrial - Numri i bizneseve të huaja të vendosura - Numri i bizneseve që përfitojnë nga lehtësirat fiskale dhe administrative - Funksionalizimi dhe përdorimi i platformës digjitale për investitorët - Numri i partneriteteve të krijuara mes bizneseve lokale dhe investitorëve ndërkombëtarë			0%	35%	100%	
	Aktiviteti/Projekti	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale**	**Burimi i financimit**	**Institucioni udhëheqës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultati**
Përmirësimi i kushteve për investime të huaja, duke ofruar incentiva dhe infrastrukturë moderne	1.3.1 Zhvillimi i parkut industrial të Fushë Kosovës	2026-2028	**2,000,000€** *2026: 700,000€* *2027: 650,000€* *2028: 650,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Parku industrial i Fushë Kosovës i zhvilluar dhe funksionalizuar
	1.3.2 Lehtësira fiskale dhe administrimi i investimeve të huaja	2026-2028	**25,000€** *2026: 10,000€* *2027: 7,500€* *2028: 7,500€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Lehtësirat fiskale janë ofruar dhe administrimi i investimeve të huaja është përmirësuar
	1.3.3 Qendra për investitorët e huaj	2026-2028	**100,000€** *2026: 40,000€* *2027: 30,000€* *2028: 30,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Qendra për investitorët e huaj është krijuar dhe funksionalizuar
Objektivi specifik 1.4	**Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit**			**Gjendja bazë**	**Caku 2026**	**Caku 2027**	
	- Numri i grave që përfitojnë nga fondi subvencionues për ndërmarrësi - Numri i të rinjve pjesëmarrës në Akademinë e Inovacionit - Numri i trajnimeve të realizuara për gratë dhe të rinjtë			0%	50%	100%	
	Aktiviteti/Projekti	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale**	**Burimi i financimit**	**Institucioni udhëheqës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultati**

Inicimi i programeve të veçanta për gratë dhe të rinjtë	1.4.1 Programi i mbështetjes për gratë në ndërmarrësi	2026-2028	**70,000€** *2026: 30,000€* *2027: 20,000€* *2028: 20,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Gratë në ndërmarrësi janë mbështetur përmes trajnimeve, granteve
	1.4.2 Akademia e inovacionit për të rinjtë	2026-2028	**50,000€** *2026: 20,000€* *2027: 15,000€* *2028: 15,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Akademia e inovacionit për të rinjtë është themeluar
	1.4.3 Qendra e aftësimit profesional për gratë dhe të rinjtë	2026	30,000€	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorët	Qendra e aftësimit profesional për gratë dhe të rinjtë është krijuar
Objektivi specifik 1.5	**Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit**			**Gjendja bazë**	**Caku 2026**	**Caku 2027**	
	- Numri i fermerëve të mbështetur - Sipërfaqja e tokës bujqësore e përfshirë në sisteme moderne të ujitjes dhe mbrojtjes - Numri i produkteve bujqësore të certifikuara - Numri i kilometrave të rrugëve bujqësore dhe kanaleve kulluese të ndërtuara			0%	50%	100%	
	Aktiviteti/Projekti	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale**	**Burimi i financimit**	**Institucioni udhëheqës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultati**
Nxitja e bujqësisë moderne, përfshirë investime në teknologji, mekanizim dhe agroturizëm	1.5.1 Fondi për mekanizimin bujqësor	2026-2028	**150,000€** *2026: 50,000€* *2027: 50,000€* *2028: 50,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorë	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorë	Fondi për mekanizimin bujqësor është krijuar dhe ka mbështetur fermerët me pajisje moderne, duke rritur produktivitetin dhe efikasitetin në bujqësi

	1.5.2 Zhvillimi i agroturizmit në zonat rurale	2026-2028	**60,000€** *2026: 20,000€* *2027: 20,000€* *2028: 20,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Agroturizmi në zonat rurale krijon mundësi të reja për turizëm, promovim të produkteve bujqësore lokale dhe ekonomisë rurale
	1.5.3 Subvencionimi i sistemeve të ujitjes dhe mbrojtjes së tokës	2026-2028	**200,000€** *2026: 70,000€* *2027: 65,000€* *2028: 65,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Sistemet e ujitjes dhe mbrojtjes së tokës janë subvencionuar
	1.5.4 Programi i certifikimit për produktet bujqësore	2026-2028	**30,000€** *2026: 10,000€* *2027: 10,000€* *2028: 10,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Programi i certifikimit për produktet bujqësore është zbatuar
	1.5.5 Diversifikimi i prodhimit bujqësor	2026-2028	**60,000€** *2026: 20,000€* *2027: 20,000€* *2028: 20,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorë	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante, donatorë	Diversifikimi i prodhimit bujqësor është nxitur
	1.5.6 Ndërtimi i rrugëve bujqësore dhe kanaleve kulluese në Fushë Kosovë dhe fshatrat, Kuzmin, Miradi e Epërme, Miradi e Poshtme, Vragoli, Henc, Harilaq, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Bardh i Madh, Bardhi i Vogël, Graboc, Pomozotin, Lismir	2026-2028	**250,000€** *2026: 100,000€* *2027: 75,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, ministritë relevante	Rrugët bujqësore dhe kanalet kulluese në Fushë Kosovë dhe fshatrat Kuzmin, Miradi e Epërme, Miradi e

	dhe Nakaradë		*2028: 75,000€*				Poshtme, Vragoli, Henc, Harilaq, Sllatinë e Madhe, Sllatinë e Vogël, Bardh i Madh, Bardhi i Vogël, Graboc, Pomozotin, Lismir dhe Nakaradë janë ndërtuar
Qëllimi strategjik #2: Rritja e cilësisë në arsim, shëndetësi dhe mirëqenie sociale							
Objektivi specifik 2.1	**Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit**			**Gjendja bazë**	**Caku 2026**	**Caku 2027**	
	- Numri i shkollave dhe çerdheve të reja të ndërtuara - Numri i objekteve shkollore të renovuara - Numri i sallave të reja shkollore të ndërtuara - Numri i institucioneve me pompa termike të instaluara - Numri i shkollave të pajisura me smart boards - Numri i objekteve të adaptuara për nxënës me aftësi të kufizuara - Raportet e pranimit të inventarit			15%	60%	100%	
	Aktiviteti/Projekti	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale**	**Burimi i financimit**	**Institucioni udhëheqës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultati**
Ndërtimi dhe modernizimi i objekteve shkollore, duke përmirësuar infrastrukturën arsimore	2.1.1 Ndërtimi i shkollës në Fushë Kosovë – Faza II, në rrugën “Fazli Grajqevci”	2026	241,000€	DKA, Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës dhe MASHT	Shkolla në Fushë Kosovë, në rrugën “Fazli Grajqevci”, është ndërtuar dhe funksionalizuar
	2.1.2 Instalimi i pompave termike në institucionet edukativo-arsimore: “Gëzimi Ynë”, “Mihal Grameno – Anex I dhe Anex II” dhe “Daut Bogujevci”	2026	400,000€	DKA, Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës dhe MASHT	Pompat termike janë instaluar në institucionet edukativo-arsimore “Gëzimi Ynë”, “Mihal Grameno – Anex I dhe Anex II” dhe “Daut Bogujevci”

	2.1.3 Ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Lismir, Komuna e Fushë Kosovës	2026	200,000€	DKA, Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, MASHT	Shkolla fillore në fshatin Lismi është ndërtuar dhe funksionalizuar
	2.1.4 Ndërtimi i çerdhës në rrugën "Shukri Obertinca" – Faza II	2026	230,000€	DKA, Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës dhe MASHT	Çerdhja në rrugën "Shukri Obertinca" – Faza II është ndërtuar dhe funksionalizuar
	2.1.5 Ndërtimi i çerdheve në fshatin Sllatinë e Madhe dhe në fshatin Miradi e Epërme, Komuna e Fushë Kosovës	2026-2028	**250,000€** *2026: 100,000€* *2027: 75,000€* *2028: 75,000€*	DKA, Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës dhe MASHT	Çerdhet në fshatin Sllatinë e Madhe dhe në fshatin Miradi e Epërme janë ndërtuar dhe funksionalizuar
	2.1.6 Renovimi i objekteve shkollore përfshin shkollat: "Bajram Curri", "Mihal Grameno", "Mihal Grameno – Anex II", "Daut Bogujevci", "Vëllezërit Frashëri", "Zenel Salihu" dhe "Hivzi Sulejmani"	2026-2028	**350,000€** *2026: 150,000€* *2027: 100,000€* *2028: 100,000€*	DKA, Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës dhe MASHT	Objektet shkollore "Bajram Curri", "Mihal Grameno", "Mihal Grameno – Anex II", "Daut Bogujevci", "Vëllezërit Frashëri", "Zenel Salihu" dhe "Hivzi Sulejmani" janë renovuar
	2.1.7 Ndërtimi i sallave shkollore në shkollën "Mihal Grameno" – Anex III dhe në shkollën e re në rrugën "Fazli Grajqevci" në Fushë Kosovë	2026-2028	**500,000€** *2026: 200,000€* *2027: 150,000€* *2028: 150,000€*	DKA, Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, MASHT	Sallat shkollore në shkollën "Mihal Grameno" – Anex III dhe në shkollën e re në rrugën "Fazli Grajqevci" në Fushë Kosovë janë ndërtuar

	2.1.8 Digjitalizimi në objektet shkollore për shkollat fillore në Fushë Kosovë, përmes blerjes së smart boards për realizimin e orës mësimore në formë vizuale	2026	300,000€	DKA, Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, MASHT	Digjitalizimi në objektet shkollore është realizuar për shkollat fillore në Fushë Kosovë, përmes blerjes së *smart boards*
	2.1.9 Sigurimi i qasjes të barabartë për nxënësit me aftësi të kufizuara: Adaptimi i objekteve shkollore me rampa dhe ambiente të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke garantuar një sistem arsimor inkluziv	2026-2028	**200,000€** *2026: 70,000€* *2027: 65,000€* *2028: 65,000€*	DKA, Komuna e Fushë Kosovës, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, MASHT, donatorët	Objektet shkollore në janë adaptuar me rampa dhe ambiente të përshtatura për nxënësit me aftësi të kufizuara
	2.1.10 Blerja e paisjeve për shkollat fillore në Fushë Kosovë	2026-2028	**200,000€** *2026: 70,000€* *2027: 65,000€* *2028: 65,000€*	DKA, Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, MASHT	Pajisjet e reja janë blerë për shkollat fillore në Fushë Kosovë
Objektivi specifik 2.2	**Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit**			**Gjendja bazë**	**Caku 2026**	**Caku 2027**	
	- Numri i pjesëmarrësve në qendrën e aftësimit profesional - Numri i marrëveshjeve me biznese për praktika pune - Numri i të rinjve të angazhuar në praktika profesionale - Numri i përfituesve nga kurset e certifikimit - Numri i përfituesve që gjejnë punësim pas përfshirjes në programe			0%	70%	100%	
	Aktiviteti/Projekti	**Afati i zbatimit**	**Kostoja totale**	**Burimi i financimit**	**Institucioni udhëheqës**	**Institucioni mbështetës**	**Rezultati**
Fuqizimi i programeve të aftësimit profesional, veçanërisht për të rinjtë dhe grupet e margjinalizuara	2.2.1 Qendra e aftësimit profesional	2026-2028	**150,000€** *2026: 50,000€* *2027: 50,000€* *2028: 50,000€*	Komuna e Fushë Kosovës, OJQ, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, OJQ, donatorët	Qendra e aftësimit profesional e funksionalizuar
	2.2.2 Partneritete me bizneset për praktika pune	2026-2028	**30,000€**	Komuna e Fushë	Komuna e	Komuna e	Është realizuar

			2026: 10,000€	Kosovës, OJQ, donatorët	Fushë Kosovës	Fushë Kosovës, OJQ, donatorët	partneriteti me bizneset për praktika pune
			2027: 10,000€				
			2028: 10,000€				
	2.2.3 Subvencionimi i kurseve të certifikimit	2026-2028	**20,000€**	Komuna e Fushë Kosovës, OJQ, donatorët	Komuna e Fushë Kosovës	Komuna e Fushë Kosovës, OJQ, donatorët	Subvencionimi i kurseve të certifikimit është realizuar
			2026: 7,000€				
			2027: 6,500€				
			2028: 6,500€				
	2.2.4 Programi i mentorimit dhe zhvillimit të karrierës	2026-2028	**20,000€**	Komuna e Fushë Kosovës, OJQ, donatorët		Komuna e Fushë Kosovës, OJQ, donatorët	Programi i mentorimit dhe zhvillimit të karrierës është zbatuar
			2026: 7,000€				
			2027: 6,500€				
			2028: 6,500€				
Objektivi specifik 2.3	**Treguesi/t për matjen e përmbushjes së objektivit**			**Gjendja bazë**	**Caku 2026**	**Caku 2027**	
